

**NIKOLLA PERDHIKU
SHYRETE SELMANAJ**

Libër mësuësi
për tekstin shkollor

MATEMATIKA 7

Botues:
Latif AJRULLAI
Rita PETRO

Redaktore përgjegjëse:
Dorentina XHAFA

Arti grafik:
Ela LUMANI

© Albas, 2016

Shtëpia botuese Albas
Në Tiranë: Rr. "Donika Kastrioti", pallati 14, ap. 4D.
Tel: 00355 45800160; e-mail: info@albas.al
Në Tetovë: Rr. "Ilinden", nr. 105
Tel: 00389 44 344 047; e-mail: albas_te@yahoo.com
Në Prishtinë: Rr. "Muharrem Fejza", p.n.
Tel: 00377 45 999 770
e-mail: albas_pr@yahoo.com

Shtypur në shtypshkronjën: DEAPRINT

Hyrje

Zbatimi me sukses i programit të matematikës nuk mund të kuptohet pa rolin shumë të rëndësishëm të mësuesit si përçues dhe transmetues i ideve të programit.

Për t'u ardhur në ndihmë mësuesve (veçanërisht mësuesve të rinj), po botojmë këtë tekst ndihmës që shoqëron tekstin e nxënësit *Matematika 7*.

Nuk duhet menduar se ky tekst është konceptuar si ditari i mësuesit, por edhe si një mënyrë për zhvillimin mësimi.

Mënyra se si është ndërtuar ora e mësimi në tekstin e nxënësit i jep mundësi mësuesit që të përdorë metoda bashkëkohore.

Në tekstin e mësuesit tërhiqet vëmendja për të punuar në mënyrë të diferencuar me tri nivelet e nxënësve. Kjo është mbajtur parasysh si në hartimin e objektivave, ashtu dhe në punën me këto nivele në klasë dhe në punën e pavarur në shtëpi.

Shpresojmë se ky tekst të ndihmojë për të arritur rezultatet e dëshiruara në mësimin e lëndës së matematikës.

PLANIFIKIMI TREMUJOR (SHTATOR–DHJETOR)

FUSHA: MATEMATIKË

LËNDA: MATEMATIKA 7

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

Kompetenca e të menduarit: zgjidh një problem matematikor dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse; Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi matematikor, duke paraqitur rezultate të njëjta.

Kompetenca e të nxënit: përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën; shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore, matematikë ose arte, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar;

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;

Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);

Kompetenca qytetare: zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë; Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj. në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave matematikore

Zgjidhja problemore: përdor simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numra; demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave; përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve nga jeta reale.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik: sugjeron formula të ndryshme; klasifikon numrat.

Të menduarit dhe komunikimi matematik: demonstroi zbatimin e numrave; përdor terminologjinë matematikore (p.sh., numër dhjetor, numër i plotë, thyesë, përqindje etj.) për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme; komunikoi të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: gjuhën e përditshme, fjalorin fillestar matematik, paraqitje të ndryshme; mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore.

Lidhja konceptuale: bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore; integron njohuritë e shprehjetë matematike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.); integron/lidh konceptet e ndryshme matematike, në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

Modelimi matematik: krijon modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore si: numër dhjetor, numër i plotë, thyesë, përqindje, eksponent, rrënjë.

Përdorimi i teknologjisë në matematikë: përdor makina llogaritëse të avancuara për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara matematikore.

Nr	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1.	Numrat e plotë (10 orë)	Përdorimi i numrave negativë 1.1	Boshti numerik	Metoda ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, punë në grup	Diagnostikues	Libri i nxënësve
2.		Përdorimi i numrave negativë 1.2	Boshti numerik	Metoda ndërvepruese, gjithëpërfshirëse punë në grup	Diagnostikues	Libri i nxënësve
3.		Mbledhja dhe zbritja e numrave negativë 1.3	Mbledhje dhe zbritje në bosht	Metoda ndërvepruese, gjithëpërfshirëse punë në grup	Vlerësim i nxënësve	Libri i nxënësve, fletorja e punës, boshti numerik
4.		Shumëfishat 1.4	Marrëdhëniet mes numrave	Metoda ndërvepruese, gjithëpërfshirëse punë në grup		Libri i nxënësve, fletorja e punës
5.		Faktorët dhe testi i plotpjesëtueshmërisë 1.5	Pjesëtuesit e një numri	Metoda ndërvepruese, gjithëpërfshirëse punë në grup	Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Libri i nxënësve, fletorja e punës
6.		Faktorët dhe testi i plotpjesëtueshmërisë 1.6		Metoda ndërvepruese, gjithëpërfshirëse punë në grup		
7.		Numrat e thjeshtë 1.7	Sita e Eratostenit			Tabela me sitën e Eratostenit
8.		Katrorët dhe rrënja katrore 1.8	Numrat katrorë		Vlerësim diagnostikues	Tabela të parapërgatitura

9.		Katrorët dhe rrënja katrore 1.9				
10.		Përsëritje 1.10				
11.	Vargjet, shprehjet dhe formulat (10 orë)	Përftimi i vargjeve 2.1	Vargu numerik			Libri i nxënës it, fletorja e punës
12.		Përftimi i vargjeve 2.2				Tabela
13.		Përftimi i vargjeve 2.3		Metoda ndërvepruese, gjithëpërfshirë se, punë në grup	Vlerësim për të nxënë	
14.		Paraqitja e funksioneve të thjeshta 2.4				
15.		Paraqitja e funksioneve të thjeshta 2.5			Vlerësim i përgjigjeve me gojë	
16.		Ndërtimi i shprehjeve 2.6	Përdorimi i shkronjave në matematikë		Vlerësim i punës në grup	
17.		Ndërtimi i shprehjeve 2.7				
18.		Nxjerrja dhe përdorimi i formulave 2.8			Vlerësim i përgjigjeve me gojë	
19.		Nxjerrja dhe përdorimi i formulave 2.9				
20.		Përsëritje 2.10				
21.	Vendvlera, renditja dhe rrumbullakimi (14 orë)	Kuptimi i numrave dhjetorë 3.1	Numri dhjetor		Vlerësim i punës në grup	
22.		Shumëzimi dhe pjesëtimi me 10,100,1000 3.2	Krahasimet dhe veprimet me numra dhjetorë			
23.		Shumëzimi dhe pjesëtimi me 10,100,1000 3.3		Metoda ndërvepruese, gjithëpërfshirë se punë në grup		
24.		Renditja e numrave dhjetorë 3.4			Vlerësim i përgjigjeve me gojë	
25.		Renditja e numrave dhjetorë 3.5		Diagnostikues		
26.		Rrumbullakimi 3.6				

27.		Mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë 3.7				
28.		Mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë 3.8				
29.		Shumëzimi i numrave dhjetorë 3.9				
30.		Pjesëtimi i numrave dhjetorë 3.10				Libri i nxënës it, fletorja e punës
31.		Vlerësimi dhe përafrimi i një rezultati 3.11				
32.		Vlerësimi dhe përafrimi i një rezultati 3.12				
33.		Vlerësimi dhe përafrimi i një rezultati 3.13				
34.		Përsëritje 3.14				
35.	Gjatësia, masa dhe kapaciteti (5 orë)	Njohja e njësive matëse 4.1	Mjetet matëse	Metoda integrale, bashkëbisedim		
36.		Njohja e njësive matëse 4.2				Libri i nxënës it, fletorja e punës
37.		Zgjedhja e njësive të përshtatshme 4.3				Mjete matëse
38.		Leximi i përshkallëzimit 4.4	Këndet, drejtëzat			
39.		Përsëritje 4.5				
40.	Këndet (7 orë)	Emërtimi dhe vlerësimi i masës së këndeve 5.1		Metoda integrale, bashkëbisedim		
41.		Ndërtimi dhe matja e këndeve 5.2				
42.		Llogaritja e këndeve 5.3				
43.		Llogaritja e këndeve 5.4				
44.		Zgjidhje problemash me kënde 5.5				Vlerësim i punës në grup
45.		Zgjidhje problemash me kënde 5.6				
46.		Përsëritje 5.7				
47.	Planifikimi	Përgatitja për	Analizim të			

	dhe grumbullimi i të dhënave (5 orë)	grumbullimin e të dhënave 6.1	dhënash			
48.		Mbledhja e të dhënave 6.2		Metoda integrale, bashkëbisedim		
49.		Përdorimi i tabelave të dendurive 6.3				
50.		Përdorimi i tabelave të dendurive 6.4				
51.		Përsëritje 6.5				
52.		Vlerësimi përmblendhës				
53		Vlerësimi i portofolit				

PLANIFIKIMI TREMUJOR (JANAR-MARS)

FUSHA: MATEMATIKË

LËNDA: MATEMATIKA 7

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç

- zgjidh një problem matematikor dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse;

përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi matematikor, duke paraqitur rezultate të njëjta.

Kompetenca e të nxënit:

- shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar; ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike

- **Kompetenca për jetën ,sipërmarrjen dhe mjedisin**

bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj)

Kompetenca personale:

bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj)

Kompetenca digjitale:

analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave matematikore

Zgjidhja problemore: përdor simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numra thyesorë dhe dhjetorë; demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave; përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik: prezanton të dhëna empirike për figurat 2d; ndërton figura gjeometrike.

Të menduarit dhe komunikimi matematik: përdor terminologjinë matematikore (p.sh., numër dhjetor, thyesë, përqindje etj.) për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme. komunikon të menduarin e tij matematikor (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: gjuhën e përditshme, fjalorin fillestar matematik, paraqitje të ndryshme. e mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore.

Lidhja konceptuale: integron njohuritë e shprehitë matematike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).
integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

Modelimi matematik: krijon modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore.

Nr	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi
54.	Thyesat (10 orë)	Thjeshtimi i thyesave 7.1			
55.		Njohja e thyesave të barabarta, numrave dhjetorë dhe përqindjeve 7.2	Thyesat		
56.		Njohja e thyesave të barabarta, numrave dhjetorë dhe përqindjeve 7.3	Numrat dhjetorë	Metoda integruese, bashkëbisedim	
57.		Krahasimi i thyesave 7.4	Përqindjet		
58.		Thyesat e rregullta, të parregullta dhe numrat e përzier 7.5	Krahasimet, veprimet me to		
59.		Mbledhja dhe zbritja e thyesave 7.6			
60.		Gjetja e pjesës së një sasive të caktuar 7.7		Punë në grup dhe punë individuale	
61.		Gjetja e mbetjes 7.8			
62.		Gjetja e mbetjes 7.9			
63.		Përsëritje 7.10			
64.	Simetria (5 orë)	Njohja dhe përshkrimi i figurave 8.1			Vlerësim i të nxënit
65.		Njohja e drejtëzës së simetrisë 8.2	Figura të ndryshme		
66.		Vetitë e simetrisë së trekëndëshave, katërkëndëshave dhe shumëkëndëshave 8.3			
67.		Vetitë e simetrisë së trekëndëshave, katërkëndëshave dhe shumëkëndëshave 8.4		Prezantime në forma të ndryshme	Vlerësim i përgjigjeve me gojë
68.		Përsëritje 8.5			
69.	Shprehjet dhe ekuacionet	Mbledhja e kufizave të ngjashme 9.1			

	(6 orë)				
70.		Mbledhja e kufizave të ngjashme 9.2	Shprehje dhe ekuacione		
71.		Hapja e kllapave 9.3			
72.		Formimi dhe zgjidhja e ekuacioneve 9.4			
73.		Formimi dhe zgjidhja e ekuacioneve 9.5		Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues	Vlerësim i punës në grup
74.		Përsëritje 9.6			
75.	Mesataret (6 orë)	Mesatarja dhe amplituda 10.1			
76.		Mesatarja dhe amplituda 10.2			
77.		Mesatarja aritmetike 10.3	Studim statistikor të dhënash		
78.		Mesatarja aritmetike 10.4			
79.		Krahasimi i shpërndarjeve 10.5			
80.		Përsëritje 10.6			
81.	Përqindjet (5 orë)	Përqindjet e thjeshta 11.1	Numrat		
82.		Përqindjet e thjeshta 11.2	Përqindjet		
83.		Llogaritja e përqindjeve 11.3			
84.		Krahasimi i sasive 11.4			
85.		Përsëritje 11.5			
86.	Problema ndërtimi (6 orë)	Matja dhe ndërtimi i segmenteve 12.1	Drejtëzat		
87.		Ndërtimi i drejtëzave pingule dhe paralele 12.2	Figurat gjeometrike		
88.		Ndërtimi i trekëndëshave 12.3	Matja dhe ndërtimi i tyre		
89.		Ndërtimi i trekëndëshave 12.4			
90.		Ndërtimi i katrorëve, drejtkëndëshave dhe shumëkëndëshave 12.5			
91.		Përsëritje 12.6			
92.	Grafikët (5 orë)	Pikat në rrjetin koordinativ 13.1			
93.		Pikat në rrjetin koordinativ 13.2			
94.		Drejtëzat paralele me boshtet 13.3			
95.		Funksioni $y = ax$ dhe grafiku i tij 13.4			
96.		Përsëritje 13.5			
97.		Vlerësimi përmbledhës			
98.		Vlerësimi i portofolit			

PLANIFIKIMI TREMUJOR (PRILL-QERSHOR)

FUSHA: MATEMATIKË

LËNDA: MATEMATIKA 7

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:

dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.

Kompetenca e të menduarit: përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi matematikor, duke paraqitur rezultate të njëjta.

Kompetenca e të nxënit

ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:

bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);

Kompetenca personale:

vlërëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup

Kompetenca qytetare:

bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj)

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave matematikore

Zgjidhja problemore: përdor matjet në figurat 2d (d = dimensionale) për zgjidhjen problemore. përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik: prezanton të dhëna empirike për figurat 2d dhe objektet 3d. sugjeron formula të ndryshme. argumenton shndërrimet.

Të menduarit dhe komunikimi matematik: përdor terminologjinë matematikore (p.sh., modë, mesore, mesatare aritmetike etj.) për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme. e mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore.

Lidhja konceptuale: bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

Modelimi matematik: përdor grafikët për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në matematikë, në fushat e tjera dhe në jetën e përditshme.

Përdorimi i teknologjisë në matematikë: përdor teknologjinë për komunikuar dhe zbuluar informacion matematik.

Nr	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
99.	Raportet dhe përpjesëtimet (5 orë)	Thjeshtimi i raporteve 14.1				
100.		Ndarja në një raport të caktuar 14.2			Vlerësim diagnostikues	Libri i nxënësit
101.		Ndarja në një raport të caktuar 14.3		Metoda integrale, bashkëbisedim		
102.		Përdorimi i përpjesëtimet të drejtë 14.4				Fletorja e punës
103.		Përsëritje 14.5				
104.	Koha (6 orë)	Sistemi 12-orësh dhe sistemi 24-orësh 15.1				
105.		Sistemi 12-orësh dhe sistemi 24-orësh 15.2			Vlerësim për të nxënë	
106.		Oraret e udhëtimeve 15.3				
107.		Grafikë nga jeta e përditshme 15.4		Puna në grup dhe punë individuale		
108.		Grafikë nga jeta e përditshme 15.5			Vlerësim i përgjigjeve me gojë	
109.		Përsëritje 15.6				
110.	Probabiliteti (7 orë)	Paraqitja numerike e probabilitetit 16.1				
111.		Ngjarjet me mundësi të njëjtë 16.2				
112.		Ngjarjet e papajtueshme 16.3				
113.		Ngjarjet e papajtueshme 16.4				
114.		Vlerësimi i probabiliteteve 16.5		Metoda integrale, bashkëbisedim	Vlerësim i aktivizimit	
115.		Vlerësimi i probabiliteteve 16.6				
116.		Përsëritje 16.7				
117.	Pozicioni dhe lëvizja (4 orë)	Pasqyrimi i figurave 17.1			Vlerësim i detyrave të shtëpisë	
118.		Rrotullimi i figurave 17.2				
119.		Zhvendosja e				

		figurave 17.3				
120.		Përsëritje 17.4				
121.		Testim				
122.	Syprina, perimetri dhe vëllimi (9 orë)	Kthimi i njërive të matjes së sipërfaqes 18.1				
123.		Llogaritja e syprinës dhe perimetrit të drejtkëndëshit 18.2				
124.		Llogaritja e syprinës dhe perimetrit të drejtkëndëshit 18.3		Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues		
125.		Llogaritja e syprinave dhe perimetrave të figurave të përbëra 18.4				
126.		Llogaritja e syprinave dhe perimetrave të figurave të përbëra 18.5				
127.		Vëllimi i kubit dhe kuboidit 18.6				
128.		Llogaritja e syprinës anësore dhe të përgjithshme të kubit dhe kuboidit 18.7				
129.		Llogaritja e syprinës anësore dhe të përgjithshme të kubit dhe kuboidit 18.8		Prezantime në forma të ndryshme		
130.		Përsëritje 18.9				
131.	Interpretimi dhe diskutimi i rezultateve 6 (orë)	Interpretimi dhe ndërtimi i piktogrameve, grafikëve me shtylla, grafikëve me segmente dhe tabelave të dendurive 19.1				
132.		Interpretimi dhe ndërtimi i piktogrameve, grafikëve me shtylla, grafikëve me segmente	Ndërtim i piktogrameve, grafikëve me shtylla, grafikëve me segmente dhe tabelave të			

		dhe tabelave të dendurive 19.2	dendurive			
133.		Interpretimi dhe ndërtimi i grafikëve rrethorë 19.3	Interpretim grafikësh			
134.		Nxjerrja e përfundimeve 19.4				
135.		Nxjerrja e përfundimeve 19.5				
136.		Përsëritje 19.6				
137.		Ushtrime përmbledhëse për lëndën 20.1;				
138.		Ushtrime përmbledhëse për lëndën 20.2				
139.		Vlerësimi përmbledhës				
140.		Vlerësim portofoli				

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore 1.1. Përdorimi i numrave negativë		Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor boshtin numerik. Meqenëse numrat negativë ndeshen për herë të parë, mësuesi/ja përdor boshtin numerik dhe secilit nxënës i kërkohet që orën tjetër të ketë të vizatuar në fletoren e klasës një bosht numerik. Mësuesi/ja duhet të ketë në klasë një tabelë me bosht numerik.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
<p>1. Kompetenca e të nxënit. Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës (p.sh., metrologjia).</p> <p>2. Kompetenca qytetare. Përkushtohet ndaj rregullave të mirësjelljes, mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë.</p>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
<p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • radhit në boshtin numerik numra të plotë pozitivë dhe negativë; • mbledh dhe zbrësë numrat pozitivë dhe negativë. 		<p>numra të plotë numra pozitivë numra negativë bosht numerik</p>	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, fleta ku të ketë boshte të vizatuara ose tabela.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Me fushën e gjuhës dhe komunikimit, metrologjinë, gjeografinë.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit)			
Meqenëse është ora e parë dhe nxënësit nuk kanë njohuri për numrat negativë, mësuesi/ja u kërkon që të bëjnë renditjen e disa numrave pozitivë.			

- a) Më thoni disa temperatura të ulëta. Nëse nxënësit nuk përmendin temperatura negative, mësuesi/ja të kërkojë deri sa ndonjë prej tyre të japë temperaturë negative.
- b) Si mendoni ju, cila është më e madhe, temperatura 0 gradë apo temperaturat negative?
- c) Si mendoni ju, cila është më e madhe, temperatura negative apo pozitive? Nëse përgjigjet e nxënësve do të jenë të gabuara, duhet t'i sqarojë mësuesi. Cila temperaturë ndan temperaturat pozitive me temperaturat negative?
- ç) Ky krahasim që bëme për temperaturat mund të bëhet dhe për numrat?

b. Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo – analizo – diskuto)

Mësuesi/ja duhet të sqarojë se çfarë quhet bosht numerik duke dhënë dhe elementet e tij:

“Është një drejtëz, që në anën e djathtë është vendosur një shigjetë, janë bërë ndarje të barabarta dhe në një prej ndarjeve është vendosur numri zero. Në të djathtë të zeros vendosen numrat pozitivë dhe në të majtë numrat negativë.

Mbasi janë sqaruar mirë këto, mësuesi/ja punon në dërrasë shembullin që është në tekst.

c. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe/praktikë e pavarur)

Mbasi mësuesi është bindur se nxënësit e kanë kuptuar shembullin, shpërndan nga një fletë me bosht numerik dhe nga një me temperatura të ndryshme. Më pas u kërkon që të vendosin në boshtin numerik numrat e dhënë sipas renditjes së duhur. Mbasi ka kontrolluar detyrën e dhënë, ngre dy nxënës në tabelë: njeri punon ushtrimin 2 dhe tjetri ushtrimin 3.

Vlerësimi:

Në përfundim të ushtrimeve, mësuesi/ja i drejton klasës disa pyetje për të kontrolluar sa i saktë ka qenë përvetësimi i mësimit. Për përgjigjet që japin nxënësit, mësuesi mund të bëjë dhe vlerësimin e disave prej tyre.

- Çfarë quajmë bosht numerik?
- Si vendosen numrat pozitivë dhe negativë në boshtin numerik?
- Cili numër është më i madh 3 apo 4; -2 apo 2 ; -7 apo -10 ?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 1, 2, 3, 4 faqe 7 fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7 Shkalla: III Klasa: VII
Tema mësimore: 1.2 Përdorimi i numrave negativë	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të nxënësve. Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës (p.sh., meteorologjia) 2. Kompetenca qytetare. Përkushtohet ndaj rregullave të mirësjelljes, mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë. 3. Kompetenca digjitale. Përdor mjetet multimediale për të bashkëpunuar me persona të tjerë.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: të mendojë në mënyrë krijuese; të mbledhë dhe të zbrësë numrat pozitivë dhe negativë.	Fjalë kyç: numrat të plotë numrat pozitive numrat negative boshti numerik
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, fletë ku të ketë të vizatuara boshte ose tabela	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me fushën e gjuhës dhe komunikimit, meteorologjinë, gjeografinë.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimin	
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (bashkëvepruese, rrjeti i diskutimit) Mësuesi u drejton nxënësve disa pyetje për të kuptuar a është përvetësuar tema e orës së kaluar nga masa e nxënësve apo jo. – Ç’është boshti numerik? – Si vendosen numrat në boshtin numerik? – Cili është ai numër në boshtin numerik që ndan numrat pozitivë me numrat negativë? – Çdo numër pozitiv është më i madh apo më i vogël se çdo numër negativ? Mbas këtyre pyetjeve mësuesi mund të pyesë nxënës për t’i vlerësuar duke shfrytëzuar ushtrimet 4, 5 dhe 6 faqe 9 në librin e nxënësit ose ushtrimin 5 dhe detyrat e shtëpisë te fletorja e punës në faqen 7.	
Ndërtimi i njohurive të reja (ndërvepruese, vëzhgo – analizo – zbato) Nxënësit lexojnë me vëmendje ushtrimin 7 dhe 9 në libër. Ndërsa nxënësit punojnë, kërkojuni atyre që përgjigjet t’i thonë me zë të lartë të shoqëruara me veprimet e duhura, në tabelë në mënyrë që të kontrollojnë sa e kanë kuptuar mësimin. Mbase është punuar dhe kuptuar ushtrimi, mësuesi ngre një nxënës mesatar për të punuar ushtrimin 8. Ushtrimet 9 dhe 10 janë shumë të rëndësishme, prandaj mësuesi duhet t’u lërë më shumë kohë. Secili nga nxënësit duhet të kenë një bosht numerik në fletoren e klasës, kurse mësuesi duhet të ketë në dërrasë një bosht numerik. Ashtu si thuhet në tekst, ushtrimet duhen të zgjidhen sikur i kemi temperatura, ushtrimi 9 sikur rriten temperaturat, kurse ushtrimi 10 sikur ulen temperaturat. Si duhet të veprojë mësuesi? Merr ushtrimin 9 (a). U thotë nxënësve, gjeni në boshtin tuaj numerik numrin - 2. Këtij	

<p>numri i shtoni 5, pra do të zhvendosemi 5 ndarje djathtas. Në çfarë numri arrijmë në bosht? Përgjigja do të jetë 3. Nëse ka përgjigje të gabuara, mësuesi duhet të kërkojë nga ata nxënës se si kanë vepruar. Nxënësit punojnë për të zgjidhur ushtrimet 9 (b, c, ç, d, dh). Të punohet me nxënësit e dobët dhe mesatarë. Mësuesi punon së bashku me nxënësit ushtrimin 10 (b, d). Për 10 (b) u kërkon që në boshtin numerik të gjejnë numrin -4, duke i konsideruar si temperaturë, zvogëlohen me 6. Mund të ketë përgjigje të sakta, por dhe të gabuara. Mësuesi duhet të kërkojë sqarimin si nga ata që kanë dhënë përgjigje të saktë, por dhe nga ata që kanë dhënë përgjigje të gabuar. Kurse për 10(d), mbasi të kenë gjetur përsëri numrin -4, kërkon që temperatura ulet me 3, pastaj vazhdon duke thënë se përsëri temperatura zvogëlohet prapa me 3. Edhe në këtë ushtrim mund të ketë përgjigje të sakta, por dhe të gabuara. Përsëri mësuesi është i detyruar për të sqaruar të dyja palët. Nxënësit punojnë ushtrimet 10 (a,c, ç, dh).</p> <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantime në forma të ndryshme)</p> <p>Nxënësit prezantojnë punën e tyre duke i shoqëruar përgjigjet me boshtin numerik. Përforcimi i të nxënësve: Mësuesi në përfundim të këtyre ushtrimeve u drejton këtë pyetje: nëse një numri çfarëdo të plotë i shtojmë një numër të plotë, si zhvendosemi në boshtin numerik?</p>
<p>Vlerësimi:</p> <p>Për të parë të nxënësve, mësuesi i drejton klasës këto dy pyetje:</p> <ul style="list-style-type: none">– Si do të veproni, nëse keni për të gjetur shumën $a + b$, kur a dhe b kanë shenja të njëjta dhe kur a dhe b kanë shenja të kundërta (me bosht numerik)?– Si do të veproni, nëse keni për të gjetur $a - b$, kur a dhe b kanë shenja të njëjta dhe kur a dhe b kanë shenja të kundërta (me bosht numerik)? <p>Me përgjigjet e dhëna dhe me atë që ka kontrolluar te metodologjia, mësuesi bën vlerësimin e disa nxënësve.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p> <p>Ushtrimet 7, 8, 9, 10 në faqen 9 te libri i nxënësit.</p>

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Mënyra e vendosjes së numrave në boshtin numerik do të ndihmojë nxënësin për të mbledhur dhe zbritur numrat.	
Tema mësimore: 1.3. Mbledhja dhe zbritja e numrave negativë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të nxënit. Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës (p.sh., metrologjia). 2. Kompetenca qytetare. Përkushtohet ndaj rregullave të mirësjelljes, mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: mbledh dhe zbrit numrat pozitivë dhe negativë; përdor boshtin numerik.		Fjalë kyç: numra të plotë numra negativë numra pozitivë bosht numerik	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, një tabelë ku të ketë të vizatuar boshte numerike.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Me fushën e gjuhës dhe komunikimit, metrologjinë, gjeografinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim)			
Për të kujtuar mbledhjen dhe zbritjen e numrave, mësuesi i drejtohet klasës me pyetjet: – Si do të veproni, nëse keni për të gjetur shumën $a + b$, kur a dhe b kanë shenjë të njëjtë dhe kur a dhe b kanë shenja të kundërta (me bosht numerik)? – Si do të veproni, nëse keni për të gjetur $a - b$, kur a dhe b kanë shenja të njëjta dhe kur a dhe b kanë shenja të kundërta (me bosht numerik)?			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato, marrëdhënie pyetje-përgjigje)			
Shembujt që janë të zgjidhur i punojnë nxënësit bashkë me mësuesin. Mësuesi jep dhe një mënyrë tjetër për të kryer veprimet. Paraqiten katër lloj ushtrimesh. a) $- a + b$ b) $- a - b$ c) $- a - (- b)$ ç) $- a - (+ b)$ Trajtohen rastet me radhë. Rastet c) dhe ç) do të vazhdohen të zgjidhen me bosht numerik. Që të eliminohet boshti numerik, për rastet a) dhe b) mësuesi zhvillon këtë diskutim me nxënësit. a) Merr në fillim shembullin $- 3 + 5$. Rezultati që ka dalë është 2. Mësuesi pyet klasën çfarë numri është rezultati pozitiv apo negativ? Përgjigjja do të jetë është numër pozitiv. Përsëri i drejtohet klasës. Nëse të dy numrat i marrim pozitivë, përfundimi 2 si mund të dalë? Mund të ketë përgjigje të ndryshme. Nëse do të ndodhë kjo, atëherë			

<p>mësuesi i drejtohet përsëri klasës. Po të zbresim nga numri 5 numrin 3, sa del përfundimi? Përgjigjja do të jetë 2. Në ushtrim: Cili është numri më i madh, 5 apo 3? Përgjigjja do të jetë 5. I drejtohet përsëri klasës me pyetjen: Cila e ka shenjën + numri më i madh apo numri më i vogël? Përsëri përgjigjja do të ketë shenjën +. Pra është një numër që ka shenjën e numrit më të madh.</p> <p>Nxjerrim këtë përfundim: Nëse kemi për të mbledhur dy numra me shenjë të kundërt, i mendojmë numrat natyrorë. Nga numri më i madh zbresim numrin më të vogël dhe përfundimit i vëmë shenjën që ka numri më i madh (kur i mendojmë të dy natyrorë), p.sh.,</p> <p>$-4 + 10$. Numri më i madh është 10. Nga 10 zbresim numrin më të vogël, që është 4 dhe del 6. Meqenëse numri më i madh ka përpara shenjën +, atëherë $-4 + 10 = 6$.</p> <p>Merret një shembull tjetër: $-11 + 8$. Duke i konsideruar të dy natyrorë numri më i madh është 11, prandaj nga 11 zbresim 8 dhe del 3. Por numri më i madh ka përpara shenjën – atëherë $-11 + 8 = -3$.</p> <p>b) Marrim shembullin $-5 - 3$. Mësuesi këtë shembull e ka zgjidhur me bosht numerik dhe i ka dalë -8. Mënyra tjetër: të dy numrat janë negativë, i mendojmë të dy natyrorë. Duke i mbledhur del 8. Këtij rezultat i vëmë shenjën e përbashkët, që është “-” pra, $-5 - 3 = -8$. Përfundimisht:</p> <p>a) nëse kemi ushtrime të trajtës $a - b$, numrat a dhe b i konsiderojmë natyrorë. Përfundimi del duke zbritur nga numri më i madh numrin më të vogël dhe numrit që del i vëmë përpara shenjën e numrit më të madh;</p> <p>b) nëse kemi ushtrime të trajtës $-a - b$, numrat a dhe b i konsiderojmë pozitivë, përfundimi del duke i mbledhur të dy numrat pa shenjë dhe përfundimit i vëmë shenjën e përbashkët që kanë numrat në ushtrim.</p> <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim) Klasa ndahet në grupe. Punojnë ushtrimet e teksti 1. Njëri grup do ta zgjidhë me bosht numerik dhe i dyti me mënyrën që u dha më lart. Para se të bëhen përfundimet e orës së mësimit, duhet të punohet me kujdes ushtrimi 6. Do të arrihet në përfundimin se në diferencën e dy numrave nuk ka vend vetia e ndërrimit.</p>
<p>Vlerësimi Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi u përgjigjet saktë pyetjeve: – Si veprohet me boshtin numerik për të gjetur sa del $-4 + 3$, po $-3 - (-2)$? – Po me mënyrën e dytë, si veprohet për të gjetur $-8 + 9$, po për $-7 - 6$?</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur Ushtrimet 4, 5 në faqen 10 të libri i nxënësit dhe 3, 4 (c, ç) dhe 7 në faqen të 8 fletores së punës. Shënim. Mënyra e dytë që u dha për të kryer veprimin $a - b$ dhe $-a - b$ nuk është e detyruar; është më e lehtë për të kryer veprimet. Dy rastet e tjera do të zhvillohen në këtë mënyrë kur të zhvillohet tema <i>Heqja e kllapave</i>.</p>

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Numrat kanë lidhje ndërmjet tyre. Disa merren nga shumëzimi i dy numrave të tjerë, disa mund të merren nga pjesëtimi i një numri me një tjetër. P.sh. numri 8 merret nga shumëzimi i numrit 4 me numrin 2 ose shumëzimit të numrit 1 me numrin 8. Kjo situatë do të sjellë dhe kuptimin e shumëfishave.	
Tema mësimore: 1.4 Shumëfishat			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit: përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi matematikor, duke paraqitur rezultate të njëjta. Kompetenca e të nxënit: ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: gjen shumëfishat e numrave të ndryshëm.		Fjalë kyç shumëfish shumëfish i përbashkët shumëfishi më i vogël i përbashkët	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me fushën e gjuhës dhe komunikimit	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësim			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (ndërvepruese, rrjeti i diskutimit) Mësuesi kontrollon mësimin e kaluar nëpërmjet detyrave të shtëpisë dhe ushtrimeve që ka teksti i nxënësit dhe fletorja e punës. Mbas kontrollit mësuesi kërkon nga nxënësit pesë numrat e parë që pjesëtohen me 3. Këta numra i shkruan në dërrasë për t'i përdorur tek organizimi i orës së mësim			
Ndërtimi i njohurive të reja (bashkëvepruese, të nxënit në bashkëpunim) Mësuesi shënon në dërrasë numrin 3 dhe gjen prodhimin e tij me numrin 1. $1 \cdot 3 = 3$. Kërkon nga nxënësit që të gjejnë prodhimet e numrit 3 me 2, me 3, me 4 e me radhë. Në dërrasë është plotësuar kjo tabelë: $1 \cdot 3 = 3$ $2 \cdot 3 = 6$ $3 \cdot 3 = 9$ $4 \cdot 3 = 12$ $5 \cdot 3 = 15$. Mësuesi formon vargun 3, 6, 9, 12, 15. Është i njëjti varg që i doli te veprimtaria e nxënësit. Numrat e këtij vargu quhen shumëfisha të numrit 3. Kërkon nga nxënësit të shkruajnë vargun me shumëfishat e 4, të 5 dhe të 10. Mësuesi sqaron se cili është kuptimi i vendosjes së tri pikave në fund. Ky shënim tregon se vargu vazhdon. Mësuesi duhet të theksojë se numri 6 dhe 8 kanë shumëfisha të përbashkët. Pasi i shkruan në dërrasë 24, 48, 72, pyet: Po numrat e këtij vargu, shumëfisha të cilit numër janë? Nëse nuk ka përgjigje, e sqaron vetë mësuesi: janë shumëfisha të numrit 24. Numri 24 është shumëfishi më i vogël i 6 dhe 8. Ky numër quhet shumëfishi më i vogël i përbashkët.			
Shënim. Në tekst nuk është shënuar por mundet që mësuesi të theksojë që këtë shumëfish më të vogël të përbashkët mund ta shkruajmë në trajtën SHVP $(6, 8) = 24$. Nxënësit vëzhgojnë dhe punojnë shembullin në libër.			
Mbas punimit të shembullit, mësuesi udhëzon nxënësit që të punojnë ushtrimin 2 në			

faqen 11. Mbasi të sqarohet mirë ushtrimi 2, nxënësit punojnë ushtrimin 7 (a), i cili kërkon shumëfishin më të vogël të numrave 4 dhe 6. Nxënësi do ta bëjë si shembulli. Nxiten nxënësit që të shprehin me fjalë përparësitë dhe mangësitë e kësaj metode. A ka mënyra të tjera për gjetjen e SHVP-së? Prandaj, mësuesi duhet t’u mësojë dhe një rrugë tjetër për gjetjen e shumëfishit më të vogël të përbashkët. Numrat i vendosim kështu në fletore: 4 6

Gjejmë pjesëtuesin më të vogël që pjesëton të paktën një nga numrat.

Në rastin tonë është numri 2. E vendosim në të djathtë dhe herësin poshtë numrave (në rast se nuk pjesëtohet ndonjë nga numrat, e shënojmë përsëri.

4 6 2 Përsëri gjejmë pjesëtuesin më të vogël dhe veprojmë si më lart.

2 3

4 6 2

2 3 2

1 3

Vazhdojmë si në dy etapat e para.

4 6 2

2 3 2

1 3 3

1 1

Kur në rreshtin e fundit, herësit të dalin të gjithë njësha, atëherë shumëfishi më i vogël i përbashkët është prodhimi i numrave të shtyllës së fundit. Pra, në rastin tonë, SHVP-ja $(4, 6) = 2 \cdot 2 \cdot 3 = 12$. Nxënësit vënë re se ky numër ka dalë edhe duke zbatuar shembullin. Mësuesi merr dhe një shembull tjetër.

9 11 3

3 11 3

1 11 11

1 1

Atëherë SHVP-ja $(9, 11) = 3 \cdot 3 \cdot 11 = 99$. Udhëzohen nxënësit që të lexojnë me vëmendje ushtrimin 9. Në fillim, mësuesi u drejtohet nxënësve: Nëse nga qesja heqim atë karamele që tepronte, ky numër karamelësh, çfarë do të ishte për numrat 2, 3, 4, 5, 6? Nëse nuk do të ketë përgjigje të saktë, mësuesi i pyet: Si do t’i ndani në mënyrë të barabartë karamelët, kur keni dy persona, tre persona, katër persona, pesë persona dhe gjashtë persona? Përgjigja do të jetë: duhet pjesëtuar numrin e karameleve me numrin e personave. Pra numri i karameleve, është shumëfishi më i vogël 2, 3, 4, 5, dhe 6-ës. Gjejmë shumëfishin më të vogël të përbashkët.

2 3 4 5 6 2

1 3 2 5 3 2

1 3 1 5 3 3

1 1 1 5 1 5

1 1 1 1 1

Atëherë, SHVP-ja $(2, 3, 4, 5, 6) = 2 \cdot 2 \cdot 3 \cdot 5 = 60$. Duke shtuar karamelen e hequr, del që në qese ka pasur 61 karamele.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantime në forma të ndryshme)

Nxënësit paraqesin punën e tyre në forma të ndryshme duke përfshirë edhe objekte konkrete.

Vlerësimi: Klasës i drejton këtë pyetje, për të vlerësuar të nxënët e mësimit.

– Cili quhet shumëfish më i vogël i përbashkët i disa numrave?

– Jep dhe këtë ushtrim: Gjeni SHVP-në $(18, 16, 2)$. Në përfundim, kontrollon punën e secilit dhe, duke pasur parasysh dhe përgjigjet te metodologjia, bën vlerësimet po ta shohë të nevojshme.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 3, 8 në faqen 11 të librit të nxënësit dhe 4, 7 dhe 8 në faqen 9 të fletores së punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 1.5 Faktorët dhe testi i plotpjesëtueshmërisë		Ka numra të cilët plotpjesëtohen nga i njëjti numër. Të gjithë numrat plotpjesëtohen me numrin një. Të gjithë numrat që shifren e njësheve e kanë 0, 2, 4, 6, dhe 8 plotpjesëtohen nga numri dy. Kjo na shtyn të mendojmë se mund të ketë rregulla për plotpjesëtimin edhe me numra të tjerë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të nxënit			
Nxënësi/ja ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.			
2. Kompetenca e të menduarit			
Nxënësi/ja gjatë punës së tij mendon në mënyrë krijuese.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
Nxënësi/-ja:		faktor	
<ul style="list-style-type: none"> dallon faktorët e një numri; dallon pjesëtimin nga plotpjesëtimi; përvetëson kushtet se kur një numër plotpjesëtohet me 2, me 3, me 4, me 5, me 6, me 8, me 9, me 10, 100 apo 1000. 		faktor i përbashkët	
		faktor më i madh i përbashkët	
		plotpjesëtueshmëri	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Me fushën e gjuhës dhe komunikimit.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit)			
Për të realizuar këtë temë, mësuesi shkruan në dërrasë numrat 12, 15, 30. Kërkon nga nxënësit se cilët numra pjesëtojnë secilin prej tyre. Pjesëtuesit i shënon pranë numrave. Për të kontrolluar mësimin e orës së kaluar, jep dhe këtë ushtrim: Gjeni SHVP-në (12, 15, 30).			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo, analizo, zbato)			
Kjo temë ka dy koncepte shumë të rëndësishme, faktori dhe plotpjesëtueshmëria. Faktor i një numri a quhet çdo numër b, që gjatë pjesëtimit të numrit a me numrin b, nuk ka mbetje. Nëse ndodh kjo, atëherë numri b plotpjesëton numrin a. Pra, çdo faktor i një numri e plotpjesëton atë numër. Prandaj, pjesëtimi dhe plotpjesëtimi janë të ndryshëm. Në pjesëtim mund të ketë mbetje, kurse në plotpjesëtim nuk ka mbetje. Numri 1 dhe vetë numri janë faktorë të numrit të dhënë. Marrim numrin 24. Ky numër plotpjesëtohet me 1 dhe 24; $24 : 1 = 24$ dhe $24 : 24 = 1$. Pohimet: numri a është faktor i numrit b dhe numri b është shumëfish i numrit a, janë të barasvlershme. P.sh., 3 është faktor i numrit 12, sepse $12 : 3 = 4$, por numri 12 është shumëfish i numrit 3, sepse $4 \cdot 3 = 12$.			

Mësuesi udhëzon nxënësit që të vëzhgojnë shembullin duke kërkuar që ata të gjejnë faktorët e përbashkët. Më të madhin e faktorëve të përbashkët do ta quajmë pjesëtuesi më i madh i përbashkët. Kështu, te shembulli, faktori më i madh i përbashkët është numri 8. Mësuesi mund t’u thotë nxënësve se përdoret ky shënim për faktorin më të madh të përbashkët PMP $(40, 24) = 8$.

Në pjesën e dytë të mësimit mësuesi duhet të japë rregulla se kur një numër plotpjesëtohet me 2, me 3, me 4, me 5, me 6, me 8, me 9 dhe 10, 100, 1000. Këto rregulla duhet të përvetësohen shumë mirë nga nxënësi dhe për këtë mund të merren nga dy shembuj. Në fillim numra dyshifrorë dhe pastaj numra me mbi tri shifra.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (praktikë e pavarur)

Nxënësit punojë si përforsim ushtrimin 1 dhe 2 faqe 13 te libri i nxënësit. Pas punës së pavarur, nxënësit bëjnë prezantimin e punës së tyre.

Vlerësimi:

Për të kuptuar përvetësimin e mësimit, nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Cilët numra quhen faktorë të një numri të dhënë?
- Cili është ndryshimi ndërmjet pjesëtimit dhe plotpjesëtimit?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 2?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 3?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 4?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 5?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 6?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 8?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 9?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 10?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 100?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 1000?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 1, 2, 3, 4 dhe 5 në faqen 10 të fletores së punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 1.6 Faktorët dhe testi i plotpjesëtueshmërisë (Ushtrime)		Është po ajo situatë si në temën e kaluar.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
Kompetenca e të nxënit:			
Përdor informacionin e marrë më parë gjatë punës së tij dhe kupton se nga një pjesë e informacionit të njohur rrjedh informacioni i ri.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
Nxënësi/-ja:		faktor	
<ul style="list-style-type: none"> dallon faktorët e një numri; dallon pjesëtimin nga plotpjesëtimi; përvetëson kushtet se kur një numër plotpjesëtohet me 2, me 3, me 4, me 5, me 6, me 8, me 9 dhe me 10, 100 apo 1000. 		faktor i përbashkët	
		faktori më i madh i përbashkët plotpjesëtueshmëri	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, një tabelë ku të jenë shkruar rregullat e plotpjesëtimit me 2, me 3, me 4, me 5, me 6, me 8, me 9, me 10, 100 apo 1000.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Me fushën e gjuhës dhe të komunikimit, me temën e orës së kaluar	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimin			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (bashkëvepruese, të nxënit në bashkëpunim)			
Mësuesi shkruan disa numra dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë se me cilët numra plotpjesëtohen. Ndërmjet numrave të ketë dhe nga ata që plotpjesëtohen me 2, 3, 5 dhe 6,. Të ketë dhe numra që nuk plotpjesëtohen me asnjë prej numrave që dihen kriteret plotpjesëtueshmërisë.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto-formulo)			
Tabelën me rregullat e plotpjesëtimit me 2, me 3, me 4, me 5, me 6, me 8, me 9 dhe me 10, 100 apo 1000 do të vihet në klasë kur nxënësit tu jenë përgjigjur pyetjeve të më poshtme.			
– Cilët numra quhen faktorë të një numri të dhënë?			
– Cili është ndryshimi ndërmjet pjesëtimit dhe plotpjesëtimit?			

- Kur një numër plotpjesëtohet me 2?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 3?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 4?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 5?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 6?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 8?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 9?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 10?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 100?
- Kur një numër plotpjesëtohet me 1000?.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, praktikë e pavarur)

Pas përgjigjeve të pyetjeve të mësipërme, nxënësit zhvillojnë në klasë ushtrimet 6, 8, 10 të librit të nxënësit dhe 9, 10, 11 të fletores së punës. Grupet bëjnë prezantimin e punës së tyre.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësit/set sipas grupeve:

- japin numra që plotpjesëtohen me numrat 2, 3, 5;
- japin numra që plotpjesëtohen me 5, 10, 9 dhe 8;
- japin numra që nuk plotpjesëtohen me asnjë nga numrat që dinë kriteret e plotpjesëtimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 5, 6, 8 dhe 9 faqe 10 nga fletorja e punës.

Fusha:Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Nxënësit mund të gjejnë numra që plotpjesëtohen me një dhe me veten e tyre. Kjo situatë na detyron që të futim dhe kuptimin e numrave të thjeshtë.	
Tema mësimore: 1.7 Numrat e thjeshtë			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</p> <p>1. Kompetenca e të menduarit Shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim.</p> <p>2. Kompetenca digjitale: Përdor teknologjinë për komunikuar dhe zbuluar informacion matematik.</p> <p>3. Kompetenca e të nxënit: Përdor tabelat për të zgjidhur problemat në mënyrë sistematike.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon faktorët e një numri; dallon numrat e thjeshtë; përdor sitën e Eratostenit për të gjetur numrat e thjeshtë. 		<p>Fjalë kyç: numra të thjeshtë sita e Eratostenit prodhim</p>	
<p>Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, tabelën me sitën e Eratostenit deri te numri i thjeshtë 11. 2 3 5 7 9 11 13 15 17 19 21 23 25 27 29 31 33 35 37 --- 2 3 5 7 11 13 17 19 23 25 29 31 35 37 41 43 45 47 49 53 --- 2 3 5 7 11 13 17 19 23 29 31 37 41 43 47 49 53--- 2 3 5 7 11 13 17 19 23 29 31 37 41 43 47 53--- 2 3 5 7 11 13 17 19 23 29 31 37 41 43 47 53---</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit, lidhet me temat 1.6 dhe 1.7 <i>Faktorët dhe testi i plotpjesëtueshmërisë.</i></p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Diskutohen së bashku me nxënësit ushtrimet e dhëna për detyrë shtëpie. Nxiten</p>			

nxënësit që të shprehin me fjalë njohuritë e marra gjatë temës së kaluar.

Ndërtimi i njohurive të reja (të nxënit në bashkëpunim)

Mësuesi jep këtë ushtrim: Gjeni faktorët e numrave 11, 13 dhe 12. Nxënësit duhet të japin këtë përgjigje: Numri 11 ka si faktor numrin 1 dhe numrin 11; numrin 13 ka si faktor numrin 1 dhe 13; kurse numri 12 ka si faktor numri 1, 2, 3, 4, 6 dhe 12. Pra, dy të parët kanë si faktorë numrin 1 dhe vetveten; kurse numri 12 ka 6 faktorë. Duke u nisur nga numri i faktorëve, numrat e plotë pozitivë i ndajmë në dy grupe. Numrat që kanë dy faktorë quhen numra të thjeshtë, kurse numrat e tjerë quhen numra jo të thjeshtë.

Mësuesi u drejton këtë pyetje:

- Ka numër çift që është i thjeshtë?
- Numrat e thjeshtë, çfarë numrash janë, çift apo tek? Pse?
- Numri 1 çfarë numri është?

Mësuesi zhvillon shembullin së bashku me nxënësit. Mbasi ka përfunduar shembullin, ngre në dërrasë një nxënës, i cili punon ushtrimin 6 në faqen 15.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe/praktikë e pavarur)

Ushtrimin 8 nxënësit e punojnë në mënyrë individuale në bankë, duke plotësuar tabelën që është në të djathtë të faqes 15 dhe katër rreshta të tjerë. Diskutohen në tabelë përgjigjet e nxënësve. A ka të drejtë Agroni? Për çfarëdo përgjigjeje, kërkohet argumentimi. Nxënësit punojnë ushtrimet 8 dhe 9 faqe 11 te fletorja e punës.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve:

1. Cilët quhen numra të thjeshtë? 2. Cili është faktori i përbashkët i numrave të thjeshtë? 3. Numrat e thjeshtë janë numra çift apo tek? Pse? 4. Numri 2 është numër i thjeshtë? Pse?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 1, 2, 3, 4 dhe 8 në faqen 15 të librit të nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Nxënësit gjejnë numra, të cilët shprehen si prodhim i dy numrave të barabartë. P.sh., $25 = 5 \cdot 5$; $36 = 6 \cdot 6$. Pra, këta numra kanë diçka të veçantë nga të tjerët, prandaj lind nevoja që të kenë një emërtim të veçantë.	
Tema mësimore: 1.8 Katrorët dhe rrënja katrore			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të nxënit Përdor informacionin ekzistues për të nxjerrë informacion të ri. 2. Kompetenca e të menduarit Gjatë punës së tij mendon në mënyrë krijuese.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: dallon numrat katrorë; lexon simbolin a^2 , i cili shkruhet dhe në trajtën $a \cdot a$; gjen katrorin e një numri të plotë; di kuptimin e \sqrt{a} dhe gjen rrënjën katrore të numrave katrorë.		Fjalë kyç: numra katrorë rrënjë katrore e anasjellë	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, një tabelë si ajo në tekst, por të jenë dhe numrat 25 dhe 36.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe të komunikimit, lidhet me temën <i>Faktorët e një numri</i> .	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim, punë në grupe) Mësuesi e ndan klasën në tri grupe. Grupit të parë i kërkon që të shkruajë në fletoren e klasës shtatë numra të thjeshtë. Grupit të dytë i kërkon që të shkruajë pesë numra që plotpjesëtohen vetëm me numrin 2 dhe grupit të tretë i kërkon që të shkruajë në fletore pesë numra që shprehen si prodhim i dy numrave të barabartë. Mbasi nxënësit i kanë kryer këto ushtrime, mësuesi ngre nga një nxënës për secilin grup në dërrasë. Po këtyre nxënësve u jep dhe ushtrime të tjera për t'i vlerësuar me notë.			
Ndërtimi i njohurive të reja (të nxënit në bashkëpunim, vëzhgo-analizo-zbato-formulo) Nëpërmjet tabelës dallohet se cilët quhen numra katrorë, si shënohen dhe si lexohen ata. Paraqitet mënyra se si mund të gjendet numri katror i një numri të dhënë nëpërmjet veprimit të shumëzimit. Shembull: 6^2 quhet numër katror, lexohet 6 në			

katror. Ai mund të shkruhet

$6^2 = 6 \cdot 6 = 36$; $9^2 = 9 \cdot 9 = 81$. Numra katrorë më të vegjël se 100 janë:

1, 4, 9, 16, 25, 36, 49, 64, 81, 100.

Mësuesi duhet të japë dhe konceptin e dytë që është rrënja katrore. Simboli i saj është \sqrt{a} dhe lexohet “rrënja katrore e numrit a”. Duhet të theksohet se rrënja katrore e numrave katrorë është numër i plotë. Shembull: $\sqrt{25} = 5$; $\sqrt{81} = 9$; $\sqrt{100} = 10$.

Mësuesi duhet të theksojë se katrori i një numri dhe gjetja e rrënjës katrore janë veprime të anasjella.

Mësuesi udhëzon nxënësit që të punojnë ushtrimin 3(a, c).

I nxit ata që gjatë punës të bëjnë pyetje të tilla, si:

– Cili është numri, katrori i të cilit është 100? Duke pasur parasysh atë që është thënë më lart, përgjigjja do të jetë 10.

– Cilët janë katrorët e numrave më të mëdhenj se 10?

Atëherë $11^2 = 11 \cdot 11 = 121$; $12^2 = 12 \cdot 12 = 144$; $13^2 = 13 \cdot 13 = 169$; $14^2 = 14 \cdot 14 = 196$;

$15^2 = 15 \cdot 15 = 225$. Por ushtrimi kërkon deri te numri 200.

Prandaj, numrat katrorë janë 121; 144; 169; 196.

Për 3(c) duke vazhduar më tej ushtrimin 3(a) do të gjejë numrat katrorë nga 300 deri te 400, që janë 324 dhe 361. Meqenëse kërkohet midis 300 dhe 400, numri 400 nuk merret.

Ushtrimin 4(c) mësuesi e zhvillon së bashku me nxënësin.

$$12^2 + 5^2 = a^2.$$

Mësuesi drejton pyetjen: Si veprojmë për të gjetur a-në?

Gjejmë $12^2 = 12 \cdot 12 = 144$ dhe $5^2 = 25$.

Atëherë $12^2 + 5^2 = 144 + 25 = 169$.

Duke vërejtur ushtrimet e mësipërme, kemi $169 = 13^2$.

Prandaj, $12^2 + 5^2 = 13^2$.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe/praktikë e pavarur)

Udhëzohen nxënësit që të punojnë ushtrimet 1,2,3/b dhe 4/a b,ç nga libri, duke përdorur njohuritë e marra gjatë orës së mësimit.

Nxënësit prezantojnë punën e tyre.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin:

– të gjejë disa numra katrorë më të vegjël se 100;

– të lexojë saktë simbole, si 12^2 ;

– të lexojë saktë simbole, si $\sqrt{144}$;

– të thotë çfarë lidhjeje ka katrori i një numri me rrënjën katrore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 1, 2, 3(b), 4(a, b, c) në faqen 16 nga libri i nxënësit dhe 1, 2 në faqen 11 në fletoren e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Situata si në mësimin e kaluar.	
Tema mësimore: 1.9 Katrorët dhe rrënja katrore (ushtrime)			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
<p>1. Kompetenca e të menduarit Zgjidh një problemë matematikore dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.</p> <p>2. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike.</p> <p>3. Kompetenca qytetare Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj.</p>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: dallon numrin katror; lexon simbolin a^2 , i cili shkruhet në trajtën $a \cdot a$; gjen katrorin e një numri të plotë tregon kuptimin e \sqrt{a} dhe gjen rrënjën katrore të numrave katrorë.		Fjalë kyç: numër katror rrënjë katrore e anasjellë	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, një tabelë me numrat katrorë më të vegjël se 200. Numrat 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14. Numrat katrorë 1 4 9 16 25 36 49 64 81 100 121 144 169 196.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me temën <i>Shumëfishat</i> dhe me orën e kaluar.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit)			
Mësuesi duhet të ketë në dërrasë një tabelë si ajo që është te burimet. Nxënësve u drejton këto pyetje, përgjigjen e të cilave do ta gjejnë në tabelë.			
<ul style="list-style-type: none"> – Cili numër e ka katrorin 64? – Cili numër e ka katrorin 144? – Sa është katrori i numrit 13? – Sa është katrori i numrit 9? – Sa është rrënja katrore e numrit 49? – Sa është rrënja katrore e numrit 196? 			
Ndërtimi i njohurive të reja (të nxënit në bashkëpunim, punë në grupe)			
Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:			
<ul style="list-style-type: none"> – Cilët janë disa numra katrorë? – Si lexohet 12^2? – Si lexohet simboli $\sqrt{144}$? – Cili numër quhet faktor i një numri të dhënë? 			
Mbasi merr përgjigjet e pyetjeve të drejtuara, udhëzon nxënësit që të zhvillojnë ushtrimin 6 faqe 16 te libri i nxënësit.. Në krah të djalhtë të ushtrimit është dhënë një			

tabelë me numra katrorë. Nxënësve u drejtohet pyetja:

– Sa faktorë ka numri 16?

Përgjigjja mund të jetë tre: 1, 4 dhe 16, por mund të jetë dhe katër: 1, 2, 4, 16.

Cila përgjigje është e saktë?

Për përgjigjen e fundit mësuesi bën argumentimin.

Po numri 100, sa faktorë ka? Mundet që, duke u nisur nga përgjigjja për numrin 16, përgjigjja mund të jetë: 1, 2, 4, 5, 10, 20, 25, 50 dhe 100.

Ndahen nxënësit në grupe dhe punohen ushtrimet për rrënjën katrore.

Mësuesi kërkon nga nxënësit përgjigje për ushtrimin 8(a, b, c, ç, d, dh, e, ë). Për ushtrimin 8(f, g) kërkon si do të veprohet për të gjetur përfundimin.

Për 8(f) mund të jepen dy përgjigje. Mësuesi i shkruan të dyja në dërrasë. E para

$$\sqrt{29 + 35} = \sqrt{29} + \sqrt{35}$$

$$\text{E dyta } \sqrt{29 + 35} = \sqrt{64} = 8.$$

Nxiten nxënësit që të veçojnë përgjigjen e saktë. Nëse nxënësit nuk e gjejnë, duhet që mësuesi të argumentojë që e dyta është përgjigjja e saktë. Nëse mësuesi shikon paqartësi, pasi ky ushtrim është pak i vështirë, merr këtë shembull:

$$\sqrt{64 + 36} . \text{ Duke zbatuar përgjigjen e parë do të kemi } \sqrt{64 + 36} = \sqrt{64} + \sqrt{36} = 8 + 6 =$$

14. Meqenëse katrori i një numri dhe rrënja katrore janë veprime të anasjella, duhet që 14^2 të jetë e barabartë me $64 + 36 = 100$. Por $14^2 \neq 100$. Duke zbatuar përgjigjen e

dytë, kemi $\sqrt{64 + 36} = \sqrt{100} = 10$. Këtu është e vërtetë që $10^2 = 100 = 64 + 36$ Pra dhe në ushtrimin e parë rasti i dytë është i vërtetë. Si përfundim, nëse brenda rrënjës kemi një shumë, duhet të gjejmë shumën, pastaj vlerën e rrënjës katrore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe/praktikë e pavarur)

Udhëzohen nxënësit që të punojnë ushtrimin 9(a I, a IV).

Nxiten që të përdorin mënyrën se si shkruhet $a^2 = a \cdot a$.

Zbatojeni këtë dhe për $(\sqrt{36})^2 = \sqrt{36}\sqrt{36} = 6 \cdot 6 = 36$. Pra, doli numri që është nën shenjën e rrënjës katrore.

Nxiten nxënësit që të formulojnë këtë rregull:

Nëse një rrënjë katrore është ngritur në katror, vlera e saj është e barabartë me numrin brenda shenjës së rrënjës katrore. P.sh. $(\sqrt{6})^2 = 6$. Marrim; $\sqrt{16^2} = \sqrt{256} = 16$. Pra doli numri që është ngritur në katror brenda rrënjës.

Jepen katër ushtrime. Gjeni $(\sqrt{49})^2$, $(\sqrt{81})^2$, $\sqrt{16^2}$, $\sqrt{6^2}$.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve:

– Si lexohen: 8^2 , $(11)^2$, $\sqrt{225}$, $\sqrt{1225}$, $(\sqrt{225})^2$?

– Me sa është e barabartë vlera e një rrënje, që është ngritur në katror?

– Me sa është vlera e një rrënje, nëse numri brenda rrënjës është ngritur në katror?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 9(a II, a III), 10 në faqen 17 të librit të nxënësit dhe nga fletorja e punës, ushtrimet 4, 8, 9, 10 në faqen 11.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Nxënësi është ndeshur gjatë kapitullit të parë me shumë situata, si: kuptimi i numrave negativë, krahasimi i tyre, veprimet e mbledhjes dhe zbritjes së numrave negativë; dallimi ndërmjet pjesëtimit dhe plotpjesëtimit; gjetja nëse një numër i dhënë plotpjesëtohet me 2, me 3 etj; gjetja e vlerave të shprehjeve të thjeshta etj.	
Tema mësimore: 1.10 Përsëritje			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të menduarit Nxënësi gjatë punës së tij mendon në mënyrë krijuese.			
2. Kompetenca digjitale Përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënit dhe për të rritur efektivitetin në nxënie.			
3. Kompetenca qytetare Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., si dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: njuh boshtin numerik; vendos numrat e plotë pozitivë dhe negativë në boshtin numerik; kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes me numrat e plotë; gjen faktorët e një numri; përcakton numrat që plotpjesëtohen me 2, me 3, me 4, me 5, me 6, me 8, me 9, me 10, me 100 dhe me 1000; dallon plotpjesëtimin me pjesëtimin; gjen SHVP-në dhe PMP-në e dy ose më shumë numrave; lexon simbolin a^2 , i cili shkruhet në trajtën $a \cdot a$ dhe simbolin \sqrt{a} ; gjen katrorin e një numri të plotë; gjen rrënjën katrore të numrave katrorë.		Fjalë kyç: Janë të gjitha fjalët e dhëna në çdo temë të këtij kreu.	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve të fituara gjatë këtij kapitulli.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe të komunikimit, si dhe me të gjitha temat e trajtuara gjatë këtij kapitulli.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim, punë në grupe) Në orën e përsëritjes metodologjia duhet të jetë e tillë që të përsëriten të gjitha konceptet që janë marrë. Për këtë duhet të zhvillohen ushtrime në grupe ose diskutime.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe) Sipas grupeve, nxënësit punojnë ushtrimet: 4, 6, 8, 10 dhe 11. Shënim. Nga orët që i janë lënë në dispozicion, në këtë kapitull mund të zhvillohet një test kontrolli. Nëse do të zhvillohet testi i kontrolli, në përsëritje mësuesi duhet të zhvillojë tipa ushtrimesh nga ato që do të jepen në test.</p> <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe) U kërkohet nxënësve që të bëjnë një prezantim të punës së tyre në grupe.</p>
<p>Vlerësimi: Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">– Cili quhet bosht numerik?– Si vendosen numrat pozitivë dhe negativë në boshtin numerik?– Cilët numra quhen faktorë të një numri të dhënë?– Cili është ndryshimi ndërmjet pjesëtimit dhe plotpjesëtimit?– Kur një numër plotpjesëtohet me 2?– Kur një numër plotpjesëtohet me 3?– Kur një numër plotpjesëtohet me 4?– Kur një numër plotpjesëtohet me 5?– Kur një numër plotpjesëtohet me 6?– Kur një numër plotpjesëtohet me 8?– Kur një numër plotpjesëtohet me 9?– Kur një numër plotpjesëtohet me 10?– Kur një numër plotpjesëtohet me 100?– Kur një numër plotpjesëtohet me 1000?– Ka numër çift që është i thjeshtë?– Numrat e thjeshtë, çfarë numrash janë çift apo tek? Pse?– Numri 1, çfarë numri është?– Si lexohet 12^2?– Si lexohet $\sqrt{144}$?
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Mësuesi duhet të krijojë ushtrime, të cilat trajtojnë konceptet më të rëndësishme të këtij kreu ose të zgjedhë ushtrime, që atij i duken më të rëndësishme si nga libri i nxënësit, ashtu edhe nga fletorja e punës.</p>

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit: Nxënësit ndeshen me një koncept të ri, prandaj situatat që krijohen duhet të shtrohen me anë të ushtrimeve të thjeshta.	
Tema mësimore: 2.1 Përfitimi i vargjeve			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.			
2. Kompetenca e të menduarit Gjatë punës së tij nxënësi mendon në mënyrë krijuese.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: tregon si formohet një varg; dallon vargjet e fundme dhe të pafundme; gjen kufizën e vargut kur jepet vendi i tij; gjen rregullën e përfitimit të një vargu; përcakton kufizat e njëpasnjëshme.		Fjalë kyç: varg kufizë varg i fundmë rregull për përfitimin e vargut kufiza të njëpasnjëshme në varg varg i pafundmë	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, tabela e ushtrimit 3 faqe 20.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit) Mësuesi shtron pyetjen: Cilat janë llojet e numrave që njihni? Përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë. Veçohet bashkësia e numrave të plotë. Mësuesi u kërkon nxënësve që të thonë pesë numra të plotë njëri pas tjetrit. Dy nga përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë. Te përgjigjja e fundit vendosen tri pika pas numrit të fundit.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto) Mësuesi thekson: Këto renditje numrash quhen vargje numerike. Çfarë duhet të dimë për vargjet? a) Çdo numër i këtyre vargjeve quhet kufizë e vargut. b) Kufizat që ndjekin njëra-tjetrën quhen kufiza të njëpasnjëshme. c) Janë dy lloj vargjesh të fundme dhe të pafundme. Për t'i dalluar, në vargun e pafundmë vendosen tri pika, kurse në vargun e fundmë nuk vendosen tri pika në fund. Mësuesi kërkon nga nxënësit të thonë tri kufiza nga vargu i parë dhe tri kufiza nga vargu i dytë. Gjithashtu, dy kufiza të njëpasnjëshme në vargun e parë dhe të dytë? Cili është varg i pafundmë? Po i fundmë? Sa kufiza ka vargu i parë? Sa kufiza ka			

vargu i dytë?

Për pyetjen e parë përgjigjja do të jetë e saktë. Kurse për të dytën mund të ketë përgjigje të saktë, por dhe të gabuar. Prandaj, mësuesi duhet t'i sqarojë nxënësit se, kur themi varg i pafundmë, nuk mund të përcaktojmë numrin e kufizave të tij.

Në vargun e fundmë numri i kufizave përcaktohet. Pra, ky është dhe një dallim tjetër midis vargut të fundmë dhe të pafundmë.

Mësuesi i drejton klasës pyetjen: Si merret kufiza e dytë nga kufiza e parë? Po kufiza e tretë nga kufiza e dytë?

Nëse përgjigjja do të jetë e gabuar, e sqaron vetë mësuesi.

Kjo përgjigje tregon dhe rregullin e ndërtimit të dy vargjeve.

Nxënësit zhvillojnë shembullin dhe mësuesi i drejton.

Gjatë punimit të shembullit mësuesi duhet të sqarojë mirë kufizat, kufizat paraardhëse, kufizat e njëpasnjëshme dhe rregullën e ndërtimit të vargut.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe praktikë e pavarur)

Mësuesi e ndan klasën në tri grupe. Grupit të parë i jep ushtrimin 1(a dhe ç) faqe 20; grupit të dytë 1(b, d) dhe grupit të tretë 1(c dhe dh). Të tria grupet do t'u përgjigjen dy kërkesave të ushtrimit.

Mbas këtij momenti mësuesi vendos në dërrasë tabelën e ushtrimit 2 në faqen 20.

Ngrihen me radhë nxënës të ndryshëm dhe shkruajnë në dërrasë nga tri kufiza të vargut përkatës.

Për ushtrimin 3(a, b) faqe 21, para se të plotësohen kuadratet, kërkohet që nxënësit të gjejnë rregullën e formimit të vargut. Në klasë punohet dhe ushtrimi 1 faqe 12 në fletoren e punës.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t'u përgjigjet saktë pyetjeve.

– Ç'është vargu?

– Çfarë quhen numrat e vargut?

– Nga dallohet vargu i fundmë nga vargu i pafundmë?

– 4. Cilat quhen kufiza të njëpasnjëshme?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 2 dhe 3, në faqen 12 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit Mësuesi duhet të krijojë situata me vargje të ndryshme, që nxënësi të përcaktojë kufizat kur jepet vendi i kufizës. Jepet kufiza. Përcaktohet vendi, vargjet e fundme dhe të pafundme.	
Tema mësimore: 2.2 Përfitimi i vargjeve (ushtrime)			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Kompetenca e të menduarit Argumenton veprimet e tij duke zhvilluar fjalorin matematik			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalë kyç	
Nxënësi/-ja: - tregon si formohet një varg; - dallon vargjet e fundme dhe të pafundme; - gjen kufizën e vargut kur jepet vendi i tij; - gjen rregullën e përfitimit të një vargu; - përcakton kufizat e njëpasnjëshme.		kufizë varg kufiza të njëpasnjëshme në varg varg i fundmë varg i pafundmë	
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës. 3. Një tabelë si ajo e ushtrimit 5 në faqen 21.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Lidhet me fushën e gjuhës dhe të komunikimit dhe me temën kaluar	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim)

Pyetjet që ju drejtuan klasës në mësimin e kaluar u drejtohen përsëri. a) Ç’është vargu?
b) Çfarë quhen numrat e vargut? c) Nga dallohet vargu i fundmë nga vargu i pafundmë?
ç) Cilat quhen kufiza të njëpasnjëshme?

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato, punë në grupe)

Në dërrasë vendoset tabela e përgatitur e ushtrimit 5.

Nxënësit vëzhgojnë me vëmendje ushtrimin 5 dhe punojnë në fletoren e klasës. Për secilin ushtrim të tabelës mësuesi ngre një nxënës në tabelë.

Mësuesi kërkon mendimin nga klasa për ushtrimet 6, 7 dhe 8.

Nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur.

Pas përfundimit të ushtrimeve diskutohen përgjigjet e nxënësve në tabelë

Me këta nxënës lejon dhe debatin me nxënësit e tjerë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe)

U kërkohet nxënësve që të krijojnë vargun sipas rregullit të mëposhtëm.

Grupi i parë. Kufiza e parë e vargut është 4. Rregulla e ndërtimit të vargut është “zbritni 2 dhe shumëzoni me tre”. Jepni kufizën e dytë, të tretë dhe të pestë.

Grupi i dytë. Shkruani vargun e numrave katrorë nga 1 deri në 100.

Shkruani vargun e dytë me kufiza të barabarta me rrënjën katrore të kufizave të vargut të parë.

Grupi i tretë. Kufiza e pestë e vargut është 30. Gjeni kufizën e parë, të dytë, të tretë, të katër dhe të gjashtë, nëse rregulla e formimit të vargut është zbritni 3.

Vlerësimi

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja.

1. Formon një varg të fundmë dhe të pafundmë.
2. Mbas formimit të vargjeve, gjen kufizën kur jepet vendi i saj në varg,
3. Gjen vendin kur jepet kufiza.

Nga përgjigjet mësuesi/-ja bën dhe vlerësimin me notë.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 4, 5, 6 dhe 7 nga fletorja e punës.

Fusha:Matematikë	Lënda:Matematikë 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit Vargjet mund të paraqiten edhe me figura të ndryshme, por dhe ato kanë një rregull. Mësuesi krijon këtë situatë: në vendin e parë është një trekëndësh, në të dytin dy trekëndësha. Mësuesi kërkon sa trekëndësha janë në vendin e pestë. Po në vendin e dhjetë?	
Tema mësimore: 2.3 Përfitimi i vargjeve(2).			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Kompetenca digjitale Përdor teknologjinë gjatë punës së tij.			
Kompetenca e të menduarit Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.			
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin Bashkëvepron në mënyrë aktive gjatë punës në grup.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalë kyç Varg Kufizë Kufiza të njëpasnjëshme	
Nxënësi/-ja: - Ndërton vargje me modele figurash dhe të përshkruan se si përftohet kufiza e përgjithshme në rastet e thjeshta.			
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës. 3. Modele figurash që paraqesin vargje, duke lënë mundësinë që nxënësit të ndërtojnë kufizat e tjera të vargut.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Lidhet me fushën e gjuhës dhe të komunikimit. Lidhet me temat <i>Përftimi i vargjeve</i> .	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim)</p> <p>Mësuesi kontrollon përgatitjen e nxënësve nëpërmjet detyrave të shtëpisë, duke u dhënë dhe ushtrime të tjera nga libri. Mësuesi parashtron situatën që ka menduar më lart dhe kërkon përgjigje nga nxënësit.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja (metoda ndërvepruese të nxënësve në bashkëpunim)</p> <p>Meqenëse nxënësit kanë parë deri tani vargjet me numra, vargjet ku “kufizat” janë modele figurash duhet të sqarohen, p.sh., modelet me pika.</p> <p>Nxënësit vëzhgojnë shembullin e librit dhe diskutojnë zgjidhjen e tij.</p> <p>Ata punojnë ushtrimin 1 në faqen 22 në libër.</p> <p>Diskutohet zgjidhja e këtij ushtrimi në tabelë.</p> <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, praktikë e pavarur)</p> <p>Për modelet e figurave të përgatitura, ndan nxënësit në dy grupe me kërkesat e ushtrimeve 2 dhe 3. Diskuton së bashku me nxënësit ushtrimin 1 dhe 2. Ushtrimin 5 e jep punë të pavarur dhe kërkon që nxënësit të gjejnë se cili ka të drejtë, Ana apo Joni, në përgjigjen e dhënë.</p> <p>Kërkon që nxënësit të bëjnë prezantimin e punës së tyre në tabelë.</p>
<p>Vlerësimi</p> <p>Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin të arsyetojë dhe të gjejë përgjigjen e saktë.</p> <p>Mësuesi duhet të ketë përgatitur dy ushtrime me dy përgjigje, një të jetë e gabuar dhe tjetra e saktë. Kërkon nga nxënësit që të arsyetojnë dhe të gjejnë se cila është përgjigja e saktë.</p> <p>Mësuesi vlerëson gjithashtu punën e bërë në grupe dhe bashkëpunimin midis nxënësve.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur</p> <p>Ushtrimet. 4 faqe 22 në librin e nxënësit dhe 3 faqe 13 te fletorja e punës.</p>

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit: Mësuesi jep një shprehje me dy shkronja $a + 2b$ dhe krijon këtë situatë. Vlera e kësaj shprehjeje është e përcaktuar. Çfarë duhet të dimë që të përcaktojmë vlerën e kësaj shprehjeje?	
Tema mësimore: 2.4 Paraqitja e funksioneve të thjeshta			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të menduarit Arsyeton dhe argumenton lirshëm mendimet e tij.			
2. Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.			
3. Kompetenca personale Demonstron vullnet për arritjen e rezultateve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: tregon së çfarë është funksioni; çifton elementet e dy bashkësive; paraqet funksionin në mënyra të ndryshme.		Fjalë kyç: funksion mekanizëm i funksionit rezultate skemë	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, tabela të ndryshme që paraqesin mekanizmin e funksionit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe të komunikimit, lidhet me teknologjinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Për të realizuar këtë temë, mësuesi/-ja ngre në dërrasë dy nxënës, të cilët vizatojnë dy paraqitjet e funksioneve (dy figurat e para). Mësuesi paraqet dhe situatën e dhënë, për të cilën kërkon përgjigje. Diskuton së bashku me nxënësit situatat e paraqitura.			

b. Ndërtimi i njohurive të reja (metoda ndërvepruese, vëzhgo–analizo–zbat)

Mësuesi shtron pyetjet: Çfarë quhet funksion? Cilat quhen të dhëna dhe çfarë quajmë rezultat?

Në dy figurat e ndërtuara, nxënësit së bashku me mësuesin përcaktojnë dy bashkësitë, atë të të dhënave dhe atë të rezultateve.

Nxënësit vëzhgojnë shembullin e librit, e punojnë dhe analizojnë zgjidhjen e tij.

Mësuesi duhet të ngulmojë në përcaktimin e të dhënave dhe rezultateve.

Nëse funksioni është dhënë me skemën e shigjetave, numrat nga dalin shigjetat formojnë bashkësinë e të dhënave.

Cila është bashkësia e rezultateve?

Bashkësia e numrave ku është drejtuar shigjeta është bashkësia e rezultateve.

c. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në dyshe, praktikë e pavarur)

Ndahet klasa në grupe. Nxënësit punojnë ushtrimin 1 dhe 2 në faqen 24, 25.

Grupet prezantojnë punën e tyre.

Gjatë prezantimit të punëve të tyre nxënësit zhvillojnë shprehitë e të folurit e të komunikimit.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve:

- Ç’është funksioni?
- Cilat quhen të dhëna?
- Cilat quhen rezultate?

Mbas këtyre pyetjeve, mësuesi kërkon që një nxënës të punojë ushtrimin 1 në faqen 25 për të ndërtuar një funksion me skemën e shigjetave, duke dhënë mekanizmin e ndërtimit të funksionit.

Vlerësohet gjithashtu puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 3 dhe 4 në faqen 25 të libri i nxënësit dhe 1, 2 në faqen 15 të fletorja e punës. Në fletoren e klasës të ndërtojnë skemën me shigjeta për ushtrimin 6 në faqen 25 të tekstit i nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksion		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 2.5 Paraqitja e funksioneve të thjeshta (Ushtrime)		Situata e të nxënit është si në mësimin e kaluar.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
<p>1. Kompetenca e të menduarit Arsyeton dhe argumenton lirshëm mendimet e tij.</p> <p>2. Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.</p> <p>3. Kompetenca personale Demonstron vullnet për arritjen e rezultateve.</p>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
<p>Nxënësi/-ja: dallon funksionin nga shprehjet; gjen vlerën e një shprehjeje; dallon të dhënat nga rezultati.</p>		<p>funksion të dhëna rezultat</p>	
Burimet: Teksti i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		<p>Lidhet me fushën e gjuhës dhe të komunikimit, lidhet me teknologjinë.</p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim, metoda ndërvepruese)			
Për të kontrolluar si është përvetësuar mësimi i kaluar, mësuesi/ja drejton këto tri pyetje.			
– Ç’është funksioni?			
– Cilat quhen të dhëna?			
– Cilat quhen rezultate?			
Nxënësit kanë të parapërgatitur skema me shigjeta nga ushtrimi 6 në fletën e punës.			
Mësuesi kërkon që ky ushtrim të zgjidhet dhe diskutohet zgjidhja nga nxënësit.			
Për këtë mësuesi ngre dhe një nxënës në dërrasë.			
Mbasi diskutojnë ushtrimin 6, nxënësit punojnë ushtrimin 3(c) nga fletorja e punës.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë në dyshe/ praktikë e pavarur)			

Duke qenë orë ushtrimesh, mësuesi ndan klasën në grupe.

Nxënësit udhëzohen për të punuar ushtrimet 4, 5 faqe 15 nga fletorja e punës.

Kur nxënësit përfundojnë ushtrimet, ata:

- dallojnë bashkësinë e të dhënëve;
- dallojnë bashkësinë e rezultateve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim)

Nxënësit bëjnë prezantimin e punëve të tyre.

Gjatë prezantimit të punëve, nxënësit zhvillojnë shprehitë e të folurit e të komunikimit.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi arrin t'u përgjigjet saktë pyetjeve:

- Ç'është funksioni?
- Cilat quhen të dhëna?
- Cilat quhen rezultate?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 5 në faqen 25 nga libri i nxënësit. Nxënësve u kërkon që të krijojnë një ushtrim si ushtrimi 6 në faqen 15 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 2.6 Ndërtimi i shprehjeve		<p>Nxënësve mund t'u paraqitet një situatë e tillë: një nxënës ka tri kuti. Në kutinë e parë ka x lapsa. Në të shtohen dhe 3 lapsa të tjerë. Në kutinë e dytë ka y fletore. Nga kutia hiqet gjysma e fletoreve. Në kutinë e tretë ka z goma. Një shok merr gjysmën e gomave dhe një shok tjetër shton 5 goma.</p> <p>Nxënësve u kërkohet të përcaktojnë numrin e objekteve në secilën kuti (të ndërtojnë shprehjen).</p>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
<p>1. Kompetenca personale</p> <p>Paraqet vullnet në arritjen e rezultateve.</p> <p>2. Kompetenca qytetare</p> <p>Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë</p>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
<p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ndërton shprehje kur i jepen disa të dhëna; tregon kuptimin e fjalëve më i madh, më i vogël, n herë më i madh dhe n herë më i vogël. 		<p>më i madh</p> <p>më i vogël</p> <p>n herë më i madh</p> <p>n herë më i vogël</p>	
Burimet: Teksti i nxënësit, fletorja e punës		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		<p>Lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit, lidhet me shkencat e natyrës.</p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit)

Për të realizuar këtë temë, mësuesi diskuton detyrat e shtëpisë dhe i vlerëson ato duke bërë vërejtjet e nevojshme.

Parashtron situatën e menduar më lart dhe kërkon përgjigje nga nxënësit.

Ndërtimi i njohurive të reja (të nxënësve në bashkëpunim, vëzhgo-analizo-diskuto)

Pasi mësuesi diskuton situatën e vendosur më lart (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij), udhëzon nxënësit që të vëzhgojnë shembujt në libër

Mësuesi dy shembujt e parë i punon duke pyetur nxënësit.

Shembullin që bën fjalë për ndërtimin e shprehjeve që përcaktojnë moshat i punon, por duke aktivizuar dhe nxënësit.

Gjatë zhvillimit të shembullit, mësuesi duhet të sqarojë mirë kuptimin e fjalëve më i madh, më i vogël, n herë më i madh apo n herë më i vogël.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe, prezantim)

Mbas punimit të shembullit dhe pas sqarimit që thamë më lart mësuesi ndan klasën në grupe dyshe për të punuar ushtrimet 1, 2, 3 faqe 26 nga libri i nxënësit dhe ushtrimin 1, 2 faqe 16 nga fletorja e punës.

U kërkohet nxënësve që të bëjnë prezantimin e punës së tyre.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t'u përgjigjet saktë pyetjeve:

– Cili është kuptimi i fjalëve “më i madh”, “më i vogël”?

– Cili është kuptimi i fjalëve “n herë më i madh”, “n herë më i vogël”?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 4, 5 në faqe 27 te libri i nxënësit dhe ushtrimi 3 në faqen 16 te fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksion		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 2.7 Ndërtimi i shprehjeve		<p>Një nxënësi mund t'i paraqitet një situatë e tillë: Një nxënës ka tri kuti</p> <p>Në kutinë e parë ka x lapsa. Në të shtohen dhe 4 lapsa të tjerë. Në kutinë e dytë ka y fletore. Nga kutia hiqet gjysma e fletoreve.</p> <p>Në kutinë e tretë ka z goma. Një shok merr gjysmën e gomave dhe një shok tjetër merr 5 goma. Sa është numri i objekteve në secilën kuti? Ndërtoni shprehjen.</p>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
<p>1. Kompetenca personale</p> <p>Paraqet vullnet në arritjen e rezultateve.</p> <p>2. Kompetenca qytetare</p> <p>Respekton punën e kryer mirë dhe pranon opinionet e tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.</p>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
<p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndërton një shprehje kur i jepen disa të dhëna; • tregon kuptimin e fjalëve më i madh, më i vogël, n herë më i madh dhe n herë më i vogël. 		<p>Fjalët kyç janë ato të mësimave të kaluara.</p>	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		<p>Lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit, lidhet me shkencat e natyrës.</p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim)

Për të realizuar këtë temë mësuesi parashtron situatën e dhënë më lart duke kërkuar përgjigje nga nxënësit.

Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe dyshe)

Mësuesi së bashku me nxënësit punon dhe diskuton në dërrasë ushtrimin 6 faqe 27 nga libri i nxënësit. Këtë ushtrim duhet ta punojnë dhe nxënësit në fletore.

Mësuesi ndan klasën në grupe dyshe për të punuar ushtrimet 4 dhe 5 në faqen 16 nga fletorja e punës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantime)

Mësuesi kërkon që secili grup të bëjë prezantimin e punës së tij në tabelë.

Gjatë prezantimit, mësuesi vlerëson punën e secilit grup.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi arrin të zgjidhë saktë ushtrimin e dhënë më poshtë.

Gjeni shprehjen, nëse nxënësi i parë në regjistër ka n fletore, nxënësi i dytë ka 3 fletore më pak se i pari, kurse nxënësi i tretë ka dy herë më shumë se nxënësi i dytë. Kontrollohet puna dhe bëhen vërejtje për vendosjen e kllapave.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 6, 7 në faqen 16, 17 te fletorja e punës. T'u kërkohet nxënësve të ndërtojnë një problemë si të ushtrimit 6 në faqen 27 të librit të nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 2.8 Nxjerrja dhe përdorimi i formulave		Mësuesi/-ja krijon këtë situatë: jep tri shkronja dhe dy veprime, shumëzim dhe mbledhje. Kërkon që me këto shkronja dhe me këto veprime të krijohet një lidhje ndërmjet tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të menduarit			
Demonstron pavarësi në mendime dhe veprim.			
2. Kompetenca qytetare			
Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> • ndërton shprehje të thjeshta algjebrike; • nxjerr dhe përdor formula të thjeshta; • zëvendëson numra të plotë pozitivë në shprehje të thjeshta lineare dhe formula. 		shprehje algjebrike formula	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Me fushën e matematikës, gjeometrinë, me fushën e shkencave të natyrës, fizikën.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rimarrje njohurish)			
Për të realizuar këtë temë, mësuesi kontrollon detyrat e dhëna orën e kaluar, sidomos detyrën për të ndërtuar një problemë. Mban shënim për të vlerësuar në fund të orës së mësimi ndonjë nxënë. Kërkon nga klasa formulat për syprinën e drejtkëndëshit e katrorit, perimetrin e drejtkëndëshit dhe katrorit, e për figura të tjera, të cilat i ka bërë në klasat e mëparshme.			
Parashtron situatën e dhënë më lart (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij) dhe kërkon përgjigje.			

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato)

Për të realizuar këtë temë, mësuesi kërkon nga nxënësit që të thonë formula të ndryshme.

Shpjegon se ç’është formula dhe si mund të jepet ajo, me fjalë ose me shkronja. Për këtë punon pjesën para shembullit.

Pastaj nxënësit punojnë shembullin së bashku me mësuesin.

Nxënësve duhet t’u tërhiqet vëmendja për shënimet që janë në kuadrat në të djathtë të shembullit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim)

Mësuesi bën ndarjen e klasës në grupe për të punuar ushtrimin 1 dhe 2 nga libri i nxënësit faqe 28.

Nxënësit bëjnë prezantimin e punës së tyre.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme:

- Çfarë quajmë formulë?
- Si mund të jepet formula?
- Cila është radha e veprimeve?
- Si shkruhet x^2 apo $2x$?
- Është dhënë shprehja $3a - b$ ku $a = 2$ dhe $b = 1$. Nxënësi i parë gjeti këtë vlerë $3a - b = 3$, kurse nxënësi i dytë $3a - b = 5$. Cili nga nxënësit e ka rezultatin e saktë?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 1, 2, 3 në faqen 17 të fletores së punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Funkzioni dhe algjebra		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 2.9 Nxjerrja dhe përdorimi i formulave (ushtrime)		Mësuesi/-ja krijon këtë situatë: jep një shprehje dhe dy rezultate të saj për vlera të caktuara të shkronjave. Nxënësi/-ja të arsyetojë për të gjetur përgjigjen e saktë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive.			
2. Kompetenca personale Bën vetëvlerësim dhe përdor mendimin kritik e kritikën konstruktive në situata të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: ndërton shprehje të thjeshta algjebrike; nxjerr dhe përdor formula të thjeshta; zëvendëson numra të plotë pozitivë në shprehjet e thjeshta lineare dhe formula.		Fjalë kyç: Po ato të mësimëve të kaluara.	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me fushën e matematikës, gjeometrinë, me fushën e shkencave të natyrës, fizikë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit)			
Për të realizuar këtë temë ,mësuesi /-ja kontrollon detyrat e shtëpisë duke diskutuar në mënyrë të veçantë ushtrimet që nxënësit kanë pasur vështirësi			
Pastaj parashtron situatën që ka menduar më lart dhe kërkon përgjigje.			
Ndërtimi i njohurive të reja (metoda ndërvepruese, vëzhgo-analizo-diskuto)			
Mësuesi punon së bashku me nxënësit ushtrimin 4, 5 në faqen 29 nga libri i nxënësit.			
Diskutohen përgjigjet e dhëna nga nxënësit.			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim)

Mësuesi e ndan klasën në tri grupe.

Grupi i parë punon ushtrimin 6 në faqen 29 nga libri i nxënësit.

Grupi i dytë ushtrimin 5 në faqen 18 nga fletorja e punës.

Grupi i tretë ushtrimin 6 në faqen 18 nga fletorja e punës.

Grupet bëjnë prezantimin e punës së tyre.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve:

- Çfarë quajmë formulë?
- Si mund të jepet formula?
- Cila është radha e veprimeve?
- Si shkruhet x^2 apo $2x$?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 7 dhe 8 në faqen 18 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit: Mësuesi krijon këtë situatë në klasë. Kufiza e tretë e një vargu është 12 dhe kufiza e pestë e vargut është 14. Rregulla e përfitimit është: shtoni një numër të thjeshtë. Cili është ky numër?	
Tema mësimore: 2.10 Përsëritje			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon të dhënat prej burimeve të ndryshme për zgjidhjen e situatave problemore. 2. Kompetenca për jetën sipërmarrjen e mjedisin Përdor simbolet algjebrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe jeta e përditshme.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: përcakton konceptet e marra si: vargu, ndërtimi i vargut, funksioni e të tjera.		Fjalë kyç: Janë fjalët kyç të përdorura gjatë kapitullit.	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe të komunikimit, me fushën e matematikës, gjeometrinë, me fushën e shkencave të natyrës, fizikën.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimin			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Për të realizuar mësuesi parashtron situatën e dhënë më lart dhe kërkon përgjigjen nga nxënësit.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe) Mësuesi bën ndarjen e klasës në grupe sipas niveleve (i parë, i dytë, i tretë, ndarja fillon nga niveli më i ulët)			
Grupi i parë: Punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimi 3 në faqen 30 nga libri i nxënësit.			
Grupi i dytë: Punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 1(a, b, c) nga libri i nxënësit.			
Grupi i tretë: Punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet 6 dhe 7 faqe 30 libri i nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim) Grupet bëjnë prezantimin e punës së tyre. Mësuesi vlerëson punën e bërë dhe evidenton pasaktësi të ndryshme që vë re.			
Vlerësimi: Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi arrin t'u përgjigjet saktë pyetjeve: – Ç'është vargu? – Çfarë quhen numrat e vargut? – Si përcaktohet, nëse vargu është i fundmë apo i pafundmë? – Si ndërtohet një shprehje? – Ç'është funksioni? – Te një funksion, cilat quhen të dhëna dhe cilat quhen rezultate?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 4 dhe 5 në faqen 30 nga libri i nxënësit.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 3.1 Kuptimi i numrave dhjetorë.		Mësuesi krijon këtë situatë në klasë: Shënon dy numra në dërrasë 567 dhe numrin 56,7. Të dy kanë tri shifra të njëjta. Pyet çfarë i dallon këta dy numra?	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</p> <p>1. Kompetenca për jetën sipërmarrjen e mjedisin Zhvillon projekte të ndryshme individuale ose në grup për të përshkruar situata të ndryshme nga jeta e përditshme (përdor numrat dhjetorë).</p> <p>2. Kompetenca e të nxënit Përdor simbole dhe fakte për zgjidhje problemore, që lidhen me numra. Përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve nga jeta reale.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/-ja: shkruan numra të ndryshëm dhjetorë; përcakton në numrin dhjetor pjesën e plotë dhe pjesën dhjetore; vlerëson se çfarë përcakton në numrin dhjetor secila shifër.</p>		<p>Fjalë kyç:</p> <p>numër dhjetorë presje dhjetore rend dhjetor</p>	
<p>Burimet: Libri i nxënësit, Fletorja e punës.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhet me shkencat e natyrës në rastet kur përdoren veprimet me numra; shoqërinë dhe mjedisin.</p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (marrëdhënie pyetje-përgjigje)

Për të realizuar këtë orë, mësuesi kërkon nga nxënësit që të thonë disa numra të plotë, të cilët ai i shkruan në tabelë.

Mbasi shkruan vetë një numër dhjetor, p.sh., 3,12, e lexon atë dhe u kërkon nxënësve që të lëvizin presjen dhe të lexojnë numrin e formuar. Gjithashtu, mësuesi shkruan numrin e plotë 567.

Pyet klasën: Cila është shifra e njësheve? Po e dhjetësheve? Po e qindësheve? Po shifër të mijësheve, ka ky numër? Parashtron situatën e dhënë më lart dhe kërkon përgjigjen.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo –analizo-zbato)

Mësuesi shpjegon se cilët quhen numra dhjetorë dhe çfarë i dallon ata nga numrat e plotë. Tregon se numri dhjetor ka dy pjesë. Mësuesi duhet të ketë të përgatitur një tabelë si ajo që është në libër. Me anën e kësaj tablele, mësuesi duhet të tregojë së çfarë përfaqëson çdo shifër para dhe pas presjes.

Shembulli zgjidhet nga mësuesi së bashku me nxënësit duke marrë pjesë e gjithë klasa.

Vlerën që kanë shifrat në numrat dhjetorë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezanti)

Mësuesi ndan klasën në grupe. Sipas grupeve punohen ushtrimet 1, 2, 3, 4.

Grupet bëjnë prezantimin e punës së tyre në tabelë.

Vlerësimi:

Kjo orë quhet e realizuar nëse nxënësi arrin tu përgjigjet saktë pyetjeve:

Merret një numër dhjetor p.sh., 34,125.

Kërkohet të gjendet nga nxënësit nëse pohimet e mëposhtme janë të vërteta apo jo.

Nëse jo, do të korrigjohen.

a) Pjesa dhjetore është 34 dhe pjesa e plotë është 125.

b) Shifra 3 ka vlerën e dhjetësheve.

c) Shifra 1 ka vlerën e të qindtave.

ç) Shifra 2 ka vlerën e të dhjetave.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 1, 2, 3 në faqen 19 te fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 3.2 Shumëzimi dhe pjesëtimi me 10, 100 dhe 1000		Mësuesi krijon këto situata në klasë: Merr numrin 234 dhe e shumëzon me 10, 100 dhe 1000 . Çfarë ka ndodhur me numrin 234? Po këtë numër e pjesëton me 10, 100 dhe 1000. Çfarë ka ndodhur?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca për jetën sipërmarrjen e mjedisin			
Përdor këtë lloj shumëzimi dhe pjesëtimi në projekte dhe situata të ndryshme nga jeta e përditshme.			
2. Kompetenca digjitale			
Përdor teknologjinë për hartimin e tabelave.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
Nxënësi/-ja: tregon ndryshimet që ndodhin kur një numër shumëzohet me 10, 100 dhe 1000; tregon ndryshimet që ndodhin kur një numër pjesëtohet me 10, 100 dhe 1000; vendos numrat në tabelat e vendvlerës.		numër dhjetor presje dhjetore tabela e vendvlerave	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Lidhet me fushën e gjuhës dhe të komunikimit, lidhet me teknologjinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim)			
Për të realizuar këtë orë, mësuesi duhet të bëjë një parapërgatitje.			
Mësuesi duhet të këtë përgatitur pesë tabelat e mësimit, dy prej të cilave t'i ketë plotësuar, kurse tri të tjerat jo.			
Mirë do të ishte që tabelat të ishin të tilla që ta vësh numrin dhe pastaj ta heqësh dhe ta zëvendësosh me numër tjetër.			
Kjo do të ndihmonte mësuesin që tabelat e vendvlerës të përdreshin dhe në klasat e			

tjera.

Mësuesi kontrollon mësimin e kaluar duke kontrolluar detyrat e shtëpisë dhe duke punuar një nxënës ushtrimin 4 faqe 19 te fletorja e punës.

Më pas mësuesi parashtron situatën e dhënë më lart dhe kërkon përgjigje.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo–analizo–diskuto)

Me dy tabelat e plotësuara mësuesi sqaron ato që janë vendosur në të djathtë të dy tabelave të para. Këto shënime kanë një rëndësi të madhe për numrat dhjetorë.

Pastaj mësuesi punon së bashku me nxënësit shembullin e tekstit duke u tërhequr vëmendjen nxënësve për vendosjen e numrave në tabelën e vendvlerave.

Mbasi ka përfunduar shembullin, ngre nxënës në dërrasë që të punojnë ushtrimin 1 faqe 34 te libri i nxënësit. Mbasi të jenë kryer shumëzimet dhe pjesëtimet, ngre nxënës të tjerë për t'i vendosur në tabelën e vendvlerave numrin para shumëzimit ose pjesëtimet dhe numrin pas kryerjes së veprimit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur, prezantim)

Mësuesi vë në punë pavarur nxënësit për ushtrimin 2 faqe 34.

Qëllimi i punimit të ushtrimit 2 faqe 34 është që nxënësit të dinë se veprimi i shumëzimit dhe i pjesëtimet janë të anasjellë të njëri tjetrit .

Nxënësit bëjnë prezantimin e punës së tyre.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi arrin t'u përgjigjet saktë pyetjeve në lidhje me situatën e krijuar.

Mësuesi merr këta tre numra 034,78; 0,2340 dhe numrin 203,102.

I drejtohet klasës:

Në cilin numër zerot janë të panevojshme?

Pas përgjigjes, kërkon nga klasa vlerën e çdo shifre në të tre numrat.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 1, 2 në faqen 19 te fletorja e punës. Për ushtrimin 1 mësuesi kërkon që nxënësit t'i vendosin në tabelat e vendvlerës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Në dërrasë mësuesi paraqet me anën e ushtrimeve tri situata: $4,5 \blacksquare 10 = 45$; $4,5 \blacksquare 10 = 0,45$; $4,5 \blacksquare 1000 = 4500$. Nxënësit duhet të mendojnë se çfarë veprimi përfaqëson kuadrati.	
Tema mësimore: 3.3 Shumëzimi dhe pjesëtimi me 10, 100 dhe 1000			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të menduarit Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime. 2. Kompetenca e të nxënit Llogarit saktë veprime me mend apo me shkrim duke përdorur strategjitë e përshtatshme me numra. 3. Kompetenca digjitale Përdor teknologjinë për llogaritje me numra.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: tregon se çfarë ndodh kur një numër shumëzohet me 10, 100 dhe 1000; tregon se çfarë ndodh kur një numër pjesëtohet me 10, 100 dhe 1000; vendos numrat në tabelat e vendvlerës.		Fjalë kyç: numër dhjetor presje dhjetore tabela e vendvlerave	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me shkencat shoqërore, lidhet me teknologjinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim)

Mësuesi kontrollon punën e pavarur të nxënësve, duke kontrolluar detyrat ose duke ngritur nxënës në dërrasë për t'i punuar, ato në mënyrë që të ndiqen edhe nga nxënësit e tjerë. Për të vlerësuar nxënien, u jep dhe ushtrime të përgatitura vetë, si ushtrimi 1 faqes 34 te libri i nxënësit, duke iu kërkuar dhe vendosjen në tabelën e vendvlerës. Më pas parashtron situatën e dhënë më lart dhe kërkon përgjigje.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato)

Meqenëse ora e mësimit ka vetëm ushtrime, mësuesi punon së bashku me nxënësit ushtrimin 3 faqes 34 tek libri i nxënësit.

Punon gjithashtu dhe problemën 7. Për problemën mësuesi së bashku me nxënësit duhet të paraqesë saktë të dhënat dhe kërkesën. Të dhënat:

Kërkesa I duhen 1600 gozhdë. Sa kuti duhet të marrë? Kutitë me gozhdë kanë nga 100 copë. Pyet nxënësit se çfarë veprimi duhet të kryejnë?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim)

Klasa ndahet në tri grupe.

Grupi i parë ushtrimin 4(a, ç, e).

Grupi i dytë ushtrimin 4(b, d, ë).

Grupi i tretë ushtrimin 4(c, dh, f).

Grupet prezantojnë punët e tyre në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar nëse, nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve:

– Nëse një numër i plotë shumëzohet me 10, 100 dhe 1000 çfarë bëjmë?

– Nëse një numër dhjetor e pjesëtojmë me 10, 100 dhe 1000 çfarë bëjmë me presjen dhjetore?

Vlerësohet gjithashtu puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimin 5, 6 në faqen 34 te libri i nxënësit dhe 5, 6, 7 faqen 20 te fletorja e nxënësit

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 3.4 Renditja e numrave dhjetorë		Nxënësit krahasojnë numrat e plotë pozitivë dhe negativë. Por si do të krahasohen numrat dhjetorë? Kjo është një situatë që do përgjigje.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të menduarit Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.			
2. Kompetenca e të nxënit Llogarit saktë veprime me mend apo me shkrim duke përdorur strategjitë e përshtatshme me numra.			
3. Kompetenca digjitale Përdor teknologjinë për llogaritje me numra.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: krahason numrat dhjetorë; krahason numrat dhjetorë me numrat e plotë; dallon numrat me pjesë të plotë të ndryshme nga numrat dhjetorë me pjesë të plotë të njëjtë.		Fjalë kyç: numër dhjetor presje dhjetore tabelë e vendvlerave pjesa e plotë pjesa dhjetore	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit; me shkencat shoqërore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Për të realizuar këtë temë, mësuesi përdor ushtrimet e fletës së punës dhe situatën e vendosur në fillim. Klasa dhe një nxënës në dërrasë punojnë ushtrimin 3 faqe 19 te fletorja e punës, përveç kërkesës që ka ushtrimi, nxënësve t’u kërkohet që të bëjnë dhe provën. Pas përfundimit të këtij ushtrimi, një nxënës tjetër ngrihet në dërrasë që të punojë ushtrimin 4 faqe 19 te fletorja e punës. Më pas mësuesi parashtron situatën e			

dhënë më lart.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato)

Mësuesi u shpjegon se çfarë do të quajmë renditje. Në dallim nga numrat e plotë, numrat dhjetorë kanë pjesën e plotë dhe pjesën dhjetore. Te numrat që kanë pjesën dhjetore të ndryshme krahasimi bëhet si te numrat e plotë. Si shembull merr ato të tekstit 8,9; 14, 639 dhe 6,45. Për numrat që pjesën e plotë e kanë të njëjtë, krahasimi fillon nga të dhjetat. Ai që ka të dhjetën më të madhe është më i madh. Nëse të dhjetën e kanë të barabartë, krahasohen të qindtat e kështu me radhë. Mbas këtij sqarimi, mësuesi zhvillon shembullin e tekstit. Mbas shembullit, mësuesi punon ushtrimin 1(a, dhe, f).

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur)

Nxënësit punojnë në punë të pavarur ushtrimet 1 dhe 2 faqe35.

Bëhet zgjidhja e ushtrimeve në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi u përgjigjet saktë pyetjeve:

- Prej sa pjesëve përbëhet një numër dhjetor?
- Nëse numrat dhjetorë pjesën e plotë e kanë të ndryshme, si bëhet krahasimi?
- Nëse numrat dhjetorë pjesën e plotë e kanë të njëjtë, si bëhet krahasimi?

Mbas përgjigjeve të këtyre pyetjeve, mësuesi merr numrat dhjetorë 3,123 dhe 3,0799.

A mund të themi se numri i dytë është më i madh se i pari, sepse të qindtat dhe të mijtat i ka më të mëdha se numri i parë?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 3 në faqen 36 te libri i nxënësit dhe 1 në faqen 20 te fletorja e punës. Mësuesi i lë detyrë një nxënësi që të përgatitë tabelën e ushtrimit 5 në faqen 36 te libri i nxënësit. Tabela të ketë përmasa të tilla që, duke u vendosur në dërrasë, të shihet nga e gjithë klasa.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Nxënësit dinë të krahasojnë numrat e plotë pozitivë dhe negativë, Por si do të krahasohen numrat dhjetorë? Kjo është një situatë që do përgjigje.	
Tema mësimore: 3.5 Renditja e numrave dhjetorë (ushtrime)			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon të dhënat e burimeve të ndryshme për zgjidhjen e situatave problemore. 2. Kompetenca digjitale Përdor teknologjinë për të nxitur informacionin.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: krahason numrat dhjetorë; krahason numrat dhjetorë me numrat e plotë; gjatë krahasimit, ndan numrat me pjesë të plotë të ndryshme dhe numrat dhjetorë me pjesë të plotë të njëjtë.		Fjalë kyç: numër dhjetor presje dhjetore tabelë e vendvlerave pjesa e plotë. pjesa dhjetore shenjat > ; <	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe të komunikimit, lidhet me teknologjinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (marrëdhënie pyetje-përgjigje) Për të realizuar këtë temë, mësuesi përdor kontrollin e detyrave të shtëpisë dhe situatën e vendosur në fillim. Pasi kontrollon detyrat e shtëpisë, mësuesi u tregon nxënësve se, për të treguar numrin më të madh ose më të vogël, përdoren dy simbole > ; <. Mësuesi pyet nxënësit se, nëse në fund të pjesës dhjetore vëmë zero, a ndryshon			

vlera e numrit?

Nëse merr përgjigje negative, mësuesi shkruan numrin 3,210 dhe kërkon nga nxënësi sa e ka shifrën e të mijtave ky numër? Po numri 3,21? Nxënësi kupton që numrat janë të barabartë. (Kjo është sqaruar dhe në tabelën e vendvlerës.)

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto)

Mësuesi punon ushtrimin 4 faqe 36 te libri i nxënësit. Për ta sqaruar këtë ushtrim, do të kihet parasysh ajo që u tha më lart. Me anën e këtij ushtrimi, kur pjesa e plotë e numrave është e njëjtë, nxënësit e kanë më të lehtë për t'i krahasuar këta numra dhjetorë. Mbas këtij ushtrimi, mësuesi përdor tabelën që ia kishte lënë për detyrë një nxënësi, për të zhvilluar ushtrimin 5.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim)

Mësuesi ndan klasën në tre grupe për të zhvilluar ushtrimin 2 faqe 20 fletë pune.

Grupi i parë 2(a, b, c);

Grupi i dytë 2(ç, d, dh)

Grupi i tretë kontrollon zgjidhjet.

Vlerësimi:

Për të vlerësuar të nxënësit e mësimit mësuesi shkruan në dërrasë katër ushtrime me shenjat > ; < ; = dhe kërkon nga nxënësit e dobët nëse janë të sakta shënimet.

$34,12 < 34,1200$; $123,220 = 123,22$; $234,234 < 235,234$; $600 > 599,999$

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 6 në faqen 36 te libri i nxënësit dhe 3, 4, 5 në faqen 20 te fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Mësuesi krijon këtë situatë në klasë. Merr numrin 346 dhe shtron pyetjen: ky numër është më afër 350 apo 340? Merr numrin 34,4 dhe përsëri shtron pyetje: ky numër është më afër numrit 34 apo numrit 35?	
Tema mësimore: 3.6 Rrumbullakimi			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin Përdorimi i sistemit dhjetor në këmbimin e monedhave. 2. Kompetenca e të nxënit Llogarit saktë veprime me mend apo me shkrim duke përdorur strategjitë e përshtatshme me numrat.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: rrumbullakon numrat e plotë dhe numrat dhjetorë; rrumbullakon nga sipër nëse shifra është 5 ose më e madhe se 5; rrumbullakon nga poshtë nëse shifra është 5 ose më e vogël se 5.		Fjalë kyç: rrumbullakim rrumbullakim nga lart rrumbullakim nga poshtë i përafërt	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me shkencat shoqërore në shkëmbimet tregtare, lidhet me fushën e edukimit fizik sportet dhe shëndetin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit) Për të realizuar këtë temë, mësuesi/-ja përdor situatën e vendosur në fillim. Ato që u dhanë në situatën e të nxënit mësuesi i trajton këtu duke bërë sqarimin e			

fjalës rrumbullakim, rrumbullakim nga sipër dhe rrumbullakim nga poshtë.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato)

Për numrat e plotë rrumbullakimi bëhet kështu:

a) sipas 10-shes më të afërt shifra e njësheve, nëse është 5 ose më e madhe se 5 shifrës së 10-shes i shtohet 1.

Nëse shifra e njësheve është e vogël se 5, ajo zëvendësohet me 0.

Mësuesi shtron pyetjen si veprojmë për të bërë rrumbullakimin sipas 100-shes, 1000-shes.

Nëse numri është dhjetor rrumbullakimi sipas njëshes më të afërt shihet shifra e të dhjetave, e kështu me radhë.

Për të sqaruar më mirë mësuesi zhvillon dy shembujt që janë në tekst.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe/praktikë e pavarur)

Mësuesi ndan klasën në grupe për të punuar ushtrimet 1, 2, 3, 4 dhe 5 në faqen 37 nga libri i nxënësit.

Grupet bëjnë prezantimin e punës së tyre.

Vlerësimi:

Nga përgjigjet e nxënësve dhe nga kontrolli i detyrave mësuesi bën vlerësimin e disa prej tyre.

Për të kontrolluar të nxënësit, mësuesi drejton dy pyetje:

- Nëse shifra është 5 ose më e madhe se 5, nga bëhet rrumbullakimi?
- Nëse vlera e shifrës është më e vogël se 5, nga bëhet rrumbullakimi?

Nga nxënësit nën mesataren, mësuesi kërkon nëse rrumbullakimi i numrave të bërë është i saktë apo jo.

Numri 56 i rrumbullakuar 57;

numri 534 i rrumbullakuar 500;

numri 23,61 i rrumbullakuar 23, 7;

numri 2,361 i rrumbullakuar 2,37.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 në faqen 21 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri	Situata e të nxënit Mësuesi shtron këtë situatë: Si vepohet për mbledhjen dhe zbritjen e numrave të plotë? A mund të vepohet kështu dhe për numrat dhjetorë?		
Tema mësimore: 3.7 Mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave me numrat dhjetorë Kompetenca personale Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: mbledh dhe zbret numrat dhjetorë duke e ndarë pjesën e plotë nga pjesa dhjetore; mbledh dhe zbret numrat dhjetorë në kolonë.	Fjalë kyç numër dhjetor pjesa dhjetore rende dhjetore		
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Lidhet me shkencat shoqërore në shkëmbimet tregtare. Lidhet me fushën e edukimit fizik sportet dhe shëndetin.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rimarrje njohurish, diskutim)

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/-ja përdor detyrat e shtëpisë, ushtrimet në fletoren e punës dhe situatën e vendosur në fillim (ose situata të tjera të tjera).

Mësuesi kontrollon detyrat e shtëpisë, bën vërejtjet e nevojshme.

Mbas kontrollit, ndan nxënësit në grupe që të punojnë ushtrimet 5 dhe 6 faqe 21 nga fletorja e punës dhe diskuton zgjidhjet.

Më pas parashtrohet situata e dhënë më lart dhe kërkohet përgjigje nga nxënësit.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato)

Mësuesi jep dy mënyrat e mbledhjes së dy numrave dhjetorë.

E para duke i ndarë pjesët e plota nga pjesët dhjetore dhe dyta duke i vendosur në shtyllë.

Për t'i konkretizuar këto, zhvillohen dy shembujt e temës. Duhet të punohen ngadalë duke sqaruar çdo veprim. Theksohet se mënyra më e mirë për mbledhjen dhe zbritjen është ajo në formë shtylle. Mbledhja dhe zbritja mund të kryhet edhe duke bërë rrumbullakimin e numrave. Por duhet sqaruar se si duhet të vendosen numrat në shtyllë për të kryer veprimin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe, prezantim)

Mësuesi ndan klasën në grupe për të punuar ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 në faqen 39 nga libri i nxënësit.

Te ushtrimi 2 nxënësit duhet të ndihmohen edhe nga mësuesi.

Nxënësit bëjnë prezantimin e punës së tyre në tabelë.

Vlerësimi

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi /-ja arrin t'u përgjigjet saktë pyetjeve:

Mësuesi shkruan mbledhjen dhe zbritjen në shtyllë 3, 32 36, 031 Pyet nxënësit nën mesataren: A janë vendosur mirë në shtyllë numrat dhjetorë?

Nëse jo, si duhen vendosur?

Më tej pyet se cilat janë mënyrat e mbledhjes dhe zbritjes së numrave dhjetorë?

Mësuesi vlerëson gjithashtu edhe punën e bërë në grup dhe bashkëpunimin midis nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 5, 6 dhe 8 nga libri i nxënësit në faqen 39.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri	Situata e të nxënit Mësuesi shtron këtë situatë: Si vepohet për mbledhjen dhe zbritjen e numrave të plotë? A mund të vepohet kështu dhe për numrat dhjetorë?		
Tema mësimore: 3.8 Mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë (ushtrime)			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave me numrat dhjetorë. Kompetenca personale Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: mbledh dhe zbret numrat dhjetorë duke e ndarë pjesën e plotë nga pjesa dhjetore; mbledh dhe zbret numrat dhjetorë në kolonë.	Fjalë kyç numër dhjetor presje dhjetore rend dhjetore		
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit. Lidhet me shkencat e natyrës.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit) Për të realizuar këtë temë, mësuesi/-ja përdor detyrat e shtëpisë ushtrimet në fletoren e punës dhe situatën e vendosur në fillim (ose situata të tjera të vendosura prej tij). Mbas kontrollit të detyrave të shtëpisë, mësuesi bën vërejtjet e nevojshme. Nxënësit punojnë ushtrimet 1 faqe 21 nga fletorja e punës dhe diskutohen zgjidhjet në tabelë. Më pas parashtron situatën e dhënë më lart për diskutim.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato) Punohen ushtrime duke përdorur rumbullakimin e numrave. Merret ushtrimi 2(a) faqe 22 nga fletorja e punës 5,9 + 3,3.			

Duke bërë rrumbullakimin, kemi $6 + 3 = 9$. Ky ushtrim zhvillohet dhe me mënyrat që janë përdorur në mësimin e kaluar $5,9 + 3,3 = 9,2$.

Duke krahasuar rezultatet, ndryshimi është shumë i vogël. Merr dhe 2(d) $9,7 - 4,6 = 5,1$. Duke bërë rrumbullakimin, kemi $10 - 5 = 5$. Prapë del qartë se ndryshimi është i vogël.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe/praktikë e pavarur)

Nxënësit punojnë në punë të pavarur ushtrimin 2 në faqen 22 nga fletorja e punës.

Diskutohen zgjidhjet e dhëna nga nxënësit në tabelë.

Vlerësimi

Mësuesi u kërkon nxënësve se cilat janë mënyrat e mbledhjes së numrave dhjetorë.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 7 në faqen 39 të libri i nxënësit dhe 1, 3, 5 dhe 7 në faqen 22 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 3.9 Shumëzimi i numrave dhjetorë		Mësuesi shtron këtë situatë: Shumëzoni numrin 32 me numrin 2. Pastaj merrni numrin 3,2 dhe kërkonte që të shumëzohet me 2. Si do të veproni?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të menduarit Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.			
2. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për llogaritje me numra.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: shumëzon një numër dhjetor me një numër të plotë; këmbe vendet gjatë shumëzimit të një numri të plotë me një numër dhjetor; kthen ushtrimin duke këmbyer vendet, p.sh., $6 \cdot 6,2 = 6,2 \cdot 6$.		Fjalë kyç: numër dhjetor presje dhjetore pjesa e plotë pjesa dhjetore	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me shkencat shoqërore, lidhet me teknologjinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim, të nxënit në bashkëpunim) Për të realizuar këtë temë, mësuesi/-ja përdor detyrat e shtëpisë, situatën e vendosur në fillim apo situata të tjera. Kontrollon detyrat e shtëpisë. Ngre nxënës në dërrasë duke dhënë ushtrime për t'i mbledhur në kolonë. Pastaj bën vlerësimin e tyre. Mbasi përfundon kontrollin, mësuesi u jep nxënësve një shumëzim numrash $5 \cdot 4$ dhe $4 \cdot 5$. Sa del prodhimi te të dyja shumëzimet? I pyet: Ç'vini re? Përgjigjja: Rezultati del i njëjtë. Më pas mësuesi parashtron situatën e dhënë më lart dhe kërkon përgjigje			

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto)

Mësuesi jep udhëzimin se si do të shumëzohet një numër dhjetor me një numër të plotë.

Janë dy momente.

Momenti i parë: e mendon numrin pa presje, kryen shumëzimin sikur të ishin numra të plotë.

Momenti i dytë: do të vihet presja te prodhimi duke lënë në të djathtë të saj aq shifra sa ka numri me presje.

Zhvillohet shembulli duke sqaruar dy momentet e shumëzimit. Shumëzimi mund të bëhet dhe në kolonë.

Mbasi nxënësit kuptojnë shembullin, ngre në dërrasë nxënës nën mesataren dhe u jep të zhvillojnë ushtrimin 1 në faqen 40 te libri i nxënësit.

Ushtrimi shkruhet në trajtën $5 \cdot 2,7 = 2,7 \cdot 5 = 13,5$.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (praktikë e pavarur, diskutim)

Nxënësit punojnë në punë të pavarur ushtrimet 2(b, c, ç) dhe 3 faqe 40 libri i nxënësit dhe 4 faqe 23 fletorja e punës.

Diskutohen përgjigjet e nxënësve në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi arrin të vlerësojë zgjidhjen e saktë të ushtrimeve më poshtë.

$45,32 \cdot 3 = 13,596$ dhe $0,65 \cdot 2 = 1,30$

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 3, 4 në faqen 40 libri i nxënësit; 2 dhe 4 në faqen 23 te fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Mësuesi merr dy numra, në mënyrë që numri i parë të plotpjesëtohet me numrin e dytë. Pastaj merr një numër dhjetor, të cilin do ta pjesëtojë me një numër të plotë. Deri të presja dhjetore pjesëtimi bëhet si te shembulli i parë. Shtrohet pyetja: Si veprohet me pjesën dhjetore?	
Tema mësimore: 3.10 Pjesëtimi i numrave dhjetorë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon të dhëna të burimeve të ndryshme për realizimin e projekteve në grup. 2. Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranon opinionet e shokëve duke treguar tolerancë. 3. Kompetenca digjitale Përdor teknologjinë për realizimin e projektit në grup.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: pjesëton numrat dhjetorë me një apo dy shifra pas presjes, me një numër të plotë njëshifror.		Fjalë kyç: pjesë dhjetore pjesë e plotë presje dhjetore pjesëtim	
Burimet: Libri i nxënësit, Fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me shkencat shoqërore, lidhet me teknologjinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit) Për të realizuar këtë temë, mësuesi/-ja përdor kontrollin e detyrave të shtëpisë, ushtrimin 3 në faqen 23 nga fletorja e punës dhe situatën e vendosur në fillim. Mësuesi kontrollon detyrat dhe bën vërejtjet e nevojshme. Pastaj ngre në dërrasë një nga nxënësit për të zhvilluar ushtrimin 3 në faqen 23 nga fletorja e punës. Mësuesi mund të ketë përgatitur edhe vetë ushtrime të ngjashme me ato të librit. Më pas parashtron situatën e dhënë më lart.			

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato, të nxënës në bashkëpunim)

Në fillim zbaton ushtrimin që ka dhënë në situatat e të nxënës. Pastaj sqaron se, mbasi ka kryer pjesëtimin e pjesës së plotë, tek herësi vendos presjen.

Pastaj pjesëtimi vazhdon si në rastin e pjesës së plotë. Mësuesi punon së bashku me nxënësit në dërrasë dy ushtrimet e shembullit duke sqaruar çdo hap që bën gjatë pjesëtimin, sidomos kur fillon pjesëtimin me pjesën dhjetore.

Mësuesi duhet të sqarojë që, për plotpjesëtimin me 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, janë po ato kritere si dhe për numrat e plotë, por i vetmi ndryshim është se te numrat e plotë herësi del numër i plotë, kurse këtu del numër dhjetor.

Punohet edhe ushtrimi 5(a). Në këtë rast duhet që dhe nxënësit ta punojnë në fletore. Është e mira që nxënësit të shkruajnë dhe sqarimet që jep mësuesi për këtë tip ushtrimi.

Pastaj mësuesi ngre në dërrasë nxënës për të punuar ushtrimin 1 në faqen 41 nga libri i nxënësit.

Për ushtrimin 5(b) mësuesi duhet të ngrejë në dërrasë nxënësin më të mirë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe, diskutim)

Mësuesi ndan klasën në grupe dyshe për të punuar në punë të pavarur ushtrimet 2, 3, 4 në faqen 41 nga libri i nxënësit.

Diskutohen përgjigjet e nxënësve në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar nëse nxënësi u përgjigjet saktë pyetjeve të dala nga situata e krijuar nga vetë mësuesi:

Mësuesi kryen dy pjesëtime:

Te njëri pjesëtim, te herësi e vendos presjen gabim dhe tek i dyti e vendos mirë.

Pyet nxënësit: A janë kryer mirë pjesëtimet?

Nëse jo, bëni korrigjimin.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 2, 3, 4 në faqen 41 nga libri i nxënësit dhe ushtrimi 6 faqe 23 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 3.11 Vlerësimi dhe përafrimi i një rezultati		Mësuesi merr: dy numra dhe gjen shumën; dy numra dhe gjen diferencën; dy numra dhe gjen prodhimin; dy numra dhe gjen herësin. Pastaj shtron pyetjen: Si do të provojmë që rezultati është i saktë?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon të dhëna të burimeve të ndryshme për realizimin e projekteve.			
2. Kompetenca qytetare Zbaton dhe respekton rregullat e punës në grup.			
3. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç;	
Nxënësi/-ja: kryen katër veprimet: mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim; bën provën e veprimit të kryer; kontrollon rezultatin edhe me anë të rrumbullakimit.		vlerësim veprim i kundërt	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me shkencat shoqërore, lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Për të realizuar këtë orë, mësuesi/-ja përdor kontrollin e detyrave të shtëpisë, ushtrime nga fleta e punës dhe nga libri i nxënësit, si dhe situatën e vendosur në fillim.			

Kontrollon ushtrimet duke ngritur në dërrasë nxënës për të punuar disa nga ushtrimet e shtëpisë.

Pastaj, nëse e shikon të arsyeshme, mund të pyesë një nga nxënësit e ngritur duke i dhënë ushtrimin 5(a) në faqen 41 nga libri i nxënësi dhe 4 në faqen 23 nga fletorja e punës. Më pas parashtron situatën e dhënë më lart.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato, metoda ndërvepruese)

Mësuesi kontrollon nëpërmjet pyetjeve se si bëhet rrumbullakimi i numrave.

Pastaj u jep përgjigje pyetjeve që ka dhënë në situatën e të nxënës.

Zhvillon shembullin A dhe B duke i sqaruar mirë etapat që kalon në çdo ushtrim. Pastaj ngre në dërrasë nxënës për të punuar ushtrimet 1 dhe 2 faqe 43 nga libri i nxënësit dhe ushtrimin 1 faqe 24 nga fletorja e punës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur, prezantim)

Nxënësit punojnë në punë të pavarur ushtrimin 3 në faqen 43 nga libri i nxënësit dhe 2 në faqen 24 nga fletorja e punës.

Nxënësit prezantojnë punën e tyre në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme:

- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është mbledhje?
- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është zbritje?
- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është shumëzim?
- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është pjesëtim?
- Si bëhet rrumbullakimi i numrave?

Të vlerësohet gjithashtu puna e bërë dhe bashkëpunimi midis nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 3, 4 në faqen 43 nga libri i nxënësit dhe 2 në faqen 24 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 3.12 Vlerësimi dhe përafrimi i një rezultati		Mësuesi merr: dy numra dhe gjen shumën; dy numra dhe gjen diferencën; dy numra dhe gjen prodhimin; dy numra dhe gjen herësin. Pastaj shtron pyetjen: Si do ta provojmë se rezultati është i saktë?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon të dhëna të burimeve të ndryshme për realizimin e projekteve.			
2. Kompetenca qytetare Zbaton dhe respekton rregullat e punës në grup.			
3. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: shumëzon dhe pjesëton numrat dhjetorë me numra njëshifrorë; bën një vlerësim të përafërt; përdor veprimin e kundërt dhe vlerësimin për të bërë provën e një rezultati.		Fjalë kyç: vlerësim veprim i kundërt rumbullakim	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me shkencat shoqërore, lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit) Vepron si në temën 3. 11. Por ushtrimet që jep në dërrasë janë 3 faqe 43 nga libri i nxënësit.			

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato)

Zhvillon ushtrimin 4 në faqen 43 nga libri i nxënësit dhe 3 në faqen 24 nga fletorja e punës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim)

Për të realizuar këtë rubrikë, mësuesi ka përgatitur paraprakisht ushtrime të ngjashme me ato që punoi gjatë orës së mësimit.

Bën ndarjen e klasës në grupe duke pajisur secilin grup me ushtrimet përkatëse.

Grupet bëjnë prezantimin e punës së tyre në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme:

- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është mbledhje?
- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është zbritje?
- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është shumëzim?
- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është pjesëtim?
- Si bëhet rumbullakimi i numrave?

Të vlerësohet gjithashtu bashkëpunimi midis nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrime për detyrë mësuesi krijon vetë si ushtrimet që punoi gjatë orës së mësimit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: E njëjtë si në mësimin 3. 11.	
Tema mësimore: 3.13 Vlerësimi dhe përafrimi i një rezultati			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e të menduarit Zgjidh arsyetën përzgjedh strategji për zgjidhjen e problemeve.			
2. Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin Zhvillon projekte individuale dhe në grup.			
3. Kompetenca qytetare Zbaton dhe respekton rregullat e punës në grup.			
4. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon të dhënat dhe kërkesën e një probleme; përcakton pyetjet për të zgjidhur problemën; zgjidh problemën; bën provën, nëse ka gjetur rezultatin e kërkuar. 		Fjalë kyç: të dhënat e problemës kërkesa e problemës	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me shkencat shoqërore, lidhet me teknologjinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rimarrje njohurish) Vepron si në temën 3. 11. Por ushtrimet që jep në dërrasë duhet të jenë përgatitur nga vetë mësuesi			

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato)

Për të realizuar këtë rubrikë, mësuesi përdor shembullin C në libër në faqen 43 dhe zgjidh problemat 5 dhe 6 në faqen 44 nga libri i nxënësit dhe problemën 4 nga fletorja e punës.

Mësuesi zgjidh së bashku me nxënësit dy problemat e shembullin C.

Mësuesi për të dyja problemat duhet që të udhëzojë nxënësit se si zgjidhen, pavarësisht se mund të jenë të thjeshta. Të caktojë çfarë dihet dhe çfarë duhet gjetur. Ngre në dërrasë nga një nxënës për të zgjidhur problemat 5 dhe 6 në faqen 44 nga libri i nxënësit dhe problemën 4 nga fletorja e punës.

Për këtë ushtrimin e fundit duhet të ngrihet një nxënës mbi mesataren.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (praktikë e pavarur, diskutim)

Nxënësit bëjnë punë të pavarur për problemën 7 në faqen 44 nga libri i nxënësit dhe 5, 6 në faqen 24 nga fletorja e punës.

Diskutohen në tabelë zgjidhjet e dhëna nga nxënësit.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme:

- Me ç’veprim bëhet prova nëse veprimi është mbledhje?
- Me ç’veprim bëhet prova nëse veprimi është zbritje?
- Me ç’veprim bëhet prova nëse veprimi është shumëzim?
- Me ç’veprim bëhet prova nëse veprimi është pjesëtim?
- Si bëhet rrumbullakimi i numrave?
- Çfarë duhet të bëjmë në fillim për të zgjidhur një problemë?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Problemat 7 në faqen 44 nga libri i nxënësit dhe 5, 6 në faqen 24 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 3.14 Përsëritje		Si në mësimet e kaluara.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
<p>1. Kompetenca e të menduarit. Arsyeton dhe përzgjedh strategjitë e duhura për zgjidhjen e problemave.</p> <p>2. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon njohuritë e marra gjatë kapitullit për zgjidhjen e ushtrimeve dhe problemave.</p> <p>3. Kompetenca qytetare Zbaton rregullat e punës së pavarur, respekton shokët.</p>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
<p>Nxënësi/-ja: dallon pjesën e plotë me pjesën dhjetore; kryen mbledhje dhe zbritjen e numrave dhjetorë; kryen shumëzimin e numrit dhjetor me numrin e plotë; kryen pjesëtimin e numrit dhjetor me numrin e plotë njëshifror.</p>		<p>numër dhjetor pjesa e plotë pjesa dhjetore pjesëtim rrumbullakim</p>	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		<p>Lidhet me fushën me shkencat shoqërore, lidhet me shkencat e natyrës.</p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (kontroll njohurish)			
<p>Për të realizuar këtë rubrikë mësuesi /-ja përdor situata të ndryshme të krijuar nga vetë ai dhe detyrat e shtëpisë.</p> <p>Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe bën vlerësimet e nevojshme.</p>			
Ndërtimi i njohurive të reja (metoda ndërvepruese)			

Meqenëse është përsëritje, mësuesi punon ushtrimin 8 dhe pastaj ngre nxënës nën mesataren për ushtrimet 1, 2, 3, 4 në faqen 45 nga libri i nxënësit. Nxënësit mbi mesataren punojnë ushtrimet 13 dhe 14 në faqen 45 nga libri i nxënësit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (praktikë e pavarur, diskutim)

Nxënësit punojnë punë të pavarur ushtrimet 5, 6, 7, 10, 11 faqe 45 libri i nxënësit
Diskutohen zgjidhjet e nxënësve në tabelë.

Mësuesi sqaron pasaktësi të ndryshme që vë re gjatë diskutimit të zgjidhjeve në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme:

- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është mbledhje?
- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është zbritje?
- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është shumëzim?
- Me ç’veprim bëhet prova, nëse veprimi është pjesëtim?
- Si bëhet rrumbullakimi i numrave?
- Çfarë duhet të bëjmë në fillim për të zgjidhur një problemë?

Të vlerësohet gjithashtu puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 5, 6, 7, 10, 11 në faqen 45 të libri i nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Matja	Situata e të nxënit: Kemi për të matur largësinë nga Tirana në Elbasan. – Çfarë njësie do të përdorim? Kemi për të matur gjatësinë e një lapsi. – Çfarë njësie do të përdorim? Kemi për të shprehur masën e një makine. Çfarë njësie do të përdorim? Kemi për të shprehur masën e një domateje. – Çfarë njësie do të përdorim?		
Tema mësimore: 4.1 Njohja e njësive matëse			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të menduarit Kupton sistemet e matjes në jetën e përditshme duke i përdorur ato për të vlerësuar, matur dhe llogaritur. 2. Kompetenca personale Bën vetëvlerësim dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme. 3. Kompetenca qytetare Respekton punën dhe rezultatet e shokut.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: kthen njësitë më të vogla në njësi më të mëdha; kthen njësitë e mëdha në njësi më të vogla.	Fjalë kyç: njësi matëse gjatësi milimetër centimetër metër kilometër masë gram kilogram ton kapacitet mililitër litër		
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, tabela me njësitë matëse.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e edukimit fizik, sportet dhe shëndetin, matjen e largësive në garat e vrapimit, kohës, lidhet me fushën e arteve, kryerja e matjeve në një vepër arti.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (marrëdhënie pyetje-përgjigje)

Për të realizuar këtë rubrikë mësuesi/-ja përdor kontrollin e detyrave të shtëpisë dhe situatën e të nxëniet të vendosur në fillim(ose situata të tjera të vendosura prej tij/saj) Kontrollon detyrat e shtëpisë. Parashtron ato që janë tek situatat e të nxëniet. Kërkon përgjigje nga nxënësit.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato)

Mësimin e fillon me njësitet matëse për gjatësitë, masën dhe kapacitetin.

Mësuesi duhet të ketë përgatitur një tabelë si ajo që është në libër.

Në këtë tabelë të ketë vendosur dhe kthimin e njësive të mëdha në njësi të vogla

Me anën e kësaj tabele mësuesi sqaron nxënësit se kur kryhet shumëzimi apo pjesëtimi me një fuqi të dhjetës.

Mbas këtyre sqarimeve, mësuesi zhvillon shembullin që është në tekst.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe)

Ndahet klasa në grupe.

Zhvillojnë ushtrimin 1 dhe 3 faqe 48 nga libri i nxënësit dhe 1 dhe 3 faqe 25 nga fletorja e punës.

Diskutohen zgjidhjet e dhëna nga nxënësit në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t’u përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme:

– Cilat janë njësitet e gjatësisë?

– Cilat janë njësitet e masës?

– Cilat janë njësitet e kapacitetit?

– Për të kaluar nga njësitet matëse më të vogla në njësitet matëse më të mëdha, çfarë veprimi kryejmë?

– Për të kaluar nga njësitet matëse më të mëdha në njësitet matëse më të vogla, çfarë veprimi kryejmë?

Të vlerësohet gjithashtu puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 2, 4, 5 në faqen 48 nga libri i nxënësit dhe 2, 4 në faqen 25 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Matja		Situata e të nxënit: Kemi për të matur distancën nga Tirana në Elbasan. – Çfarë njësie do të përdorim? Kemi për të matur gjatësinë e një lapsi. – Çfarë njësie do të përdorim? Kemi për të shprehur masën e një makine. – Çfarë njësie do të përdorim? Kemi për të shprehur masën e një domateje. – Çfarë njësie do të përdorim?	
Tema mësimore: 4.2 Njohja e njësive matëse			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon njohuritë e marra rreth njësive të matjes për zgjidhjen e ushtrimeve. 2. Kompetenca digjitale Përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: kthen njësitë më të vogla në njësi më të mëdha; kthen njësitë e mëdha në njësi më të vogla.		Fjalë kyç: njësi matëse gjatësi milimetër metër centimetër kilometër masë gram kilogram ton kapacitet mililitër litër	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e edukimit fizik, sportet dhe shëndetin, matja e largësive në garat e vrapimit; kohës, lidhet me fushën e arteve, kryerja e matjeve në një vepër arti, lidhet me teknologjinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit)

Për të realizuar këtë rubrikë mësuesi/-ja përdor kontrollin e detyrave të shtëpisë situatën e vendosur në fillim (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij).

Kontrollon detyrat e shtëpisë identifikon gabimet, bën sqarimin e tyre.

Parashtron ato që janë tek situatat e të nxënësve.

Analizon situatat e paraqitura së bashku me nxënësit dhe shkruan përgjigjet e sakta në tabelë.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato)

Punon me klasën ushtrimin 8, 9 në faqen 48 nga libri i nxënësit dhe ushtrimin 5 në faqen 25 nga fletorja e punës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, diskutim)

Mësuesi ndan klasën në grupe.

Zhvillojnë ushtrimin 6 dhe 7 në faqen 48 nga libri i nxënësit dhe 4 në faqen 25 nga fletorja e punës.

Diskutohen zgjidhjet e dhëna nga nxënësit në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar nëse nxënësi/-ja arrin tu përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme:

– Cilat janë njësitet e gjatësisë?

– Cilat janë njësitet e masës?

– Cilat janë njësitet e kapacitetit?

– Për të kaluar nga njësitet matëse më të vogla në njësitet matëse më të mëdha, çfarë veprimi kryejmë?

– Për të kaluar nga njësitet matëse më të mëdha në njësitet matëse më të vogla, çfarë veprimi kryejmë?

Të vlerësohet gjithashtu puna e bërë në grupe dhe bashkëpunimi midis nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 3, 6, 7 në faqen 48 nga libri i nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Matja		Situata e të nxënit: Dihet që njësitë e gjatësisë janë mm, cm, m, km etj., por jo çdo gjatësi matet me secilën nga këto njësi. Po kështu, edhe për njësitë e masës dhe të kapacitetit. Duke vërejtur me kujdes, duhet të zgjedhim ato njësi që i përshtaten objektit që duam të matim.	
Tema mësimore: 4.3 Zgjedhja e njësive të përshtatshme			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve me matjet. 2. Kompetenca personale Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: përzgjedh njësinë e përshtatshme të matjes në varësi të objektit.		Fjalë kyç: njësi matëse gjatësi milimetër centimetër metër kilometër masë gram kilogram ton kapacitet mililitër litër	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me shkencat e natyrës, matja e gjatësive, lidhet me edukimin fizik, sportet dhe shëndetin, matjet antropometrike të nxënësve.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjeti i diskutimit)

Për të realizuar këtë rubrikë, mësuesi/-ja përdor kontrollin e detyrave të shtëpisë dhe ushtrimet 6, 7, 8 faqe 25 nga fletorja e punës.

Kontrollon detyrat e shtëpisë, identifikon gabimet, bën sqarimin e tyre

Diskuton dhe zgjidh së bashku me nxënësit ushtrimet 6, 7, 8 në faqen 25 nga fletorja e punës. Mund të bëjë dhe vlerësimin e tyre me notë.

Ndërtimi i njohurive të reja (metoda ndërvepruese, vëzhgo-analizo-zbato)

Për të realizuar këtë rubrikë, mësuesi/-ja përdor situatën e vendosur në fillim ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij dhe ushtrimin 1 në faqen 49 nga libri i nxënësit dhe ushtrimin 4 në faqen 26 nga fletorja e punës.

Mësuesi kërkon sqarime për ato që ka në situatën e të nxënësit. Mbas kësaj, punon në dërrasë shembullin e librit duke sqaruar mirë ato që kërkohen. Pastaj punon bashkë me nxënësit ushtrimin 1 në faqen 49 nga libri i nxënësit dhe ushtrimin 4 në faqen 26 nga fletorja e punës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, diskutim)

Mësuesi ndan klasën në grupe.

Zhvillojnë ushtrimin 3 në faqen 49 nga libri i nxënësit dhe 2 në faqen 26 nga fletorja e punës.

Diskutohen zgjidhjet e dhëna nga nxënësit në tabelë.

Vlerësimi:

Ora quhet e realizuar nëse nxënësi/-ja arrin tu përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme:

– Cilat janë njësitet e gjatësisë?

– Cilat janë njësitet e masës?

– Cilat janë njësitet e kapacitetit?

– Për të kaluar nga njësitet matëse më të vogla në njësitet matëse më të mëdha, çfarë veprimi kryejmë?

– Për të kaluar nga njësitet matëse më të mëdha në njësitet matëse më të vogla, çfarë veprimi kryejmë?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 2, 3 faqe 49 nga libri i nxënësit dhe 1, 2 faqe 26 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Matja		Situata e të nxënit: Mësuesi duhet të ketë një vizore dhe një enë të shkallëzuar. Si do të bëjmë leximin për gjatësinë, kapacitetin dhe masën? Kjo situatë do t’u shtrohet nxënësve.	
Tema mësimore: 4.4 Leximi i përshkallëzimit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e të menduarit Zgjidh njësitë e duhura matëse për situata të caktuara. 2. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon njohuritë e marra për njësitë e matjes për zgjidhjen e ushtrimeve e problemave.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: njeh mjetet matëse; lexon përshkallëzimet në një mjet matës		Fjalë kyç: vlerësim përshkallëzim ndarje	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, Vizore, enë të shkallëzuara për të përcaktuar kapacitetin, mjet i thjeshtë peshimi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me fizikën, për kuptimin e peshës, gjatësisë dhe kapacitetit.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rimarrje njohurish) Për të realizuar këtë rubrikë, mësuesi/-ja përdor kontrollin e detyrave të shtëpisë dhe mjetet matëse. Mbas kontrollit, mësuesi merret me mjetet e matjes. Mësuesi duhet të ketë mjete matëse. Që mësimi të përvetësohet nga nxënësit, duhet që dhe në çdo bankë të ketë mjete matëse. Mësuesi i sqaron se si bëhet leximi me këto mjete.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-zbato, të nxënit në bashkëpunim) Mbasi ka sqaruar përdorimin e mjeteve matëse, mësuesi zhvillon së bashku me nxënësit shembullin që është në tekst. Nëse nxënësit nuk kanë mjete matëse, kërkon që ata të vizatojnë në fletoret e klasës figurat e ushtrimit 1. Pastaj klasën e ndan në dy grupe. Grupi I ushtrimi 1(a, b, c); Grupit II ushtrimin 1 (ç, d, dh). Mbasi nxënësit t’i kenë përfunduar, ngre nga një përfaqësues që të japë leximet, nëse ka gabim njëri grup kërkon që ta korrigjojë grupi tjetër.			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, diskutim)

Mësuesi e ndan klasën në grupe.

Grupit të parë ushtrimin 3 dhe 4 faqe 51 tek libri i nxënësit.

Grupit të dytë ushtrimin 3, 4 faqe 27 nga fletorja e punës.

Diskutohen zgjidhjet e nxënësve në tabelë.

Vlerësimi:

Për të vlerësuar të nxënësit, mësuesi merr vizoren e shkallëzuar dhe kërkon nga nxënësi se çfarë përfaqëson një ndarje në të.

Të njëjtën gjë bën dhe me mjetet e tjera matëse nëse i ka.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 1, 2, 3, 4 në faqen 27 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Matja		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 4.5 Përsëritje		Është po ajo situatë që jepet në mësimin e kaluar	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
<p>1. Kompetenca e të menduarit Zgjidh njësitë e duhura matëse për situata të caktuara.</p> <p>2. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon njohuritë e marra për njësitë e matjes për zgjidhjen e ushtrimeve e problemave.</p>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Rezultatet e gjithë kapitullit.		Fjalë kyç Janë të gjitha fjalët kyç të kapitullit.	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, Vizore, enë të shkallëzuara për të përcaktuar kapacitetin, mjet i thjeshtë peshimi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me fizikën, për kuptimin e peshës, gjatësisë dhe kapaciteti. Me fushën e arteve për të përcaktuar matjet e hapësirave të ndryshme.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimin			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Diskutim: Përdorimi i njësive matëse në fusha të ndryshme. Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe bën vlerësimet e nevojshme.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe) Klasa ndahet në tri grupe. Grupi i parë punon ushtrimin 1. Grupi i dytë punon ushtrimin 2. Grupi i tretë punon ushtrimin 3 në faqen 52 nga libri i nxënësit. Pastaj punohen ushtrimet 9 dhe 10 në faqen 52 nga libri i nxënësit. Me këto dy ushtrimet e fundit sqarohet dhe një herë se si bëhet leximi i përshkallëzimeve.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantime) Mbas përfundimit të ushtrimeve, secili grup paraqet punën.			
Vlerësimi: Ora quhet e realizuar, nëse nxënësi/-ja arrin t'u përgjigjet saktë pyetjeve të mëposhtme: – Cilat janë njësitë e gjatësisë? – Cilat janë njësitë e masës? – Cilat janë njësitë e kapacitetit? – Për të kaluar nga njësitë matëse më të vogla në njësitë matëse më të mëdha, çfarë veprimi kryejmë? – Për të kaluar nga njësitë matëse më të mëdha në njësitë matëse më të vogla, çfarë veprimi kryejmë? Të vlerësohet gjithashtu puna e bërë në grupe dhe bashkëpunimi midis nxënësve.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 4, 5, 6, 7 dhe 8 në faqen 52 nga libri i nxënësit.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit Mësuesi krijon këtë situatë. Merr një pikë në dërrasë dhe ndërton dy gjysmëdrejtëza [OA) dhe [OB). Çfarë formohen? Me çfarë njësie maten këndet? Si të përcaktojmë masat e këtyre këndeve?	
Tema mësimore: 5.1. Emërimi dhe vlerësimi i masës së këndeve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Kompetenca e të menduarit. Organizon lidhjet konceptuale të njohurive.			
Kompetenca e të nxënit Demonstron kuriozitet për gjeometrinë.			
Kompetenca personale Demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: dallon drejtëzën nga gjysmëdrejtëza; emërton drejtëzën, gjysmëdrejtëzën dhe këndet; dallon këndet e kundërta në kulm, të cilat janë të barabarta ndërmjet tyre; mat këndet me raportor.		Fjalë kyç kënd gradë kënd i drejtë kënd i ngushtë kënd i gjerë kënd i shtrirë kënd reflektiv segment drejtëz gjysmëdrejtëz raportor	
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës. 3. Raportori.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Me artet në përdorimin e figurave gjeometrike. Shkenca e natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (parashtrimi i situatës)

Mësuesi duhet të ketë njoftuar nxënësit që të pajisen me raportor. Meqenëse mësimi ka shumë koncepte mësuesi gjatë gjithë orës duhet të merret me temën e mësimit.

Mësuesi u parashtron nxënëse situatë e dhënë më lart dhe kërkon përgjigje.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo – analizo – zbato)

Në fillim mësuesi bën emërtimin e objekteve të reja si, segment, drejtëz, gjysmëdrejtëz, kënd dhe të gjitha llojet e këndeve. Këto duhet t'i ndërtojë në dërrasë me vizore.

Gjithashtu duhet t'u shpjegojë se këndet maten me raportor. Pastaj punon me shembullin. Më pas punon ushtrimet 1, 2, 3 faqe 55 nga libri i nxënësit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë me grupe, prezantim)

Klasa ndahet në dy grupe.

Grupit të parë i jep ushtrimin 4 dhe grupit të dytë ushtrimin 5 faqe 55 nga libri i nxënësit.

Për të parë se sa janë në gjendje të matin këndet, bëhet edhe kontrolli i matjeve nga nxënësit.

Vlerësimi

Për të vlerësuar të nxënësit e mësimit, mësuesi drejton këto pyetje

1. Si formohet këndi?
2. Cilat janë elementet e një këndi?
3. Si shkruhet këndi?
4. Cili quhet kënd i ngushtë, i drejtë, i gjerë, reflektiv?
5. Si shkruhet drejtëza dhe gjysmëdrejtëza?

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 1, 2, 3 faqe 28 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria	Situata e të nxënit Mësuesi vizaton dy gjysmëdrejtëza [OA) dhe [OB) Formohen dy kënde njëri prej të cilëve është reflektiv. Si do të matet ky kënd, kur raportori nuk ka kënd më të madh se 180° ?		
Tema mësimore: 5.2. Ndërtimi dhe matja e këndeve			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit. Organizon lidhjet konceptuale të njohurive. Kompetenca e të nxënit Demonstron kuriozitet për gjeometrinë. Kompetenca personale Demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: përcakton me afërsi këndin, pa e matur atë; mat me raportor çfarëdo lloj këndi që mund t'i jepet; ndërton këndin kur jepet masa e tij.	Fjalë kyç kënd gradë kënd i drejtë kënd i ngushtë kënd i gjerë kënd i shtrirë kënd reflektiv segment drejtëz gjysmëdrejtëz raportor		
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës. 3. Raportori.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Me artet në përdorimin e figurave gjeometrike. Shkenca e natyrës.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rimarrje njohurish)

Kontrollon detyrat e shtëpisë, duke kontrolluar edhe saktësinë e matjeve. Pastaj kërkon nga nxënësit që të matin këndet e ushtrimit 4 faqe 28 nga fletorja e punës. Më shumë përqendrohet te mënyra e matjes së këndeve c, ç dhe d. Më pas parashtrohet situata e dhënë më lart duke kërkuar përgjigje.

Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto)

Kërkon nga nxënësit që të kenë hapur librat dhe të kenë raportorin. Punon ushtrimin e zgjidhur sipas dy metodave për këndet refleksive. I sqaron mirë këto dy metoda se këndet refleksive janë më të mëdha se dy kënde të drejta dhe raportori nuk mat kënde më të mëdha se 180° .

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur)

Nxënësit i vë në punë për të matur këndet e ushtrimit 1 në faqen 56 nga libri i nxënësit. Mbas përfundimit të ushtrimit ngre në dërrasë tre nxënës për të vizatuar këndet e dhëna në ushtrimin 2.

Vlerësimi

Për të vlerësuar të nxënit e mësimit, shtrohen këto pyetje

1. Si formohet këndi?
2. Cilat janë elementet e një këndi?
3. Si shkruhet këndi?
4. Cili quhet kënd i ngushtë, i drejtë, i gjerë, reflektiv?
5. Si shkruhet drejtëza dhe gjysmë drejtëza?
6. Si dhe me se maten këndet?

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 3, 4, 5 faqe 57 nga libri i nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit Nëse kemi një trekëndësh, një katërkëndësh apo një shumëkëndësh çfarëdo, si do të veprojmë për të gjetur shumën e këndeve?	
Tema mësimore: 5.3. Llogaritja e këndeve			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit. Organizon lidhjet konceptuale të njohurive. Kompetenca e të nxënit Demonstron kuriozitet për gjeometrinë. Kompetenca personale Demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: gjen masën e këndeve të çfarëdoshme.		Fjalë kyç trekëndësh shuma e masës së këndeve të trekëndëshit	
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës. 3. Raportori.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Me artet në përdorimin e figurave gjeometrike. Shkenca e natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rikujtim njohurish) Mbasi kontrollon detyrat, jep për të punuar ushtrimin 3 në faqen 28 të fletorja e punës. Pastaj ngre dy nxënës dhe kërkon që njëri të vizatojë një trekëndësh dhe tjetri një katërkëndësh, me vizore jo me dorë të lirë. Më pas parashtron situatën e dhënë më lart dhe kërkon përgjigje.			

Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar)

Nxirren tri pohimet e rëndësishme.

Këndi i plotë është një rrotullim i plotë dhe masa e tij është 360° .

Këndi i shtrirë është një gjysmë rrotullimi dhe masa e tij është 180° .

Shuma e këndeve të një trekëndëshi është 180° .

Pohimin e fundit, nxënësit e nxjerrin duke gjetur masat e tri këndeve të trekëndëshit duke i mbledhur ata. Në katërkëndësh ndërtohet një diagonal. Çfarë ndodhi me katërkëndëshin? Përgjigjja do të jetë: U formuan dy trekëndësha. I drejton klasës pyetjen: Si mendoni, sa do të jetë shuma e këndeve të katërkëndëshit?. Mbas përgjigjes, ngre një nxënës që të matë këndet e katërkëndëshit dhe gjen shumën e tyre. Më pas mësuesi punon shembullin e zgjidhur.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur)

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet 1 dhe 2 në faqen 58 nga libri i nxënësit.

Vlerësimi

Për të vlerësuar të nxënësit, drejtohen këto pyetje:

1. Cili quhet kënd i plotë dhe sa është masa e tij?
2. Cili quhet kënd i shtrirë dhe sa është masa e tij?
3. Sa është shuma e masave të këndeve të një trekëndëshi?
4. Sa është shuma e masave e këndeve një katërkëndëshi?

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 3, 4, 5, 6, 7 në faqen 59 nga libri i nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit Nëse kemi një trekëndësh, një katërkëndësh apo një shumëkëndësh çfarëdo, si do të veprojmë për të gjetur shumën e këndeve?	
Tema mësimore: 5.4 Llogaritja e këndeve. Ushtrime			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit. Organizon lidhjet konceptuale të njohurive. Kompetenca e të nxënit Demonstron kuriozitet për gjeometrinë. Kompetenca personale Demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: gjen masën e këndeve të çfarëdoshme.		Fjalë kyç trekëndësh. shuma e masës së këndeve të trekëndëshit	
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës. 3. Raportori.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Me artet në përdorimin e figurave gjeometrike. Shkencat e natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Kontrollon detyrat e shtëpisë duke bërë dhe vlerësime. Një nxënës punon në dërrasë ushtrimet 8, 9, 10 në faqen 59 nga libri i nxënësit dhe diskutojnë nxënësit. Më pas parashtron situatën e dhënë më lart dhe kërkon përgjigje.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar) Mësuesi ngre në dërrasë një nxënës që të vizatojë figurat e ushtrimit 4 nga fletorja e punës faqe 32. Gjatë kësaj kohe kërkon që të punojnë ushtrimet 1 dhe 2 në faqen 31, 32 nga fletorja e punës. Mbasi t'i kenë përfunduar, kërkon masat e këndeve që duheshin gjetur.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur) Mbas përfundimit të këtyre ushtrimeve, punohet ushtrimin 4 në faqe 32 nga fletorja e punës, figurat e të cilit janë në dërrasë.			
Vlerësimi Për të vlerësuar të nxënit, mësuesi drejton këto pyetje: 1. Cili quhet kënd i plotë dhe sa është masa e tij? 2. Cili quhet kënd i shtrirë dhe sa është masa e tij? 3. Sa është shuma e masave të këndeve të një trekëndëshi? 4. Sa është shuma e masave të një katërkëndëshi? 5. Me se dhe si maten këndet?			
Detyrat dhe puna e pavarur Ushtrimet 5, 6, 7, 8 në faqen 32 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit	
Tema mësimore: 5.5. Zgjidhje problemash me kënde		Marrim dy drejtëza që priten dhe jepet masa e njërit kënd. Si do të gjejmë masën e këndeve të tjera? Jepen dy drejtëza paralele që priten nga një drejtëz e tretë shtrohet pyetja nëse jepet një kënd, a kemi mundësi të gjejmë masën e shtatë këndeve të tjera?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Kompetenca e të menduarit Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave në gjeometri.			
Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalë kyç	
Nxënësi/-ja: - përdor në problema të thjeshta shumën e këndeve të trekëndëshit dhe të katërkëndëshit; - zgjidh problema të thjeshta me kënde; - përdor pohimin se këndet e kundërta në kulm janë të barabarta.		kënde të kundërta në kulm kënde me një brinjë të përbashkët dhe një brinjë në shtrirje të njëra-tjetrës drejtëz prerëse trekëndëshi dybrinjënjëshëm	
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës. 3. Raportori. 4. Vizorja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Me artet në përdorimin e figurave gjeometrike. Shkenca e natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjet diskutimi)			
Kontrollon detyrat e shtëpisë duke bërë vërejtjet e nevojshme. Pastaj ngre në dërrasë një nxënës të vizatojë ato që janë dhënë në situatën e të nxënit dhe i drejtohet klasës po			

me pyetjen e dhënë aty.

Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar)

Mbas përgjigjeve të marra, mësuesi trajton pjesën e parë të mësimit, ku shpjegon konceptet që jepen aty. Ushtrimi 1: këndi APC + këndin APD = këndin CPD = 180° (sepse është kënd i shtrirë)(1). Për të njëjtën arsye këndi BPD + këndi APD = 180° (2) Nga barazimet (1) dhe (2), del se këndi APC + këndin APD = këndi BPD + këndi APD. Nga barazimi i fundit, del se këndi APC = këndi BPD, çfarë deshëm të vërtetonim.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim)

Ushtrimet 2, 3, 4 në faqen 60 i zgjidhin nxënësit në grupe dhe i prezantojnë para klasës.

Vlerësimi

Për të vlerësuar të nxënët mësuesi drejton këto pyetje:

- Cilat quhen kënde të kundërta në kulm dhe si janë ndërmjet tyre?
- Sa kënde formohen nga prerja e dy drejtëzave paralele nga një prerëse dhe cilat janë kënde të barabarta?
- Kur dy drejtëza janë pingule?
- Kur trekëndëshat janë dybrinjënjëshëm?

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 4, 5, 6, 7 në faqen 61 nga libri i nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit Do të kihet parasysh situata e mësimit të kaluar.	
Tema mësimore: 5.6 Zgjidhje problemash me kënde			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave në gjeometri. Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: - përdor në problema të thjeshta shumën e këndeve të trekëndëshit dhe të katërkëndëshit; - zgjidh problema të thjeshta me kënde; - përdor pohimin se këndet e kundërta në kulm janë të barabarta.		Fjalë kyç kënde të kundërta në kulm kënde me një brinjë të përbashkët dhe një brinjë në shtrirje të njëra-tjetrës drejtëz prerëse trekëndësh dybrinjënjëshëm	
Burimet Fletorja e punës, raportori, vizorja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Me artet në përdorimin e figurave gjeometrike. Shkencat e natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rikujtim njohurish) Vepron si në mësimin e kaluar. Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar) Problemat që do të punohen do të jenë nga fletorja e punës. Punohet ushtrimi 2 në faqen 33. Pastaj ushtrimet 1, 3, 4 faqe 34. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim) Nxënësit prezantojnë punët e tyre para klasës.			
Vlerësimi Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësi iu përgjigjet këtyre pyetjeve: 1. Cilat quhen kënde të kundërta në kulm dhe si janë ndërmjet tyre? 2. Sa kënde formohen nga prerja e dy drejtëzave paralele nga një prerëse dhe cilat janë kënde të barabarta? 3. Kur dy drejtëza janë pingule? 4. Kur trekëndëshat janë dybrinjënjëshëm?			
Detyrat dhe puna e pavarur Ushtrimet 5, 6, 7 në faqen 34 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometri		Situata e të nxënit	
Tema mësimore: 5.7.		Mësuesi paraqet situatën e	
Përsëritje		problemës 5 në faqen 62 nga libri i nxënësit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Kompetenca e të menduarit.			
Organizon lidhjet konceptuale të njohurive.			
Kompetenca e të nxënit			
Demonstron kuriozitet për gjeometrinë.			
Kompetenca e të menduarit			
Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave në gjeometri.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalë kyç	
Nxënësi/-ja:		kënde të kundër në kulm	
- përdor në problema të thjeshta shumën e këndeve të trekëndëshit dhe të katërkëndëshit.		kënde me një brinjë të përbashkët dhe një brinjë në shtrirje të njëra-tjetrës	
- zgjidh problema të thjeshta me kënde.		drejtëz prerëse	
- përdor pohimin se këndet e kundërta në kulm janë të barabartë.		trekëndësh dybrinjënjëshëm	
Burimet		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare	
1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës. 3. Raportori. 4. Vizorja.		Me artet në përdorimin e figurave gjeometrike.	
		Shkencat e natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rikujtim njohurish)			
Rikujtohen njohuritë e mësimëve të kaluara me anë të situatave të të nxënit.			

Ndërtimi i njohurive të reja (punë individuale, punë e drejtuar)

Meqenëse është orë përsëritjeje, mësuesi i vë nxënësit të punojnë individualisht me ushtrimet 1, 2, 3 në faqen 62 nga libri i nxënësit. Nëse mësuesi do të zhvillojë test për kapitullin e dytë, të tretë të katërt dhe të pestë është mirë që në këtë orë përsëritje të zhvillojë ushtrime tip nga të katër kapitujt.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (metoda)

Nxënësit paraqesin punët e tyre para klasës.

Vlerësimi

Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësi iu përgjigjet këtyre pyetjeve:

1. Cilat quhen kënde të kundërta në kulm dhe si janë ndërmjet tyre?
2. Sa kënde formohen nga prerja e dy drejtëzave paralele nga një prerëse dhe cilat janë kënde të barabarta?
3. Kur dy drejtëza janë pingule?
4. Kur trekëndëshat janë dybrinjënjëshëm?

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 4 dhe 6 në faqen 62 nga libri i nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Statistikë		Situata e të nxënit	
Tema mësimore: 6.1 Përgatitja për grumbullimin e të dhënave		Nëse duhet që të nxjerrim se cili libër i bibliotekës së shkollës është lexuar më shumë, çfarë duhet të bëjmë?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: - vendos se cilat të dhëna do të jenë të përshtatshme për një pyetje; - mbledh dhe organizon të dhënat; - harton dhe përdor një pyetësor për një vrojtim të thjeshtë; - dallon të dhënat parësore nga të dhënat dytësore.		Fjalë kyç të dhëna informacion të dhëna parësore të dhëna dytësore pyetësor	
Burimet 1. Libri i nxënësit. 2. Fletorja e punës. 3. Statistika nga shkolla		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Teknologjinë dhe TIK-un. Gjuhën dhe komunikimin. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Diskutohet mbi faqen e parë të kapitullit VI. Më shtrohet situata e dhënë më lart.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto) Mësuesi në fillim sqaron se cilat quhen të dhëna parësore dhe cilat quhen të dhëna dytësore. Mbas këtyre sqarimeve, punohet shembulli i librit duke u sqaruar çdo situatë që paraqitet se do t'u vlejë nxënësve për të punuar ushtrimet e tjera.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë individuale) Pastaj klasa punon ushtrimet 2, 3 dhe 7 në faqen 65 nga libri i nxënësit.			
Vlerësimi Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen këtyre pyetjeve: 1. Për të bërë një studim, sa lloje të dhënash kemi? 2. Çfarë quajmë të dhëna parësore? 3. Çfarë quajmë të dhëna dytësore?			
Detyrat dhe puna e pavarur Ushtrimet 4, 5 në faqen 65 nga libri i nxënësit dhe 2, 3, 4 në faqen 35 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Statistikë		Situata e të nxënit: Në çfarë mënyre mund të mbledhim të dhënat e një procesi të caktuar?	
Tema mësimore: 6.2. Mbledhja e të dhënave			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: organizon pyetësoin; përdor tabelën për sistemimin e të dhënave.		Fjalë kyç: të dhëna informacion të dhëna parësore të dhëna dytësore pyetësor	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, statistika që mund të ketë shkolla.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Teknologjinë dhe TIK-un. Gjuhën dhe komunikimin. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Diskutohen detyrat e shtëpisë. Parashtrohet situata dhe diskutohet rreth saj.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar, punë në grupe) Nëse mbledhim të dhëna direkt nga një grup nxënësish, si veprojmë? Pyetjet që drejtohen duhet të jenë të studiuara me kujdes. Për këtë punohet tabela në librin e nxënësve. Në këtë tabelë jepen disa sqarime për pyetjet që duhen drejtuar. Mbase shihet me kujdes tabela, nxënësit punojnë shembullin e tekstit. Mësuesi i udhëzon edhe për ushtrimin 1 në faqen 67 nga libri i nxënësit. Pastaj në grupe punohen ushtrimet 2 dhe 3 në faqen 67 nga libri i nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim) Grupet paraqesin punën e tyre.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen këtyre pyetjeve: – Mund të përdoren në pyetësor fjalët herë, shpesh, rregullisht? – A duhet ta kërkojmë në pyetësor emrin e personit të pyetur? – A duhet të jetë i gjatë pyetësori?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 4 në faqen 67 nga libri i nxënësit dhe 1, 2 në faqen 36 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Statistikë		Situata e të nxënit: Si mendoni, ku mund të vendosen të dhënat e një pyetësi?	
Tema mësimore: 6.3. Përdorimi i tabelave të dendurive			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> ndërton dhe përdor tabelat për mbledhjen e të dhënave; ndërton dhe përdor tabelat e dendurive për të mbledhur të dhëna të veçanta, të grupuara, ose me intervale të njëjta. 		Fjalë kyç: tabela e dendurive tabela e dendurive të grumbulluara	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, statistika që mund të ketë shkolla.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Teknologjinë dhe TIK-un. Gjuhën dhe komunikimin. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim)			
Diskutohen detyrat e shtëpisë. Parashtrohet situata dhe diskutohet rreth saj.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-formulo, punë individuale)			
Mësuesi duhet të ketë përgatitur tabela si ato të librit. Mbasi u shpjegon mënyrën e përdorimit të tabelave, nxënësit punojnë shembullin e librit. Mbasi analizohen të gjitha veprimet që bëhen për të mbushur tabelat nxënësit punojnë ushtrimin 1 në faqen 69 nga libri i nxënësit. Ushtrimet 2 dhe 3 punohen në mënyrë të pavarur nga klasa.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim)			
Mbas përfundimit të ushtrimeve, nxënësit paraqesin punën e tyre para klasës.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: <ul style="list-style-type: none"> Për të bërë një studim, sa lloje të dhënash kemi? Cilat janë të dhëna parësore? Cilat janë të dhëna dytësore? A mund të përdoren në pyetësor fjalë si disa herë, shpesh, rregullisht? A duhet t'i vënë emrat në pyetësor personat e pyetur? A duhet të jetë i gjatë pyetësi? Çfarë shënohet në tabelat e dendurive? 			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 1, 2, 3 në faqen 37 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Statistikë		Situata e të nxënit: Si në mësimin e kaluar.	
Tema mësimore: 6.4. Përdorimi i tabelave të dendurive			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: ndërton dhe përdor tabelat për mbledhjen e të dhënave; ndërton dhe përdor tabelat e dendurive për të mbledhur të dhëna të veçanta, të grupuara, ose me intervale të njëjta.		Fjalë kyç: tabela e dendurive tabela e dendurive të grumbulluara	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, statistika që mund të ketë shkolla.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Teknologjinë dhe TIK-un. Gjuhën dhe komunikimin. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimin			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rikujtim njohurish) Vepronet si në mësimin e kaluar.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe dyshe) Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimet 4, 5, 6 në faqen 70 nga libri i nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim) Grupet paraqesin punën e tyre para klasës.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve mbi ndërtimin dhe përdorimin e pyetësorëve.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 4, 5, 6 faqe 38 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Statistikë		Situata e të nxënit: Vlejnë situatat e përdorura në mësimet e mëparshme.	
Tema mësimore: 6.5. Përsëritje			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: organizon pyetësonin; përdor tabelën për sistemimin e të dhënave; ndërton dhe përdor tabelat për mbledhjen e të dhënave; ndërton dhe përdor tabelat e dendurive për të mbledhur të dhëna të veçanta, të grupuara ose me intervale të njëjta.		Fjalë kyç: të dhëna informacion të dhëna parësore të dhëna dytësore pyetësor tabela e dendurive tabela e dendurive të grumbulluara	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, statistika që mund të ketë shkolla.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Teknologjinë dhe TIK-un. Gjuhën dhe komunikimin. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Kontrollohen detyrat dhëna dhe diskutohet mbi zgjidhjen e tyre.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar, punë në grupe dyshe) Punohet me nxënësit ushtrimi 5 në faqen 71. Pastaj nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimet e tjera në librin e nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim) Grupet paraqesin punën e tyre para klasës.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve mbi ndërtimin dhe përdorimin e pyetësorëve.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 6 dhe 7 në faqen 71 nga libri i nxënësit.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Vizatohen në dërrasë tre drejtkëndëshat që janë në libër dhe nxirret që pjesët e ngjyrosura janë të barabarta, por si thyesa janë $\frac{1}{4}$, $\frac{2}{8}$, $\frac{4}{16}$. Pyetja: Si përftohen këto thyesa nga njëra-tjetra?	
Tema mësimore: 7.1. Thjeshtimi i thyesave			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake. Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: thjeshton thyesat; thjeshton thyesat deri sa të kthehen në thyesa të pathjeshtueshme.		Fjalë kyç: thyesë numërues emërues thyesa të barabarta thjeshtoj faktor i përbashkët thyesa të pathjeshtueshme faktori më i madh i përbashkët	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, tabela si ato që janë në libër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin. Shkencat e natyrës. Artet. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimi) Në fillim të orës së mësimi pyeten nxënësit si nga mendojnë se vjen fjala thyesë. Shihet pjesa në tekst se si i shkruanin egjiptianët thyesat me hieroglifë. Te thyesat gjendet se cili quhet emërues dhe cili quhet numërues i thyesës.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto) Në dërrasë një nxënës vizaton drejtkëndëshat që janë dhënë në situatën e të nxënit. Shkruhen të tria thyesat dhe diskutohet se si merret thyesa e parë nga thyesa e tretë dhe nga thyesa e dytë. Nëse nxënësit nuk e kanë të qartë, mësuesi u drejton këtë pyetje: si merret njëshi nga katra, po 4 nga 16? Mbas përgjigjes, mësuesi u thotë nxënësve se thyesa $\frac{1}{4}$ merret nga thyesa $\frac{4}{16}$ duke pjesëtuar si numëruesin dhe			

emëruesin e thyesë me 4. Po kështu, dhe për marrje e $\frac{1}{4}$ nga $\frac{2}{8}$. Ky veprim quhet thjeshtim. Vihet re se thyesa $\frac{1}{4}$ është e tillë që numëruesi dhe emëruesi nuk kanë pjesëtues tjetër të përbashkët. Kjo quhet thyesë e pathjeshtueshme. Mësuesi duhet të sqarojë se cila quhet thyesë e pathjeshtueshme. Kështu nxënësit kujtojnë edhe faktorin më të madh të përbashkët. Mbas këtyre sqarimeve, nxënësit punojnë shembullin në tekst.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim)

Në grupe nxënësit punojnë ushtrimet 1 dhe 3 në faqen 74 nga libri i nxënësit dhe e prezantojnë punën para klasës.

Vlerësimi:

Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve:

- Cili është emëruesi dhe numëruesi i një thyese?
- Cili quhet faktori më i madh i përbashkët i dy numrave?
- Kur një thyesë quhet e pathjeshtueshme?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 3, 4, 5, 6 në faqen 74 nga libri i nxënësit.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Shtrohet kjo situatë: thyesat $\frac{1}{10}$, $\frac{1}{100}$, $\frac{1}{1000}$ çfarë vendi zënë në tabelën e vendvlerave? Numrat dhjetorë 0,2; 0,002, si lexohen dhe si mund të shkruhen në formë thyesë?	
Tema mësimore: 7.2. Njohja e thyesave të barabarta, numrave dhjetorë dhe përqindjeve			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake. Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: shkruan një numër dhjetor të fundmë si thyesë dhe anasjellas; shkruan një përqindje si thyesë; dallon thyesat e barabarta.		Fjalë kyç: thyesa të barabarta përqindje numër dhjetor i fundmë	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, një tabelë të vendvlerave.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin. Shkencat e natyrës. Artet. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rrjet diskutimi) Parashtrohet situata e dhënë më lart. Diskutohet mbi pyetjen për thyesat dhe numrat dhjetorë.			

Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar)

Nxënësit punojnë shembullin dhe mësuesi i drejton. Mësuesi duhet të ketë përgatitur një tabelë si ajo e faqes 76. Me anën e kësaj table nxënësit do të përcaktojnë dhe thyesat e barabarta dhe kthimin e përqindjeve në thyesa dhe në numra dhjetorë.

Përsëri punohet nga mësuesi dhe shembulli tjetër. Në këtë shembull mësuesi duhet të sqarojë për mënyrën e kthimit të përqindjeve në thyesa të pathjeshtueshme dhe në numra dhjetorë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe, prezantim)

Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimet 1, 2 në faqen 76 nga libri i nxënësit dhe ushtrimin 3 faqe 40 nga fletorja e punës. Paraqesin punën e tyre para klasës.

Vlerësimi:

Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve:

- Si veprohet për të kthyer një numër dhjetor të fundmë në thyesë
- Si veprohet për të kthyer një thyesë në numër dhjetor?
- Si veprohet për të kthyer një përqindje në thyesë dhe pastaj në numër dhjetor?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 2, 3, 4 në faqen 40 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit Shtrohet kjo situatë: thyesat $\frac{1}{10}$, $\frac{1}{100}$, $\frac{1}{1000}$ çfarë vendi zënë në tabelën e vendvlerave? Numrat dhjetorë 0,2; 0,002 si lexohen dhe si mund të shkruhen si thyesa?	
Tema mësimore: 7.3. Njohja e thyesave të barabarta, numrave dhjetorë dhe përqindjeve			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake. Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: shkruan një numër dhjetor të fundmë si thyesë dhe anasjellas; shkruan një përqindje si thyesë; dallon thyesat e barabarta.		Fjalë kyç: thyesa të barabarta përqindje numër dhjetor i fundmë	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin. Shkencat e natyrës. Artet. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rikujtim njohurish) Rikujtohen njohuritë në temën paraardhëse.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe) Klasa e ndarë në grupe punon problemën 7 në faqen 40 nga fletorja e punës dhe ushtrimet 4 dhe 5 në faqen 77 nga libri i nxënësit. Ndërkohë mësuesi i ndihmon kur kanë paqartësi.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim) Grupet prezantojnë punën e tyre para klasës.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Si veprohet për të kthyer një numër dhjetor të fundmë në thyesë? – Si veprohet për të kthyer një thyesë në numër dhjetor? – Si veprohet për të kthyer një përqindje në thyesë dhe pastaj në numër dhjetor?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 5, 6 faqe 40 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 7.5. Thyesat e rregullta, të parregullta dhe numrat e përzier		Çfarë ndryshimi ka ndërmjet thyesave $\frac{3}{5}$; $\frac{11}{2}$ dhe numrit $2\frac{3}{5}$?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.			
Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake.			
Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: dallon thyesat e rregullta nga thyesat e parregullta; dallon numrat e përzier nga thyesat; kthen një thyesë të parregullt në një numër të përzier dhe anasjellas.		Fjalë kyç: Thyes e rregullt Thyesë e parregullt Numër i përzier	
Burimet: Teksti i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin. Shkencat e natyrës. Artet. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimi) Shtrohet pyetja e dhënë në situatën e të nxënit dhe mësuesi pret përgjigjet e nxënësve.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto) Mbasi kanë bërë dallimin ndërmjet $\frac{3}{5}$; $\frac{11}{2}$ dhe $2\frac{3}{5}$ dilet në përkufizimin e thyesave e rregullta, thyesave të parregullta dhe numrave të përzier. Gjithashtu sqarohet se numri i përzier merret nga thyesa jo e rregullt. Nxënësit punojnë shembullin e teksit. Mësuesi i drejton.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe, prezantim) Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimet 1, 2, 3, 4 në faqen 80 nga libri i nxënësit. Ushtrimi 1 (a, b, dh) në faqen 42 nga fletorja e punës. Grupet paraqesin punën e tyre para klasës.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Cilat quhen thyesa të rregullta? – Cilat quhen thyesa të parregullta? – Cilët quhen numra të përzier? – Si përftohen numrat e përzier? – Çfarë përmban një numër i përzier?			
Detyrat dhe puna e pavarur Ushtrimet 1(c, ç, d), 2, 4 në faqen 42 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 7.4. Krahasimi i thyesave		Bëhet krahasimi i numrave dhjetorë 2,2 me 2,2 ; 34, 15 me 34,12 dhe 0,32 me 0,345. Shtrojmë pyetjen, po thyesat mund të krahasohen? Nëse po, si veprohet?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.			
Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake.			
Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
Nxënësi/-ja: shkruan një numër dhjetor të fundmë si thyesë dhe anasjellas; shkruan një përqindje si thyesë; dallon thyesat e barabarta; krahason thyesat		thyesa të barabarta përqindje numër dhjetor i fundmë kuptimi i simboleve =; >; < kuptimi i shënimit $0,\bar{3}$	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Gjuhën dhe komunikimin. Shkencat e natyrës. Artet. Shoqërinë dhe mjedisin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rikujtim njohurish, diskutim)			
Pas detyrave të shtëpisë, punohen ushtrimet 1, 2, 3, 4 në faqe 40 nga fletorja e punës. Shtrohet situata e të nxënit.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar)			
Për të krahasuar thyesat, ka katër mënyra. Mënyra e parë. Vizatojmë dy drejtkëndëshat që janë në libër. Një pjesë e drejtkëndëshit të parë është $\frac{1}{3}$ e të gjithë drejtkëndëshit, kurse tek i dyti është sa $\frac{1}{4}$. Shtrohet pyetja: Cila nga pjesët e ngjyrosura është më e madhe, e para apo e dyta? Përgjigjja do të jetë: e dyta, pra $\frac{1}{3} > \frac{1}{4}$. Mënyra e dytë. Me makinë llogaritëse. Mënyra e tretë. Thyesat kthehen në numra dhjetorë. Para se t'i kthejmë në numra			

dhjetorë të u japim kuptimin e numrave dhjetorë të pafundmë. Thyesa $\frac{1}{3}$, për t’u kthyer në numër dhjetor, pjesëtohet numëruesi me emëruesin dhe kemi $\frac{1}{3} = 0,333$. Ky quhet numër dhjetor i pafundmë. Simbolikisht shënohet $0,\overline{3}$. Kurse $\frac{1}{4} = 0,25$. Nga krahasimi i numrave dhjetorë, del se $0,\overline{3} > 0,25$ pra $\frac{1}{3} > \frac{1}{4}$.

Mënyra e katërt. Nëse thyesat kanë emërues të barabartë, më e madhe është ajo që ka numërues më të madh. Nëse kanë numërues të barabartë, më e madhe është ajo që ka emërues më të vogël.

Nxënësit punojnë shembullin e tekstit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur)

Nxënësit punojnë ushtrimin 1 dhe 3 në faqen 79.

Vlerësimi:

Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve:

- Në sa mënyra i krahasojmë thyesat?
- Kur një numër dhjetor është i pafundmë dhe si shënohet ai?
- Si veprojmë që një thyesë ta kthejmë në numër dhjetor?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 4, 7 në faqen 79 nga libri i nxënësit dhe 3, 6 në faqen 41 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 7.6. Mbledhja dhe zbritja e thyesave		Janë dhënë $\frac{3}{5} - \frac{1}{5}$ dhe $\frac{3}{2} + \frac{4}{5}$. Çfarë i dallon thyesat në të dyja veprimet? Si mendoni, si kryhen veprimet?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.			
Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake.			
Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> • mbledh dhe zbret thyesat me emërues të njëjtë; • mbledh dhe zbret thyesat me emërues të ndryshëm. 		Fjalë kyç: thyesa me emërues të njëjtë thyesa me emërues të ndryshëm	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin Shkencat e natyrës Artet Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rikujtim njohurish)			
Punohen nga disa nxënës detyrat e shtëpisë dhe ushtrimet 5 dhe 6 në faqen 42 nga fletorja e punës. Rikujtohen njohuritë e marra.			

Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar)

Mbasi nxënësit iu përgjigjen pyetjeve të situatës së menduar të situatës së nxënësit, punojnë shembullin që është në tekst. Etapat nëpër të cilat kalon mbledhja dhe zbritja e thyesave, sidomos për thyesat me emërues të ndryshëm, duhet të sqarohen me shumë kujdes.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, diskutim)

Mbas mbarimit të shembullit nxënësit punojnë në grupe ushtrimet 1, 2, 3, 4 në faqen 81 nga libri i nxënësit. Për ushtrimet 1 dhe 2 diskutojnë nxënësit nën mesatarë.

Vlerësimi:

Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve:

- Cilat quhen thyesa të rregullta?
- Cilat quhen thyesa të parregullta?
- Cilët quhen numra të përzier?
- Si fitohen numrat e përzier?
- Çfarë përmban një numër i përzier?
- Si veprohet për të mbledhur dhe zbritur thyesat me emërues të njëjtë?
- Si veprohet për të mbledhur dhe zbritur thyesat me emërues të ndryshëm?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 2, 4 në faqen 43 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Mësuesi jep këtë ushtrim 7: 3. Herësi del 2 dhe mbetja është 1. Shtrohet pyetja: Si mund të shkruhet kjo mbetje?	
Tema mësimore: 7.8. Gjetja e mbetjes			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake. Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: pjesëton një numër çfarëdo; përcakton mbetjen e pjesëtimit; shkruan mbetjen si thyesë me emërues pjesëtuesin.		Fjalë kyç: i pjesëtueshmi pjesëtues mbetje herës	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin Shkencat e natyrës Artet Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimi) Pas detyrave të shtëpisë, shtrohet situata më lart. Nxënësit japin mendimet e tyre.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar) Në pjesëtimin e dy numrave dallojmë katër elemente: të pjesëtueshmin ose numrin që pjesëtohet, pjesëtuesin ose numri që pjesëton, herësin ose atë që del nga pjesëtimi dhe mbetjen. Duke marrë shembujt e parë, mësuesi u shpjegon se cili është i pjesëtueshmi, cili është pjesëtuesi, cili është herësi dhe cila është mbetja. Nxënësit punojnë shembullin e tretë. Mësuesi i drejton. Në këtë shembull sqarohet dhe se çfarë bëhet me mbetjen dhe si shkruhet ajo.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe) Klasa punon në grupe ushtrimet 1, 2, 3 në faqen 83 nga libri i nxënësit. Punohet nga të gjithë problema 7 në faqen 84 nga libri i nxënësit.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Cilët përbërës dallojmë në një pjesëtim dhe si emërtohen ata? – Si shkruhet mbetja e pjesëtimit?			
Detyrat dhe puna e pavarur Ushtrimet 4, 5, 6 në faqen 84 nga libri i nxënësit.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Shtrohet kjo situatë: janë tre nxënës dhe kanë 6 fletore. Secili nga nxënësit do të marrë $\frac{1}{3}$ e të gjitha fletoreve. Si do ta gjejmë se sa fletore i takojnë secilit nxënës?	
Tema mësimore: 7.7. Gjetja e pjesës së një sasive të caktuar			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake. Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: gjen pjesën e një sasive të caktuar ose të një numri.		Fjalë kyç: pjesë sasi njësi matëse	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin Shkencat e natyrës Artet Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhí mendimi) Mbasi kontrollohen detyrat e shtëpisë, shtrohet situata e të nxënit. Nxënësit japin pyetje të ndryshme.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto) Mbasi diskutohen përgjigjet, nxënësit punojnë shembullin e tekstit. Sqarohet kuptimi i njës “e”. Nëse gjendet pjesa e një madhësie, ajo ka njësi matëse dhe pjesa ka po atë njësi matëse. Nëse gjendet pjesa e një numri, ajo nuk ka njësi matëse. Këto duhet të sqarohen nga mësuesi.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur) Nxënësit punojnë problemën 4 në faqen 82 nga libri i nxënësit.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Si gjendet pjesa e një numri? – A ka njësi matëse për rezultatin që del? – Si gjendet pjesa e një madhësie që ka njësi?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 1, 2, 3, 7 në faqen 44 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit: Si te mësimi i kaluar.	
Tema mësimore: 7.9. Gjetja e mbetjes			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake. Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> • pjesëton një numër çfarëdo; • përcakton mbetjen e pjesëtimit; • shkruan mbetjen si thyesë me emërues pjesëtuesin. 		Fjalë kyç: i pjesëtueshmi pjesëtues mbetje herës	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin Shkencat e natyrës Artet Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim)			
Mbasi kontrollohen detyrat e shtëpisë, shtrohet për diskutim situata e të nxënit. Nxënësit japin pyetje të ndryshme.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe)			
Ora e mësimit është vetëm me ushtrime. Klasa punon në grupe ushtrimet 1, 2, 5, 6 në faqen 45 nga fletorja e punës.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim)			
Grupet paraqesin punën e tyre.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Ç’ dallojmë në një pjesëtim dhe si emërtohen? – Si shkruhet mbetja e pjesëtimit?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 3,4, 7, 8 në faqen 45 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Numri		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: 7.10. Përsëritje		Shtrohen situatat e kapitullit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Është inovativ, paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij. Kompetenca personale Demonstron besim në forcat vetjake. Kompetenca qytetare Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: pjesëton një numër çfarëdo; përcakton mbetjen e pjesëtimit; shkruan mbetjen si thyesë me emërues pjesëtuesin.		Fjalë kyç: i pjesëtueshmi pjesëtues mbetje herës	
Burimet: libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin Shkencat e natyrës Artet Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Diskutohen çështjet kryesore nga kapitulli.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe) Meqenëse është orë përsëritjeje, punohen ushtrime për të kujtuar të gjitha konceptet e marra në këtë kapitull. Klasa ndahet në grupe. Punohen ushtrimet 2, 5, 6, 7 në faqen 85 nga libri i nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim) Grupet paraqesin punën e tyre.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësi iu përgjigjet pyetjeve: <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat quhen thyesa të rregullta? 2. Cilat quhen thyesa të parregullta? 3. Cilët quhen numra të përzier? 4. Si fitohen numrat e përzier? 5. Çfarë përmban një numër i përzier? 6. Ç'dallojmë në një pjesëtim dhe si emërtohen përbërësit? 7. Si shkruhet mbetja e pjesëtimit? 			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 3, 4, 8, 9 në faqen 85 nga libri i nxënësit.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit: Figurat nga trupat gjeometrikë.	
Tema mësimore: 8.1 Njohja dhe përshkrimi i figurave dhe trupave			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e menduarit Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave në gjeometri. Kompetenca personale Vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: vizaton figurat dypërmasore; njeh dhe përshkruan trupat gjeometrikë; vizaton trupat gjeometrikë.		Fjalë kyç: figurë dypërmasore figurat plane dypërmasore katror drejtkëndësh paralelogram romb, balonë trapez trekëndësh çfarëdo trekëndësh barabrinjës trekëndësh dybrinjënjëshëm trekëndësh kënddrejtë trup gjeometrik kub kuboid piramidë me bazë katror piramidë me bazë trekëndësh prizëm me bazë trekëndësh cilindër kon sferë	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, figura gjeometrike, trupa gjeometrikë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkencat e natyrës Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Diskutohet mbi situatën e të nxënit: figurat e trupat gjeometrikë.			
Ndërtimi i njohurive të reja (metoda) Mësuesi duhet të ketë porositur nxënësit që të jenë të pajisur me vizore, gërshërë dhe fletë me ngjyra të ndryshme. Vizatohen figurat gjeometrike që janë në libër. Meqenëse trupat gjeometrikë tani për			

tani i kanë vështirë t'i ndërtojnë, i vizatojnë në dërrasë me ndihmën e mësuesit. Përcaktohet se cilat quhen brinjë, cilat quhen kulme, cilat quhen faqe dhe cilat quhen baza për trupat gjeometrikë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim)

Klasa ndahet në grupe. Punohen ushtrimet 3, 5, 6 në faqen 88 nga libri i nxënësit.

Grupet prezantojnë punën e tyre.

Vlerësimi:

Ora do të quhet e realizuar, nëse:

nxënësit e dobët dallojnë dhe vizatojnë figurat e ndryshme;

nxënësit mbi mesataren vizatojnë trupat gjeometrikë;

tregojnë kulmet dhe brinjët te figurat dhe trupat gjeometrikë;

tregojnë bazat dhe faqet anësore te trupat gjeometrikë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 1, 2, 3, 4 në faqen 46 nga fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit: Mësuesi ka përgatitur një trekëndësh barabrinjës dhe ka ndërtuar njërën prej lartësive të tij. Shtron pyetjen: Nëse e përthyejmë sipas drejtëzës së ndërtuar, çfarë do të ndodhë?	
Tema mësimore: 8.2. Njohja e drejtëzës së simetrisë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e menduarit Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave në gjeometri. Kompetenca personale Vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon drejtëzën e simetrisë në figura të ndryshme; ndërton drejtëzat e simetrisë në figurat që kanë drejtëz simetrie. 		Fjalë kyç: figurë dypërmasor trup gjeometrik	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, figura gjeometrike, trupa gjeometrikë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkencat e natyrës Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim)			
Pas kontrollit të detyrave, shtrohet situata e të nxënit. Diskutohet rreth saj.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto)			
Nxënësit punojnë shembullin dhe mësuesi i drejton për të nxjerrë përkufizimin e drejtëzës së simetrisë. Punojnë ushtrimin 4 në faqen 89 nga libri i nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur, prezantim) Nxënësit punojnë në mënyrë individuale ushtrimet 6, 7, 8 në faqen 90 nga libri i nxënësit. Paraqesin punën e tyre.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Cila drejtëz quhet drejtëz simetrie? – Sa drejtëza simetrie ka trekëndëshi barabrinjës? Vizatojini ato. – Cila figurë ka shumë drejtëza simetrie dhe ku kalojnë ato? – Jepni disa figura që kanë nga dy drejtëza simetrie.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 1, 2, 3 në faqen 48 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit: Mësuesi merr një trekëndësh barabrinjës dhe një trekëndësh dybrinjënjëshëm. Dhe kërkon nga nxënësit që të matin brinjët dhe këndet. Pastaj u drejton pyetjen: çfarë i dallon këta trekëndësha?	
Tema mësimore: 8.3. Vetitë e simetrisë së trekëndëshave, katërkëndëshave dhe shumëkëndëshave			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e menduarit Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave në gjeometri. Kompetenca personale Vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: përshkruan trekëndëshat, katërkëndëshat dhe shumëkëndëshat duke përdorur brinjët, këndet dhe drejtëzën e simetrisë.		Fjalë kyç: trekëndësha çfarëdo trekëndësha barabrinjës trekëndësha dybrinjënjëshëm trekëndësha kënddrejtë shumëkëndësha çfarëdo shumëkëndësha me brinjë dhe kënde të barabarta	
Burimet: libri i nxënësit, fletorja e punës, figura gjeometrike, trupa gjeometrikë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkencat e natyrës Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimi) Mbas kontrollit të detyrave, shtrohet situata e të nxënit dhe merren mendimet e nxënësve.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-formo) Nxënësit mund të kenë përgatitur në shtëpi një trekëndësh çfarëdo, një trekëndësh dybrinjënjëshëm, një trekëndësh barabrinjës, një katror, një katërkëndësh kënddrejtë, një romb, një paralelogram, një trapez çfarëdo dhe një trapez dybrinjënjëshëm. Nëse jo, i vizatojnë në fletore. Me matjet me vizore dhe këndet me raportor do të vërtetohen vetitë e dhëna. Nxënësit punojnë shembullin e tekstit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim) Punojnë në grupe ushtrimet e tekstit dhe paraqesin punën para klasës.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit formulojnë vetitë e figurave të ndryshme.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 1 dhe 2 në faqen 92 nga libri i nxënësit.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit: Si në mësimin e kaluar.	
Tema mësimore: 8.4. Vetitë e simetrisë së trekëndëshave, katërkëndëshave dhe shumëkëndëshave			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e menduarit Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave në gjeometri. Kompetenca personale Vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> përshkruan trekëndëshat, katërkëndëshat dhe shumëkëndëshat duke përdorur brinjët, këndet dhe drejtëzën e simetrisë. 		Fjalë kyç: trekëndësha çfarëdo trekëndësha barabrinjës trekëndësha dybrinjënjëshëm trekëndësha kënddrejtë shumëkëndësha çfarëdo	
Burimet: libri i nxënësit, fletorja e punës, figura të ndryshme.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkenca e natyrës Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimin			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Pas kontrollit të detyrave të shtëpisë, diskutohet për zgjidhjen e tyre.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar, diskutim) Nxënësit punojnë ushtrimin 4 dhe 6 në faqen 92, 93 dhe grafikun e ushtrimit 5 në faqen 93 nga libri i nxënësit. Diskutojnë edhe për zgjidhjen e ushtrimit 6 po në këtë faqe.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe) Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimet 2, 3 në faqen 49 nga fletorja e punës.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit formulojnë vetitë e figurave të ndryshme.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 1, 4 në faqen 49 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit: Situatat e përdorura gjatë kapitullit.	
Tema mësimore: 8.5. Përsëritje			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e menduarit Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemave në gjeometri. Kompetenca personale Vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> përshkruan trekëndëshat, katërkëndëshat dhe shumëkëndëshat duke përdorur brinjët, këndet dhe drejtëzën e simetrisë. 		Fjalë kyç: trekëndësja çfarëdo trekëndësja barabrinjës trekëndësja dybrinjënjëshëm trekëndësja kënddrejtë shumëkëndësja çfarëdo shumëkëndës ha me brinjë të barabarta	
Burimet: libri i nxënësit, fletorja e punës, figura të ndryshme.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkenca e natyrës Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rikujtim njohurish)			
Kontrollon detyrat dhe kërkon nga nxënësit që të vizatojnë në dërrasë figurat e studiuara në këtë kapitull. Mësuesi/-ja i pyet: Ç'mund të thoni për këto figura?			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe)			
Ndahet klasa në grupe dhe punohen ushtrimet 2, 5, 7 në faqen 94 nga libri i nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim)			
Grupet paraqesin punën e tyre.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit formulojnë vetitë e figurave të ndryshme.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 2, 3, 6 në faqen 94 nga libri i nxënësit.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit: Shtrohet situata: kemi 10 fletore dhe 5 libra. A mund të mblidhen? Ose: një nxënës ka 4 fletore dhe 5 lapsa, kurse një nxënës tjetër ka 8 fletore dhe 5 lapsa. A mund të themi se të dy nxënësit kanë 12 fletore dhe 10 lapsa?	
Tema mësimore: 9.1. Mbledhja e kufizave të ngjashme			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca personale Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: dallon kufizat që kanë pjesën shkronjore të ngjashme; tregon numrin që është para shkronjave (koeficientin); mbledh vetëm kufizat e ngjashme; mbledh kufizat e ngjashme; mbledh vetëm koeficientët.		Fjalë kyç: ekuacion shprehje kufiza të ngjashme mbledhja e kufizave të ngjashme koeficient	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkencat e natyrës Gjuhën dhe komunikimin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimi) Shtrohet situata e të nxënit. Përgjigjet mund të jenë të ndryshme. Në fund, përgjigjet unifikohen.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto) Jepet një shembull për mbledhjen e kufizave të ngjashme. Nëse në një tavolinë janë 2 mollë dhe në një komodinë janë dhe 3 mollë të tjera, sa mollë janë gjithsej? Përgjigjja do të jetë 5 mollë. Pra, mblodhëm numrin, kurse fjalën mollë nuk e ndryshuam. Kështu do të veprohet edhe për kufizat e ngjashme. Mbas kësaj, mësuesi zhvillon pjesën para			

shembullit. Sqarohet mirë veprimi që bëhet me kufizat e ngjashme. Nxënësit punojnë shembullin dhe mësuesi i udhëzon. Më pas punohet ushtrimi 1 në faqen 96 nga libri i nxënësit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grup, diskutim)

Klasa ndahet në grupe. Grupi i parë punon 2(a, b, c, ç, d, dh). Grupi i dytë punon 2 (e, ë, f, g, gj, h). Në fund diskutohen përgjigjet.

Vlerësimi:

Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve:

- Cilat quhen kufiza të ngjashme?
- Nga sa pjesë bëhet kufiza?
- Si mblidhen kufizat e ngjashme?

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet 3, 5 në faqen 97 nga libri i nxënësit dhe 1, 2 në faqen 50 nga fletorja e punës. Mësuesi i sqaron nxënësit për ushtrimin 3.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit: Situatë e ngjashme me mësimin e kaluar.	
Tema mësimore: 9.2. Mbledhja e kufizave të ngjashme			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca personale Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon kufizat që kanë pjesën shkronjore të ngjashme; tregon numrin që është para shkronjave (koeficientin); mbledh vetëm kufizat e ngjashme; mbledh kufizat e ngjashme; mbledh vetëm koeficientët. 		Fjalë kyç: ekuacion shprehje mbledhja e kufizave të ngjashme kufiza të ngjashme koeficient	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkencat e natyrës Gjuhën dhe komunikimin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimin			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (marrëdhënie pyetje-përgjigje)			
Si i shënojmë kufizat? Si i mbledhim ato?			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar)			
Duk punuar shembullin sqarohet se në kufizat e ngjashme në fillim vihet numri. Nëse një kufizë nuk është vendosur numër, ky është 1. Shkronjat në kufiza vendosen sipas rendit alfabetik. Nxënësit punojnë ushtrimin 6 në faqen 97 te libri i nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim) Klasa ndahet në grupe. Grupi I, ushtrimin 4, ndërsa grupi II ushtrimin 7 në faqen 97 nga libri i nxënësit. Grupet prezantojnë punën.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Cilët quhen kufiza të ngjashme? – Nga sa pjesë bëhet kufiza? – Si mblidhen kufizat e ngjashme?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 3, 4, 5 në faqen 50 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit: Mësuesi merr këtë ushtrim: $3(2x - 5y) + (x - y)$. Pyet klasën: Si do të vepohet në këtë rast për të thjeshtuar shprehjen?	
Tema mësimore: 9.3. Hapja e kllapave			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca personale Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: heq kllapat; mbledh kufizat e ngjashme.		Fjalë kyç: kllapa kufiza	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkencat e natyrës Gjuhën dhe komunikimin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimi)			
Mbas kontrollit të detyrave të shtëpisë, shtrohet pyetja e situatës së të nxënit. Priten përgjigje nga nxënësit.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto)			
Nxënësit punojnë shembullin e tekstit. Mësuesi i ndihmon për veprimet që do të kryejnë.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe dyshe)			
Pastaj nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimet 1, 2 në faqen 98 nga libri i nxënësit.			
Vlerësimi:			
Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Si vepohet për të hequr kllapat, nëse numri para kllapës është pozitiv? – Si vepohet për të hequr kllapat, nëse numri para kllapës është negativ? – Cili numër është para kllapës, nëse nuk është shkruar?			
Detyrat dhe puna e pavarur:			
Ushtrimet 1, 2 faqe 51 nga fletorja e punës dhe 3, 4 faqe 98 nga libri i nxënësit.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit: Mësuesi krijon këto dy situata: si ta gjejmë numrin që kam menduar, nëse i shtoj 3 dhe shuma më del 18? Nëse $4x + 12 = 0$, si ta gjejmë x ?	
Tema mësimore: 9.4. Formimi dhe zgjidhja e ekuacioneve			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca personale Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> formon ekuacionin kur u jepen disa të dhëna; zgjidh ekuacione të thjeshta; dallon shprehjet nga ekuacionet; bën provën. 		Fjalë kyç: ekuacion zgjidhje ndryshimi i shenjës ndryshimi i vendeve zgjidhje e ekuacionit	
Burimet: libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkencat e natyrës Gjuhën dhe komunikimin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimi) Jepen pyetjet e situatës së të nxënit. Priten përgjigjet e nxënësve.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto) Më pas, nxënësit punojnë shembullin që është në tekst. Ka disa veprime që duhen sqaruar nga mësuesi. Mësuesi duhet t’u sqarojë nxënësve se një kufizë kalon nga njëra anë e ekuacionit duke i ndryshuar shenjën. Kemi të drejtë të pjesëtojmë ose të shumëzojmë të dyja anët e një ekuacioni me një numër. Për këto veprime të punohet dhe ushtrimi 1 (f, i) në faqen 99.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e diferencuar) Për ushtrimet 1(a, b, c, ç, d, dh, e, f) punojnë nxënës nën mesataren. Për ushtrimet e tjera nxënës mbi mesataren.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Cili është ndryshimi ndërmjet shprehjes dhe ekuacionit? – Si zgjidhet ekuacioni, nëse është i trajtës $x - 3 = 7$? – Po ekuacioni i trajtës $3x = 12$? – Po ekuacioni i trajtës $\frac{x}{3} = 4$? – Po ekuacioni i trajtës $3x + 5 = 8$?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 1, 2 në faqen 52 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit: Një nxënës ka x lekë. Një shok i jep dhe 1000 lekë. Atij i bëhen 2560 lekë. Sa lekë ka pasur në fillim nxënësi?	
Tema mësimore: 9.5. Formimi dhe zgjidhja e ekuacioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca personale Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> • formon ekuacionin kur i jepen disa të dhëna; • zgjidh ekuacione të thjeshta; • dallon shprehjet nga ekuacionet; • bën provën. 		Fjalë kyç: ekuacion zgjidhje ndryshimi i shenjës ndryshimi i vendeve zgjidhje e ekuacionit	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkencat e natyrës Gjuhën dhe komunikimin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (rikujtim njohurish) Mbasi kontrollohen detyrat, disa nxënës punojnë ushtrimin 3 në faqen 52 nga fletorja e punës. Për punën e kryer, mësuesi bën vlerësimet e tyre. Parashtron situatën dhe kërkon përgjigje.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-diskuto) Për mësimin punohet ushtrimin 4 në faqen 100 nga libri i nxënësit dhe sqarohen konceptet.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë e pavarur) Më tej nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 3 në faqen 100 nga libri i nxënësit.			
Vlerësimi: Ora quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Cili është ndryshimi ndërmjet shprehjes dhe ekuacionit? – Si zgjidhet ekuacioni, nëse është i trajtës $x - 6 = 7$? – Po ekuacioni i trajtës $3x = 17$? – Po ekuacioni i trajtës $\frac{x}{3} = 1$? – Po ekuacioni i trajtës $3x + 5 = 5$?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 5, 6 në faqen 100 nga libri i nxënësit dhe 4, 5 në faqen 52 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Algjebra dhe funksioni		Situata e të nxënit: Situatë e ngjashme me mësimin paraardhës.	
Tema mësimore: 9.6. Përsëritje			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të menduarit Organizon lidhjen konceptuale të njohurive. Kompetenca personale Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e funksioneve.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: formon ekuacionin kur i jepën disa të dhëna; zgjidh ekuacione të thjeshta; dallon shprehjet nga ekuacionet; bën provën.		Fjalë kyç: ekuacion zgjidhje ndryshimi i shenjës ndryshimi i vendeve zgjidhje e ekuacionit	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikular: Artet Shkencat e natyrës Gjuhën dhe komunikimin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (kontroll njohurish) Kontrollohen detyrat. Nëse shihet të nevojshme, mund të bëhen edhe vlerësime.			
Ndërtimi i njohurive të reja (punë individuale) Gjatë gjithë orës nxënësit punojnë individualisht ushtrimet 1, 5, 6, 8 dhe 10 në faqen 101 nga libri i nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim) Nxënësit paraqesin punën e tyre.			
Vlerësimi: Ora quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Cili është ndryshimi ndërmjet shprehjes dhe ekuacionit? – Si zgjidhet ekuacioni nëse është I trajtës $x - 6 = 17$? – Po ekuacioni i trajtës $3x - 17 = 0$? – Po ekuacioni i trajtës $\frac{2x}{3} = 1$? – Po ekuacioni i trajtës $3x + 5 = 5$?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 2, 3, 4, 7, 9 faqe 101 nga libri i nxënësit.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Statistikë		Situata e të nxënit: Në një klasë me 30 nxënës është bërë një test në matematikë. Në këtë test janë marrë 3 katra, 5 pesa, 6 gjashta, 3 shtata, 6 teta, 4 nënta dhe 3 dhjeta. Si do të përcaktohet se cila notë është në mes? Si do ta përcaktojmë se cila notë përsëritet më shumë?	
Tema mësimore: 10.1. Mesatarja dhe amplituda			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e të nxënit Demonstron kuriozitet për përdorimin e statistikës në analizën e dukurive nga jeta reale. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për përpunimin e informacionit. Kompetenca qytetare Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> tregon çfarë është moda dhe si gjendet ajo; tregon çfarë është mesorja dhe si gjendet ajo; tregon çfarë është amplituda dhe si gjendet ajo. 		Fjalë kyç: statistikë mesore mesatare aritmetike modale (modë)	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, statistika të ndryshme që mund të jenë në shkollë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhën dhe komunikimin Artet, Teknologjinë Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimi) Parashtrohet situata e menduar në fillim. Mund të ketë mendime të ndryshme.			
Ndërtimi i njohurive të reja (vëzhgo-analizo-formulo) Nxënësit punojnë shembullin, ku gjendet mesorja, moda dhe amplituda. Arrihet në përfundime se çfarë quhet modë, mesore, mesatare aritmetike dhe amplitudë.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (metoda) Nxënës punojnë në grupe dyshe ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 në faqen 104 nga libri i nxënësit dhe individualisht ushtrimin 5 në faqen 53 nga fletorja e punës.			
Vlerësimi: Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Çfarë quajmë mesore dhe si e gjejmë atë? – Çfarë quajmë modë dhe si e gjejmë atë? – Çfarë quajmë amplitudë?			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 1, 2, 3, 4 në faqen 53 nga fletorja e punës.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Statistika	<p>Situata e të nxënit Në një klasë me 30 nxënës është bërë një test në matematikë. Në këtë test janë marrë 3 katra, 5 pesa, 6 gjashta, 3 shtata, 6 teta, 4 nënta dhe 3 dhjeta. Si do të përcaktohet se cila notë është në mes? Si do ta përcaktojmë se cila notë përsëritet më shumë?</p>		
Tema mësimore: 10.2. Mesatarja dhe amplituda.			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të nxënit Demonstron kuriozitet për përdorimin e statistikës në analizën e dukurive nga jeta reale. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për përpunimin e informacionit. Kompetenca qytetare Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: tregon çfarë është moda dhe si gjendet ajo; tregon çfarë është mesorja dhe si gjendet ajo; tregon çfarë është amplituda dhe si gjendet ajo.</p>		<p>Fjalë kyç statistikë mesore mesatare aritmetike modale (modë)</p>	
<p>Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, statistika të ndryshme që mund të jenë në shkollë.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Gjuhën dhe komunikimin Artet Teknologjinë Shoqërinë dhe mjedisin</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimit</p>			
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (kontroll njohurish) Kontrollohen detyrat e shtëpisë. Punojnë në mënyrë të pavarur në dërrasë dy nxënës ushtrimet 4 dhe 5 në faqen 104 nga libri i nxënësit. Klasa punon po këto ushtrime. Përgjigjen e nxënësve e kontrollojnë nxënësit e klasës.</p>			
<p>Ndërtimi i njohurive të reja (punë në grupe) Nxënësit punojnë në grupe ushtrimin 6, 7, 8 në faqen 104 nga libri i nxënësit 104 nga libri i nxënësit.</p>			
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (prezantim) Grupet paraqesin punën e tyre para klasës.</p>			
<p>Vlerësimi Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve: – Çfarë quajmë mesore dhe si e gjemë atë? – Çfarë quajmë modë dhe si e gjemë atë? – Çfarë quajmë amplitudë?</p>			
<p>Detyrat dhe puna e pavarur Ushtrimet 6, 7 dhe 8 në faqen 54 nga fletorja e punës.</p>			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Statistikë	Situata e të nxënit Një klasë me 30 nxënës është bërë një test në matematikë. Në këtë test janë marrë: 3 nxënës kanë marrë notën 4; 5 nxënës kanë marrë notën 5; 6 nxënës kanë marrë notën 6; 3 nxënës kanë marrë notën 7; 6 nxënës kanë marrë notën 8; 4 nxënës kanë marrë notën 9 dhe 3 nxënës kanë marrë notën 10. Kërkohej nota mesatare e klasës. Si do të veprohet?		
Tema mësimore: 10.3. Mesatarja aritmetike.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të nxënit Demonstron kuriozitet për përdorimin e statistikës në analizën e dukurive nga jeta reale. Kompetenca digjitale Beson në përdorimin e teknologjisë për përpunimin e informacionit. Kompetenca qytetare Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/-ja: – tregon se çfarë quhet mesatare aritmetike; – gjen mesataren aritmetike.		Fjalë kyç mesatare aritmetike	
Burimet: Libri i nxënësit, fletorja e punës, statistika të ndryshme që mund të jenë në shkollë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Gjuhën dhe komunikimin Artet Teknologjinë Shoqërinë dhe mjedisin	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mëimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimesh)			
Parashtron nxënësve situatën e menduar në fillim. Mund të jenë dy mendime të ndryshme. Njëri mendim mund të jetë: mbledhim notat nga 4 deri te 10 dhe shumën e pjesëtojmë me 7. Mendimi tjetër: mbledhim të gjitha notat dhe shumën e pjesëtojmë me 30.			
Ndërtimi i njohurive të reja (metoda)			
Nxënësit punojnë shembullin dhe mësuesi iu sqaron çdo veprim që kryhet. Kështu nxirret përkufizimi i mesatares aritmetike. Zhvillohet ushtrimi 1 dhe 6 në faqen 104, 105			

nga libri i nxënësit. Nxënësit nën mesataren punojnë ushtrimet 2 dhe 3 nga libri i nxënësit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (punë në grupe, prezantim)

Klasa ndahet në dy grupe, ku grupi i parë punon ushtrimin 4 dhe grupi i dytë punon ushtrimin 5. Mbasi përfundohen ushtrimet, prezanton punën një përfaqësues nga çdo grup

Vlerësimi

Ora do të quhet e realizuar, nëse nxënësit iu përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë quajmë mesore dhe si e gjemë atë?
